



STIHL

STIHL

KATALOGU 2021

PËR MË SHUMË INFORMACION DHE KËSHILLA:

KATALOGU 2021

www.stihl.com



0463 931 5023. M5, M0, Konradin, Printuar në Gjermani © ANDREAS STIHL AG & Co. KG 2020. Printuar në letër të certifikuar PEFC. Certifikata PEFC (Programi për Mbështetjen e Skemave të Certifikimit Pyjor) nënkupton menaxhim pyjor të plotë me synimin për të garantuar se ekosistemet mbeten të paprekuara për gjeneratat e ardhshme. Organet certifikuese të pavarura monitorojnë zbatimin e rregullave në lidhje me akordimin e kësaj vule miratimi. Kompanitë që përdorin letër të certifikuar PEFC tregojnë angazhimin e tyre ndaj ambientit dhe qëndrimin përgjegjës të tyre ndaj drurit - një material bazë i paçmueshëm. Për më shumë informacion vizitoni www.pefc.de.

TË PËRKUSHTUAR NDAJ FRYMËS INOVATORE TË THEMELUESIT

Përkushtimi ndaj frymës inovatore të themeluesit, në këto momente që karakterizohen nga ndarjet dhe ndërperjet, është një vlerë e çmuar sepse përmes saj rritet qëndrueshmëria dhe besimi. Veçanërisht në vitin 2020 e kemi përjetuar diçka të tillë në shumë dimensione. Kompania jonë i ka rrënjët në fushën e pylltarisë. Prandaj për ne vjen natyrisht të menduarit vizionar, në mënyrën që na e përcaktojnë pylli dhe natyra.

Në këtë vit, STIHL feston 95-vjetorin e themelimit. Kompania, e cila u themelua para gati një shekulli nga Andreas Stihl, sot e kësaj dite ndjehet e përkushtuar ndaj frymës së inovacionit dhe vullnetit të themeluesit tonë. Ne - tashmë gjenerata e 3 e familjes Stihl - shohim te forca e inovacionit dhe te drejtimi kërkues i kompanisë, një garanci për qëndrueshmërinë e saj.

Qoftë te motorët djegës, te teknologjia e produkteve me bateri apo te ofertat digjitale, siç është menaxhimi i gamës së produkteve për klientelën tonë profesioniste: si përdorues mund të keni gjithmonë besim të plotë, se me çdo ndryshim, me çdo risi, është i lidhur një përmirësim i prekshëm, si në efikasitet, në përdorimin e thjeshtë (miqësor), në pamjen e jashtme dhe në shërbimet e mirëmbajtjes. Ne bëjmë gjithçka që është në dorën tonë për të forcuar besimin tuaj në qëndrueshmërinë dhe në besueshmërinë e cilësisë së produkteve tona. Sepse ne krijojmë vegla pune dhe zgjidhje për ju, me qëllim që ju punën tuaj në natyrë ta shihni si një atraksion dhe të keni kënaqësi gjatë kryerjes së saj.

Familja juaj Stihl

Selina Stihl
Zëvendës kryetarja
e Bordit Këshillues

Dr Nikolas Stihl
Kryetari i Bordit

Karen Tebar
Zëvendës kryetarja
e Bordit Këshillues

PRODUKTET STIHL TESTOHEN RREGULLISHT NGA INSTITUCIONET GJERMANE DHE NDËRKOMBËTARE

Ne i ndërmarrim këto ekzaminime sepse i shikojmë si vazhdimin logjik të programit tonë të testimit. Ne i vlerësojmë së tepërmi opinionet e palëve të treta - jo pak, pasi u japin klientëve tanë qetësi. Institucionet konfirmojnë standardet e cilësisë sonë të lartë dhe teknologjitë karakteristike të produkteve STIHL duke na shpërblyer me tregues dhe simbole cilësie. Më shumë informacione gjithëpërfshirëse në lidhje me pajtueshmërinë tonë me direktivën 2002/44/EC (dridhjet) janë të disponueshme në faqen www.stihl.com/vib.

SHPJEGIMI I TREGUESVE TË CILËSISË

Kushtet e testeve për treguesit e cilësisë mund t'i gjeni në faqet tona të përcaktuara të internetit.



Testimi vullnetar (i lirë) i sigurisë - i konfirmuar nga një testues i certifikuar. Bazuar në Siglën GS vërtetohet se cili organ e ka kryer testimin, për shembull TÜV. www.tuv.com/united-kingdom/en/gs-mark.html.



Simboli i cilësisë së Shoqatës Bujqësore Gjermane. Ky komision i pavarur, jofitimprurës, përcakton kriteret e testimit dhe standardet e vlerësimit dhe është përgjegjës për dhënie të treguesit të cilësisë. Testi Signum zakonisht kërkon nga gjashtë deri në dymbëdhjetë javë për të përfunduar. Raportet e testit mund të shihen në linjë te www.dlg.org.



Certifikata DLG përfshin një test gjithëpërfshirës të vlerësimit të dobisë kryer nga DLG, bazuar në kriteret e pavarura dhe të mirënjohura të vlerësimit të produkteve agrikuturore. Nje makineri apo sistem i cili është i certifikuar nga DLG vlerësohet në entitetin e tij si neutral, në terma të karakteristikave të tij dalluese. Për më shumë informacion, vizitoni www.dlg.org.



Bordi i Administratorëve për Punën dhe Teknologjinë Pylltare (Kuratorium für Waldarbeit und Forsttechnik e.V.) i akordon treguesin "KWF Pro" (më parë ishte "treguesi i testit KWF Utility Value") për pajisje teknike pylltare që përmbushin standardet e larta të kërkuara për zbatim profesional të pylltarisë në lidhje me efikasitetin, sigurinë, ergonominë dhe pajtueshmërinë me rregullat mjedisore. Simboli akordohet në bazë të testeve praktike intensive nga përdoruesit profesionistë. Simboli i cilësisë "KWF Standard" i akordohet produkteve që i nënshtrohen gjithashtu testeve praktike të rrepta, por të cilat nuk janë të përshtatshme për zbatim në pylltari. Produkte të tilla janë ideale për t'u përdorur në bujqësi, lulishte, prerjen e drurëve të zjarrit dhe përdoruesit e rastësishëm. Produktet me veçoritë teknike specifike që janë testuar në mënyrë të suksesshme marrin "simbolin e testit "KWF" me ngjyrë blu. Raportet e testit mund të shihen në internet në adresën www.kwf-online.de.



Publikuesi ÖKO-TEST teston produktet nga të gjithë sektorët, duke marrë në konsideratë veçanërisht përshtatjen e tyre ndaj mjedisit dhe mungesën e ndotësve. Produktet që kapin rezultate të jashtëzakonshme në këtë testim mund të mbajnë etiketën ÖKO-TEST, e cila konsiderohet si vula më e pranuar e cilësisë në Gjermani. Për më shumë informacion, vizitoni www.oekotest.de.



Simboli European Eco-Label u përdor për herë të parë në vitin 1992 dhe njihet nga Komisioni Evropian, të gjithë anëtarët e BE-së dhe Zonës Ekonomike Evropiane. Për konsumatorët evropianë, simboli "lule" tregon një produkt me cilësi të lartë, që mbron mjedisin dhe është testuar nga institucione kombëtare të pavarura në secilin prej shteteve anëtare. Për më shumë informacion vizitoni <http://ec.europa.eu/environment/ecolabel>.



Të gjitha këpucët me GORE-TEX® dhe veshjet mbajnë garancinë Guaranteed to Keep You Dry™, që do të thotë se janë të garantuara se janë rezistente ndaj ujit, erës dhe mundësojnë qarkullimin e ajrit gjatë jetëgjatësisë së përdorimit të produktit. Për më shumë informacion, vizitoni gore-tex.co.uk.



Produktet me etiketën Oeko-Tex® janë testuar dhe certifikuar sipas Standardit 100 të Oeko-Tex®. Standardi 100 nga Oeko-Tex® është një sistem testimi dhe certifikimi në të gjithë botën për tekstile që mund të përdoren te produktet e papunuara, gjysmë të përfunduar dhe fundore. Testimet e helmueshmërisë kontrollojnë për substanca të ndaluara dhe kimikate që janë potencialisht të rrezikshme për shëndetin. Për më shumë informacion, vizitoni www.oeko-tex.com.



Ky simbol shfaqet mbi veshjet mbrojtëse ndaj prerjeve për përdoruesit e sharrave portative me zinxhir që janë certifikuar sipas EN 381 ose EN ISO 11393 dhe EN 17249.



Kjo sigël është për veshje dalluese të testuara sipas EN 20471.

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

1. Ky katalog i bën të gjithë katalogët e mëparshëm të pavlefshëm.
2. Nuk mund të bëhen ankesa në lidhje me specifikimet dhe imazhet në këtë katalog. Modeli, teknologjia, ngjyrat, veçoritë dhe çmimet mund të ndryshojnë.
3. Sharrat origjinale me zinxhir të markës STIHL dhe veglat motorike të tjera mund të dallohen nga kombinimi i ngjyrave të tyre portokalli/gri.
4. Ky katalog dhe përmbajtja e tij janë të mbrojtura me të drejta autori. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara, veçanërisht ndryshimi, përkthimi dhe riprodhimi me sisteme elektronike.

Ky katalog përmban kombinime të ndryshme të veglave dhe pjesëve shtesë të krijuara për zbatim të ndryshme dhe lloje të ndryshme përdoruesish. Për përdorime normale, ne mbështesim përdorimin e kombinimeve të rekomanduara nga STIHL. Këto mund të gjenden në manualin e përdoruesit të veglës suaj. Shitësit e STIHL mund t'ju japin këshilla të individualizuara në lidhje me kombinimin më të mirë që i përshtatet nevojave tuaja.

STIHL paralajmëron për imitimet:
www.stihl.com/piracy

www.stihl.com



TABELA E PËRMBAJTJES

VEGLA PUNE ME BATERI	NGA FAQJA 8	1
MOTOSHARRA DHE KRASITËSE DEGËSH NË LARTËSI	NGA FAQJA 38	2
MJETE PRERËSE	NGA FAQJA 74	3
SISTEMI KOMBI DHE SISTEMI MULTI	NGA FAQJA 80	4
KORRËSE BARI ME SHTYRJE, TRAKTORË KORRËS DHE PAJISJE AJROSËSE	NGA FAQJA 94	5
MOTOKOSA DHE SHARRA PASTRIMI	NGA FAQJA 128	6
PRERËSE GARDHESH DHE PRERËSE GARDHESH NË LARTËSI	NGA FAQJA 158	7
VJELËSIT SPECIALË	NGA FAQJA 172	8
GRIRËSE DEGËSH	NGA FAQJA 178	9
KULTIVATORË	NGA FAQJA 186	10
SISTEME PASTRIMI	NGA FAQJA 194	11
PAJISJE SPËRKATËSE	NGA FAQJA 232	12
PRERËSE BETONI, MAKINERI PRERËSE DHE TURJELA PËR SHPIM NË TOKË	NGA FAQJA 240	13
KARBURANTE DHE LUBRIFIKANTË	NGA FAQJA 262	14
VEGLA MANUALE DHE AKSESORË PYLLTARIE	NGA FAQJA 274	15
PAJISJE MBROJTËSE PERSONALE	NGA FAQJA 284	16
DYQANI I MARKËS	NGA FAQJA 324	17
DETAJET E TEKNOLOGJIVE KRYESORE	NGA FAQJA 374	

PRODUKTE TË REJA



MS 400 C-M RISI BOTËRORE DHE E LEHTË NË PESHË

Motosharrë e re, STIHL MS 400 C-M, është e para në botë me piston magnezi. Përdorimi i materialit të lehtë i ndërlidhur me mënyrën e prodhimit sjell si pasojë një peshë motori prej vetëm 5.8 kg dhe rrjedhimisht një raport peshë-fuqie më pak se 1.5 kg për kilowatt. Në të njëjtën kohë, pjesa e re e produktit siguron një xhiro maksimale rrotulluese, e cila garanton një mënyrë efektive pune, veçanërisht në krasitjen e degëve. Me këtë performancë të klasit të parë, MS 400 C-M përbush atë çfarë dëshiron përdoruesi profesionist nga një produkt i tillë: fuqi të madhe dhe peshë të lehtë.

VEGLA PUNE ME BATERI

BOSHT TELESKOPIK PËR FOR HSA 26	12
KËLLËF MBAJTËS PËR GTA 26	13
BATERI PËR MOTOKOSËN FSA 57	19
BATERI PËR FRYRËSIN E GJETHEVE BGA 57	19
BATERI PËR AJROSËSIN E BARIT RLA 240	20
BATERI PËR MAKINËN KORRËSE RMA 443 PV	26
BATERI PËR MAKINËN KORRËSE RMA 443 VC	26
BATERI PËR MAKINËN KORRËSE RMA 448 PV	26
BATERI PËR MAKINËN KORRËSE RMA 448 VC	26
BATERI PËR GËRSHËRËN E LIGUSTRAVE HLA 66	28
BATERI PËR GËRSHËRËN E LIGUSTRAVE HLA 86	28
BATERI PËR PRERËSIN E DEGËVE NË LARTËSI HTA 66	28
BATERI PËR FRYRËSIN E GJETHEVE BGA 200	29
KUTI PËR PERFORMANCË BATERIE	32
KUTI PËR KARIKUES BATERIE	32
MBAJTËSE KOMFORTI PËR BGA 200	33

MOTOSHARRA

MOTOSHARRË MS 194 C-E	42
MOTOSHARRË MS 400 C-M	47
MOTOSHARRË MS 881	47
BATERI PËR MOTOSHARRËN MSA 220 C-B ME ZINXHIR SHARRE PREJ METALI TË FORTË	57

MOTOKOSA DHE SHARRA PASTRIMI

KOKA MOTOKOSE TRIMCUT C 32-2, C 42-2, C 52-2	150
KOKË MOTOKOSE POLY CUT 6-2	150
SET THIKASH PLASTIKE PËR POLY CUT 6-2	153
TEH PRERËS BARI GRASSCUT 250-32	154
UPGRADE KIT GRASSCUT 250-32	155

KULTIVATORË

KULTIVATOR MH 600	189
KULTIVATOR MH 700	190
PLUG AHK 800	192
SET 12" RROTASH TRANSPORTUESE ART 012	192
SET RROTASH METALIKE AMR 060 / AMR 070	193
BASHKUES/PËRSHTATËS PER TRANSPORTIM AHT 600	193

SISTEME PASTRIMI

HINKË E PËRTHYER PËR BR 800	201
POMPË LAVAZHI RE 150	212
POMPË LAVAZHI RE 150 PLUS	212
POMPË LAVAZHI RE 170	213
POMPË LAVAZHI RE 170 PLUS	213
FSHESË ME KORRENT RA 90 DHE RA 110	214
FSHESË ME KORRENT E THATË DHE ME UJË SE 33	225
FILTRA PËR SE 33	228
FILTRA PET PËR SE 33	228

PRERËSE BETONI, MAKINERI PRERËSE DHE TURJELA PËR SHPIM NË TOKË

PRERËSE BETONI GS 461, ME ZINXHIR PRERËS DIAMANTI 36 GGM DHE SHINË DREJTUESE ROLLOMATIC G, 45 cm	244
36 GBM ZINXHIR PRERËS DIAMANTI, 40 cm	245
36 GGM ZINXHIR PRERËS DIAMANTI, 45 cm	245
SHINË DREJTUESE ROLLOMATIC, 40 cm DHE 45 cm	245

KARBURANTE DHE LUBRIFIKANTË

KARBURANT MOTOMIX, 1l	264
MULTI OIL BIO, 150 ml	267
MOTO4PLUS, 1l	268
MULTICLEAN, 500 ml	271
CARE & CLEAN KIT MAKINË KORRËSE	271
CARE & CLEAN KIT FS / FS PLUS	271
CARE & CLEAN KIT HS / HS PLUS	271

PAJISJE MBROJTËSE PERSONALE

HELMETË ADVANCE X-CLIMB	316
PËRSHTATËS PËR MBROJTËSET E VESHËVE BT	318

DYQANI I MARKËS

324

PERFORMANÇË SISTEMATIKE: FUQIA JONË ME BATERI.

SISTEMI AS	12	SISTEMI AK	18
LINJA AI	16	SISTEMI AP	24



SUPERFUQI TË VËRTETA

VEGLA PUNE ME BATERI PËR ÇDO KËRKESË

Mirëmbajtja e zonave të pyllëzuara dhe të gjelbërta paraqet një shumëllojshmëri sfidash për njerëzit dhe makineritë - përfshirë këtu edhe për qëndrueshmërinë. Ne ofrojmë katër sisteme veglash pune me bateri, në mënyrë që të sigurohet gjetja e pëgjigjes së duhur për ju, midis veglave tona të fuqishme, të rehatshme dhe fleksible me jetëgjatësi baterie të madhe. Si për përdorim personal, po ashtu edhe profesional, mund të mbështeteni gjithmonë në performancën e veglave të punës STIHL me bateri.

PËR PËRDORIM PRIVAT: PËRSHTATJE E PËRKRYER, PERFORMANCË MAKSIMALE NË ÇDO PËRDORIM

SISTEMI AS

KRYENI NJË GAMË PUNËSH KOPSHTARIE ME LEHTËSI

Sistemet e reja të veglave të dorës, të sistemit AS përshtaten në mënyrë perfekte për mirëmbajtjen e gardheve dhe punimin e tokës. Energjia e përdorur gjenerohet në mënyrë efektive nga bateria e zëvendësueshme AS 2.



AS
SYSTEM

LINJA AI

KRYENI PUNË TË VOGLA TË KOPSHTARISË BRENDË NJË KOHE SHUMË TË SHKURTËR

Me mjetet e lehta dhe të shpejta të linjës AI, do të jeni të pajisur në mënyrë fantastike për t'u përballur me punët e vogla të kopshtit tuaj. Për të karikuar baterinë e integruar, mjeti i punës duhet thjesht të lidhet me një prizë muri.



AI
SYSTEM



SISTEMI AK

REALIZONI PROJEKTE AMBICIOZE

Sistemi AK ofron një fuqi dhe kohëzgjatje të lartë pune. Me ofertën fleksible të veglave, klientit i ofrohet mundësia më e mirë për të kryer punët e kopshtarisë. Të gjitha bateritë e linjës AK janë të pajisura me karikues AL 101 ose AL 300 dhe çdo vegël është kompatibel me sistemin AK.



AK
SYSTEM

PËR PËRDORUES PROFESIONISTË: FUQI E PËRQENDRUAR

SISTEMI AP

SUKSES I SIGURUAR NË PËRDORIME PROFESIONALE

Sistemi jonë AP përfshin një gamë të gjerë me vegla pune me bateri, veçanërisht të fuqishme. Kapaciteti dhe qëndrueshmëria e tyre i bën ato ideale për mirëmbajtje profesionale të tokave, kopshteve dhe pemëve. Veglat e punës së kësaj serie janë të përshatshme edhe në mjedise komunale gjithashtu, duke mbajtur një profil të ulët kur konsiderojmë zhurmën.



AP
SYSTEM

SISTEMI AS



- Për përdorues në shtëpi
- Për mirëmbajtje ambientesh dhe kopshti
- Me baterinë e fuqishme AS 2



HSA 26
10.8 V • 0.8 kg^①



Prerëse gardhesh me bateri, e lehtë dhe kompakte, me tehe për shkurtimin dhe mirëmbajtjen e degëve më të vogla, me gjelbërim të përhershëm dhe pemëve zbukuruese me gjethe të vogla. Tehet prerëse janë dizenuar sipas gjeometrisë optimizuese të prerjes STIHL për një përvojë sa më optimale gjatë prerjes. E pajisur me prerëse bari për prerjen e skajeve të lëndinës. Përfshin një dorezë kontrolli e cila nuk lejon rrëshkitje gjatë mbajtjes dhe përdorimit, duke siguruar kështu ergonomi të përsosur. Gjithashtu, kjo vegël pune lejon ndryshimin e shpejtë të teheve prerës pa mjete shtesë, si dhe përmban një tregues të nivelit të karikimit të baterisë, në mënyrë që të shikoni kapacitetin e mbetur të baterisë në çdo kohë. Bateria AS 2 punon ekskluzivisht me produktet e sistemit AS, por nuk është kompatibël me HSA 25. HSA 26 është e disponueshme si set ose si një mjet individual. Më tepër për porositjen dhe detajet teknike i gjeni në faqen 166.

Të përfshira në set:

- 1 x bateri me jone litiumi AS 2, 28 Wh, 10.8 V
- 1 x karikues standart AL 1
- 1 x teh prerës me gjatësi prerje 20 cm, duke përfshirë kapakun mbrojtës të tij
- 1 x prerës bari, me gjatësi prerje 12 cm, duke përfshirë kapakun mbrojtës të tij
- 1 x çantë mbajtëse e zezë/portokalli me vrima për montim në mur

HSA 26 si mjet individual pa bateri, karikues dhe çantë mbajtëse, përfshirë prerëse/thikë bari apo shkurresh.
Gjatësia e tehut prerës **20 cm**
Nr. i porosisë **HA03 011 3500**

HSA 26 set me AS 2 dhe AL 1
Gjatësia e tehut prerës **20 cm**
Nr. i porosisë **HA03 011 3506**

E RE BOSHT TELESKOPIK PËR HSA 26

Mundëson punë ergonomike me HSA 26 në qëndrim të drejtë. Lidhje e shpejtë dhe e thjeshtë me HSA 26 si dhe ndërrim i lehtë i baterive AS 2. Boshti teleskopik nga 95 - 110 cm është i përshtatshëm me kënd pune 125°, me roleta të thjeshta në përdorim, si edhe dorezë të lëmuar. Teleskopia përshtatet plotësisht me HSA 26 dhe nuk është kompatibël me GTA 26 ose HSA 25.

Nr. i porosisë **HA03 710 7100**



① Pësha duke përfshirë baterinë, por duke përfshirë prerësin e gardheve.
② Pësha duke përfshirë baterinë, por duke përfshirë mjetin prerës.



GTA 26
10.8 V • 1.2 kg^①



Krasitëse degësh me bateri për një gamë të gjerë përdorimesh kopshtarë. Për krasitjen e degëve dhe shkurreve, prerjen e mbeturinave të kopshtit dhe ndërtimin me dru. E pajisur me një zinxhir sharre 1/4" PM3 për një fuqi të lartë të prerjes dhe performancës. Përfshin një dorezë kontrolli e cila nuk lejon rrëshkitje gjatë mbajtjes dhe përdorimit, duke siguruar kështu ergonomi të përsosur. Ofron zëvendësimin e zinxhirit pa mjete shtesë, kapuçin mbrojtës dhe fleksibël për një punë të sigurt, si edhe treguesin e nivelit të karikimit të baterisë. GTA 26 është e disponueshme si set ose si një mjet individual. Më tepër për porositjen dhe detajet teknike i gjeni në faqen 276.

Të përfshira në set:

- 1 x bateri me jone litiumi AS 2, 28 Wh, 10.8 V
- 1 x karikues standart AL 1
- 1 x shinë prerëse të lehtë me gjatësi 10 cm
- 1 x zinxhir prerës 1/4" PM3, 10 cm
- 1 x Multioil Bio, 50 ml
- 1 x çantë mbajtëse e zezë/portokalli me vrima për montim në mur

GTA 26 si mjet individual pa bateri, karikues dhe çantë mbajtëse, përfshirë Multioil Bio, 50 ml
Gjatësia e shinës **10 cm**
Nr. i porosisë **GA01 011 6900**

GTA 26 set me AS 2 dhe AL 1
Gjatësia e shinës **10 cm**
Nr. i porosisë **GA01 011 6910**

E RE KËLLËF MBAJTËS PËR GTA 26

Mundëson mbajtjen e GTA 26 në rripin e mesit dhe kapje të shpejtë gjatë punës. Rripi i përshtatshëm i këmbës fikson mbajtësen në brez dhe mundëson lehtësi në mbajtje. Pjesa e shpinës, e përforcuar, ofron mbrojtje të lartë gjatë lidhjes. Kllapa shtesë e mban GTA 26 të lidhur më së miri në këllëf.

Nr. i porosisë **GA01 490 1700**



① Shpjegimi i simboleve gjendet në faqen 375
② Avantazh në çmim kur blihen si set, krahasuar me blerjen e çdo përbërësi individualisht.



ZINXHIRI PRERËS 1/4"-PM3 PËR PRERJE EFIKASE ME GTA 26

Zinxhiri prerës 1/4"-PM3 si dhe shpejtësia e tij prej 8 m/s mundësojnë rendiment në punë dhe prerje të pastër. Falë fiksimit të kapakut të zinxhirit me dado flutur, zëvendësimi i zinxhirit bëhet i mundur në mënyrë të thjeshtë, pa përdorur vegla. Të dhëna për porositjen për zinxhirin 1/4"-PM3 dhe për shinën mbajtëse i gjeni në faqen 74.



FAQE 267 MULTIOIL BIO



Miqësor ndaj mjedisit me një gamë të gjerë përdorimesh, si për shembull vajosje e zinxhirit për GTA 26. I disponueshëm në 50 ml dhe 150 ml





BATERIA AS 2

Bateri 10.8 V, e lehtë, kompakte dhe e fuqishme. Kompatibël me gjithë veglat e punës 10.8 V nga sistemi AS i STIHL (jo me HSA 25). Fuqia e baterisë 28 Wh, pesha 0.2 kg.

Nr. i porosisë **EA02 400 6500**

KARIKUES STANDART AL 1

230 V. Kompatibël me baterinë STIHL AS 2. Me tregues niveli të karikimit të baterisë (dritë LED pulsuese). Kabëll lidhës me ngjitje Velcro. Me mundësi montimi në mur.

Nr. i porosisë **EA03 430 2500**

AS 2



28 Wh

FUQIA E BATERISË^①

KOHËZGJATJA E KARIKIMIT TË BATERISË, KAPACITETI 80%/100%



55 min / 70 min

KOHËZGJATJA E BATERISË (ME SHEMBUJ PËRDORIMI)

KOHËZGJATJA E PUNËS PËR KARIKIM TË PLOTË TË BATERISË^② (DERI NË ...)

HSA 26

Shkurtim gjethesh



30 njësi shkurresh/
ligustrash

110 min

GTA 26

Kur presim degët
(Ø 4 cm)



80 prerje

25 min

① Kapaciteti i fuqisë në bazë të specifikimeve të prodhuesit. Kapaciteti aktual i fuqisë gjatë operimit është më i ulët, për të rritur jetëgjatësinë e shërbimit.
② Vlerat e llogaritura janë vlerësime dhe mund të variojnë në varësi të punës së kryer.

③ Kohëzgjatjet e baterive dhe specifikimet e zonave për secilin karikim baterie janë vlerësime dhe mund të variojnë në varësi të mënyrës së përdorimit të veglës së punës dhe në varësi të çfarë po pritet me të.



LINJA AI



- Për përdorues në shtëpi
- Për të kryer spontanisht punë të vogla kopshtarie
- Me bateri të integruar për kryerje të shpejtë dhe të drejtpërdrejtë të punëve



HSA 45

18 V • 2.3 kg^①



Një prerëse gardhesh me bateri, shumë e lehtë, me performancë të mirë prerjeje, e përdorur për shkurtimin e shkurreve dhe gardheve në ambientet e jashtme të shtëpisë suaj. E pajisur me teh prerës një-anësor me hapësirë 24 mm ndërmjet dhëmbëve prerës, me mbrojtës prerjeje të integruar dhe me mbrojtës të vidhosur në krye të tehut prerës. Ajo gjithashtu përmban baterinë me jone litiumi (36 Wh) të integruar në trup, bashkë me treguesin e nivelit të karikimit të baterisë. Kohëzgjatja e karikimit të baterisë: 145 min / 210 min (80%/100%). Më tepër për porositjen dhe detajet teknike i gjeni në faqen 166.

Gjatësia e shines **50 cm**
Nr. i porosisë **4511 011 3500**



BGA 45

18 V • 2.2 kg^①



Fryrëse me bateri, e lehtë në manovrim, e përdorur për të pastruar ambientet e jashtme të shtëpisë. E pajisur me grykë rrumbullake, si edhe me baterinë me jone litiumi (45 Wh) të integruar në trup. Ajo gjithashtu përfshin treguesin e nivelit të karikimit të baterisë. Kohëzgjatja e karikimit të baterisë: 210 min / 300 min (80%/100%). Më tepër për porositjen dhe detajet teknike i gjeni në faqen 202.

Nr. i porosisë **4513 011 5900**

① Pësha duke përfshirë baterinë
② Vlerat e llogaritura janë vlerësime dhe mund të variojnë në varësi të punës së kryer.



FSA 45

18 V • 2.3 kg^①



Motokosë kompakte me bateri, e përdorur për të shkurtuar dhe pastruar barin në ambientet e jashtme të shtëpisë. Me baterinë me jone litiumi (36 Wh) të integruar në trup, si edhe me treguesin e nivelit të karikimit të baterisë të përfshirë në të. FSA 45 ka një bosht dhe dorezë të cilat mund të përshtaten pa përdorur mjete shtesë, si edhe një kokë kositëse të cilës mund t'i përshtatet këndi i punës, duke përfshirë në këtë mënyrë, edhe kositjen në kënd vertikal. Një tjetër karakteristikë është thjeshtësia në ndryshimin e mjetit prerës nga thika PolyCut në fije kositëse pa patur nevojë të ndryshoni kokën kositëse. Kohëzgjatja e karikimit të baterisë: 145 min / 210 min (80%/100%). Më tepër për porositjen dhe detajet teknike i gjeni në faqen 146.

Nr. i porosisë **4512 011 5700**



LLOJET E PËRDORIMIT TË BATERIVE^② (ME SHEMBUJ PËRDORIMI)

KOHËZGJATJA E BATERISË PËR KARIKIM BATERIE^③ (DERI NË ...)

HSA 45

i gardheve



80 m²

40 min

BGA 45

Gjethet e thata në beton:



200 m²

10 min

FSA 45

Sipërfaqet e gjelbërta /
këndet e kopshteve:



250 m / 50 m²

20 min / 12 min

① Kohëzgjatjet e baterive dhe specifikimet e zonave për secilin karikim baterie janë vlerësime dhe mund të variojnë në varësi të mënyrës së përdorimit të veglës së punës dhe në varësi të çfarë po pritet me të.
② Shpjegimi i simboleve gjendet në faqen 375

SISTEMI AK

AK
SYSTEM

- Për përdorues rastësorë
- Për sasi të mëdha pune në kopshtin tuaj të shtëpisë
- Me bateri të zëvendësueshme dhe të fuqishme me jone litiumi



AK 20

MSA 120 C-B

36 V • 2.7 kg^①

Motosharrë e lehtë për mirëmbajtje ambienti dhe punë të drejtpërdrejta, por e aftë për përdorim manual. Dorezë e butë, tendosje dhe ndryshim i shpejtë dhe i përshtatshëm i zinxhirit STIHL. Serbatori i vajit ka një dritare shikimi transparente, si edhe një performancë të lartë prerëse në sajë të një zinxhiri prerës 1/4" PM3. Më tepër për porositjen dhe detajet teknike i gjeni në faqen 62.

MSA 120 C-B pa baterinë dhe karikuesin^②

Gjatësia e shinës 30 cm

Nr. i porosisë 1254 011 5870

Set MSA 120 C-B me AK 20 dhe AL 101^③

Gjatësia e shinës 30 cm

Nr. i porosisë 1254 011 5880



AK 30

MSA 140 C-B

36 V • 2.6 kg^①

Motosharrë e lehtë për mirëmbajtje ambienti dhe punë të drejtpërdrejta, por e aftë për përdorim manual. 25% më shumë performancë prerjeje krahasuar me MSA 120 C-B. Dorezë e butë, tendosje dhe ndryshim i shpejtë dhe i përshtatshëm i zinxhirit STIHL. Serbatori i vajit ka një dritare shikimi transparente, si edhe një performancë të lartë prerëse në sajë të një zinxhiri prerës 1/4" PM3. Më tepër për porositjen dhe detajet teknike i gjeni në faqen 62.

MSA 140 C-B pa baterinë dhe karikuesin^②

Gjatësia e shinës 30 cm

Nr. i porosisë 1254 011 5840

Set MSA 140 C-B me AK 30 dhe AL 101^③

Gjatësia e shinës 30 cm

Nr. i porosisë 1254 011 5850

B = Tendosje e shpejtë e zinxhirit



AK 10

E RE FSA 57

36 V • 2.7 kg^①

Motokosë me bateri, e lehtë dhe e thjeshtë në përdorim, për kositje bari dhe pastrim barërash në pjesë këndore afër mureve, me diametër prerës të thikës prej 280 mm, me gjatësi boshti të lëvizshme me buton dhe zhvendosje të dorezave, pa patur nevojë për vegla shtesë. Mbajtës distance gjatë kositjes, duke mbajtur larg pengesat si pemë apo shkurre. Dorezë e lehtë dhe e thjeshtë në përdorim. Mbushja e kokës AutoCut C 3-2 me fill prerës pa patur nevojë për vegël. Koka prerëse alternative PolyCut 3-2 me thika plastike të disponueshme si aksesori. Më tepër për porositjen dhe detajet teknike i gjeni në faqen 146.

FSA 57 pa baterinë dhe karikuesin

Nr. i porosisë 4522 011 5730

Set FSA 57 me AK 10 dhe AL 101

Nr. i porosisë 4522 011 5748

Set FSA 57 me 2 x AK 10 dhe AL 101

Nr. i porosisë 4522 200 0017



TABELË PËRMBLEDHËSE E KOHËZGJATJEVE TË KARIKIMIT TË BATERIVE, KOHËS SË PUNËS PËR NJË KARIKIM BATERIE DHE LLOJET E BATERIVE.

E DISPONUESHME NË FAQET 22 DHE 23

- ① Peshë me përjashtim të baterisë, përfshirë shinën dhe zinxhirin e sharrës
- ② Me shinë dhe zinxhir sharre
- ③ Peshë duke përjashtuar baterinë, duke përfshirë mjetin prerës dhe mbrojtësen.
- ④ Peshë duke përjashtuar baterinë
- ⑤ Shpjegimi i simboleve në faqen 375



AK 10

HSA 56

36 V • 2.9 kg^①

Një prerëse gardhesh me bateri, shumë e lehtë, me performancë të mirë prerjeje, e përdorur për shkurtimin e shkurreve dhe gardheve në ambientet e jashtme të shtëpisë suaj. E pajisur me teh prerës një-anësor me hapësirë 30 mm ndërmjet dhëmbëve prerës, me mbrojtës prerjeje të integruar në formë loti dhe me mbrojtës të vidhosur në krye të tehut prerës. Më tepër për porositjen dhe detajet teknike i gjeni në faqen 166.

HSA 56 pa baterinë dhe karikuesin

Gjatësia e tehut prerës 45 cm

Nr. i porosisë 4521 011 3500

Set HSA 56 me AK 10 dhe AL 101

Gjatësia e tehut prerës 45 cm

Nr. i porosisë 4521 011 3510



AK 20

E RE BGA 57

36 V • 2.3 kg^①

Aparat fryrës i thjeshtë dhe i lehtë me bateri dhe formë ergonomike. Për fryrje dhe mbledhje gjethesh, bari, letre dhe mbeturinash të tjera në ambientet pranë shtëpisë. Grykë rrumbullake, mbajtëse e lëmuar, gyp fryrës i përshtatshëm në tre nivele, sipas gjatësisë trupore të përdoruesit. Grykë horizontale për rendiment më të lartë të shfryrjes së ajrit, gjithashtu e disponueshme. Më tepër për porositjen dhe detajet teknike i gjeni në faqen 202.

BGA 57 pa baterinë dhe karikuesin

Nr. i porosisë 4523 011 5960

BGA 57 set with AK 20 and AL 101

Nr. i porosisë 4523 011 5970

HLA 5636 V • 3.8 kg^①

Prerëse gardhesh në lartësi me bateri, shumë e lehtë, e përdorur për të prerë gardhe të larta dhe të gjera në kopshtin tuaj të shtëpisë. E pajisur me teh prerës një-anësor, me mbrojtës prerjeje të integruar në formë loti. Gjithashtu ofron një kënd të ndryshueshëm prerjeje nga -45° deri në +90° dhe një bosht të zbrëthueshëm për lehtësi transporti. Teh prerës i rregullueshëm prej 115 cm dhe gjatësi totale prej 210 cm. Më tepër për porositjen dhe detajet teknike i gjeni në faqen 170.

HLA 56 pa baterinë dhe karikuesin

Nr. i porosisë

HA01 011 2900

Set HLA 56 me AK 20 dhe AL 101

Nr. i porosisë

HA01 200 0011



AK 20

**AKSESORËT:
BOSHT ZGJATUES
PËR HLA**

Shihni faqen 21

RMA 339 C36 V • 16.0 kg^①

Korrëse bari me bateri, shumë e lehtë, thjeshtësisht e manovrueshme, me një gjerësi prerjeje prej 37 cm, për hapësira lëndine nga ato me përmasa të vogla deri në ato me përmasa mesatare. Me kontroll automatik shpejtësie dhe thikë të optimizuar për jetëgjatësi baterie më të madhe. Ofron përshtatje qendrore të gjatësisë së prerjes, si edhe dorezë timoni të rehatshme dhe të rregullueshme sipas gjatësisë. Përfshin koshin grumbullues prej 40 litrash, të palosshëm, si edhe treguesin e nivelit të mbushjes së tij. Më tepër për porositjen dhe detajet teknike i gjeni në faqen 114.

RMA 339 C pa baterinë dhe karikuesin

Nr. i porosisë 6320 011 1420

Set RMA 339 C me AK 20 dhe AL 101

Nr. i porosisë 6320 011 1442

Set RMA 339 C me AK 30 dhe AL 101

Nr. i porosisë 6320 011 1443

Versione shtesë: RMA 339; Shihni tabelën në faqen 128



AK 20

**RMA 235**36 V • 14.0 kg^①

Korrëse bari me bateri, shumë e lehtë, thjeshtësisht e manovrueshme me një gjerësi prerjeje 33 cm për hapësira të vogla lëndine. Me kontroll automatik shpejtësie dhe thikë të optimizuar për jetëgjatësi baterie më të madhe. Ofron përshtatje qendrore të gjatësisë së prerjes. Me timon drejtues të palosshëm në 2 nivele të rregullueshme gjatësie, si edhe me kosh grumbullues prej 30 litrash, të palosshëm sipas treguesit të mbushjes së tij. Më tepër për porositjen dhe detajet teknike i gjeni në faqen 114.

RMA 235 pa baterinë dhe karikuesin

Nr. i porosisë 6311 011 1410

Set RMA 235 me AK 20 dhe AL 101

Nr. i porosisë 6311 200 0010

Set RMA 235 me AK 30 dhe AL 101

Nr. i porosisë 6311 200 0007



AK 20

**ERE
RLA 240**36 V • 15.0 kg^①

Bateri kompakte për aparat ajrosës dhe pastrimi të sipërfaqeve të vogla me bar. Rregullues qendror i thellësisë me dorezë rrotulluese në mbulesë, drejtuesi/timoni i përshtatshëm në 4 nivele, gjerësia e kapjes 34 cm, me 16 thika. Përfshin rulin e ajrit dhe koshin grumbullues prej 50 litrash. Më tepër për porositjen dhe detajet teknike i gjeni në faqen 126.

RLA 240 pa baterinë dhe karikuesin

Nr. i porosisë 6291 011 6600

Set RLA 240 me AK 30 dhe AL 101

Nr. i porosisë 6291 200 0000



AK 30

**KAPAK PËR BATERI TË SISTEMIT AK**

Për të mbuluar vendin e baterisë tek sistemi AK i veglave të punës STIHL. (Nuk përfshihen RMA 235, RMA 339 / 339 C si dhe RLA 240). Ofron mbrojtje kundër pluhurit dhe papastërtive në periudha të gjata magazinimi.



Nr. i porosisë 4520 602 0900

ZGJATUES BOSHTI PËR HLA

I përbërë nga alumini. Zgjatues boshti i thjeshtë prej 50 cm për prerësin e gardheve në lartësi në lartësi: HLA 56. Peshë: 500 g.



Nr. i porosisë HA01 820 5000

ÇANTË BATERIE

Çantë e lehtë, e fortë për transportim të lehtë dhe ruajtje të aksesoreve të veglave STIHL pa kablo. Për katër bateri ose dy bateri dhe një karikues.



Nr. i porosisë 0000 881 0520

C = Versioni komfort

① Peshë duke përfshirë baterinë

② Shpjegimi i simboleve në faqen 375

③ Avantazh në çmim kur blihen si set, krahasuar me blerjen e çdo përbërësi individualisht.



BATERITË AK

Kompatibël me sistemin AK të STIHL. Bateri të lehta me jone litiumi dhe me treguesin e nivelit të karikimit të baterisë (katër drita LED). Të disponueshme me kapacitete të ndryshme fuqie.



AK 10 72 Wh fuqi baterie[Ⓢ], 0,8 kg
Nr. i porosisë **4520 400 6515**

AK 20 144 Wh fuqi baterie[Ⓢ], 1,2 kg
Nr. i porosisë **4520 400 6518**

AK 30 180 Wh fuqi baterie[Ⓢ], 1,3 kg
Nr. i porosisë **4520 400 6512**

KARIKUES STANDARD AL 101

230 V. Kompatibël me bateritë STIHL AK dhe AP. Me treguesin e nivelit të karikimit të baterisë (LED). Lidhje me kabëll me ngjitesin Velcro. Montimi në mur është i mundur.



Nr. i porosisë **4850 430 2520**

KARIKUES I SHPEJTË AL 300

230 V. Për kohë karikimi më të shkurtër për bateritë STIHL AK, AP dhe AR. Përmban mekanizmat e duhur për montimin në mur dhe për mbledhjen e saktë të kabllit nga pas. Ofron treguesin e mënyrës së funksionimit (LED) dhe ftohje aktive të baterisë.



Nr. i porosisë **4850 430 5500**



KËSHILLË PROFESIONALE NGA STIHL:

MERR MË TË MIRËN NGA VEGLAT E PUNËS ME BATERI STIHL!

STIHL ofron një gamë të gjerë baterish për produktet në sistemin AK dhe sistemin AP. STIHL rekomandon një bateri specifike për çdo produkt, me qëllim që të jeni të pajisur për punë gjithmonë, në mënyrën më të mirë të mundshme. Kur japim këto rekomandime, gjithmonë marrim në konsideratë kombinimin ideal të fuqisë maksimale me performancën, kohëzgjatjen e mjaftueshme të baterisë, peshën më të lehtë të mundshme dhe shpërndarjen e balancuar të peshës. Rezultati: ju gjithmonë merrni më të mirën nga veglat tuaja të punës.

AK 30 **AP 300 S** **AR 3000 L**

	AK 10	AK 20	AK 30
FUQIA E BATERISË[Ⓢ]	72 Wh	144 Wh	180 Wh
KOHËZGJATJA E KARIKIMIT TË BATERIVE, KAPACITETI: 80%/100%			
AL 101	70 / 95 min	135 / 180 min	160 / 205 min
AL 300	30 / 45 min	35 / 55 min	35 / 60 min

[Ⓢ] Kapaciteti i fuqisë në bazë të specifikimeve të prodhuesit. Kapaciteti aktual i fuqisë gjatë operimit është më i ulët, për të rritur jetëgjatësinë e shërbimit.

		AK 10	AK 20	AK 30
		72 Wh	144 Wh	180 Wh
FUQIA E BATERISË[Ⓢ]				
LLOJET E BATERIVE[Ⓢ] (SHEMBULL PËRDORIMI) DHE KOHA E PUNËS PËR KARIKIM BATERIE[Ⓢ] (DERI NË ...)				
MSA 120 C-B	Kur sharrojmë dru katrorë (10 x 10 cm): 	18 min 60 cuts [Ⓢ]	40 min 160 cuts	55 min 190 cuts
MSA 140 C-B	Kur sharrojmë dru katrorë (10 x 10 cm): 	18 min 60 cuts [Ⓢ]	40 min 160 cuts [Ⓢ]	45 min 210 cuts
E RE FSA 57 (me kokë kositëse prej najloni)	Kositje bari: / Lëndinë: 	25 min 625 m / 125 m ²	50 min 1,250 m / 250 m ²	60 min 1,500 m / 300 m ²
HSA 56	të gardhit 	50 min 175 m ²	100 min 350 m ²	120 min 420 m ²
HLA 56	të gardhit 	50 min 190 m ²	100 min 380 m ²	120 min 460 m ²
E RE BGA 57	Gjethet të thata në asfalt: 	10 min 380 m ²	22 min 760 m ²	27 min 900 m ²
RMA 235	Lëndinë: 	150 m ²	300 m ²	400 m ²
RMA 339 / RMA 339 C	Lëndinë: 	120 m ²	250 m ²	330 m ²
E RE RLA 240	Lëndinë: 	96 m ² [Ⓢ]	190 m ² [Ⓢ]	250 m ² [Ⓢ]

Bateria e rekomanduar
 Performancë e reduktuar e veglës së punës

[Ⓢ] Vlerat e llogaritura janë vlerësime dhe mund të variojnë në varësi të punës së kryer
[Ⓢ] Kohëzgjatjet e baterive dhe specifikimet e zonave për secilin karikim baterie janë vlerësime dhe mund të variojnë në varësi të mënyrës së përdorimit të veglës së punës dhe në varësi të çfarë po pritet me të.

[Ⓢ] Kur punohet sipërfaqja, vetëm në një drejtim (pa kalim)

SISTEMI AP



- Për përdorues profesionalë
- Për mirëmbajtje pemësh dhe kopshtesh si edhe ambientesh
- Me bateri të fuqishme me jone litiumi të sistemit AP ose me bateritë në çantën e shpinës të sistemit AR



TABELË PËRMBLEDHËSE E KOHËZGJATJEVE TË KARIKIMIT TË BATERIVE, KOHËS SË PUNËS PËR NJË KARIKIM BATERIE DHE LLOJET E BATERIVE.

SHIHNI NË FAQEN 36

C = Versioni komfort
B = Tendosje e shpejtë e zinxhirit
T = Doreza e sipërme

Ⓢ Peshë me përjashtim të baterisë, përfshirë shinën dhe zinxhirin e sharrës



MSA 161 T

36 V • 2.5 kg[Ⓢ]



Motosharrë me bateri për arboristë, shumë e lehtë dhe profesionale për përdorim në zona të ndjeshme ndaj zhurmave. E pajisur me zinxhir prerës 1/4" PM3 për një prerje precize dhe performancë të lartë prerjeje, me koncept përdorimi të optimizuar dhe vidë kapëse në kapakun e yllzës. Me tepër për poroshtjen dhe detajet teknike i gjeni në faqen 62.

MSA 161 T pa baterinë dhe karikuesin[Ⓢ]

Gjatësia e shinës 25 cm
Nr. i poroshtisë 1252 200 0043

Gjatësia e shinës 30 cm
Nr. i poroshtisë 1252 200 0044



MSA 200 C-B

36 V • 3.3 kg[Ⓢ]



Motosharrë me bateri me performancë të lartë prerjeje dhe përdorim në zona të ndjeshme ndaj zhurmave. 44% më shumë performancë në prerje krahasuar me MSA 160 C-B. Tendosje e shpejtë e zinxhirit STIHL, tapë serbatori pa mjete shtesë, me zinxhir prerës 1/4" PM3 për një prerje precize dhe performancë të lartë prerjeje. Me thumba metalikë. Për më shumë informacion në lidhje me veçoritë dhe detajet teknike, shihni faqen 62. Informacione shtesë mbi versionet e gdhendjeve janë të disponueshme në faqen 62.

MSA 200 C-B pa baterinë dhe karikuesin[Ⓢ]

Gjatësia e shinës 30 cm
Nr. i poroshtisë 1251 200 0018

Gjatësia e shinës 35 cm
Nr. i poroshtisë 1251 200 0021



MSA 220 C-B

36 V • 3.6 kg[Ⓢ]



Motosharrë me bateri për një gamë të gjerë përdorimesh. Deri në 20% më shumë performancë prerjeje krahasuar me MSA 200 C-B. Kapaciteti i saj i lartë dhe mjeti i saj profesional i prerjes janë të përshtatshëm për një shumëllojshmëri aplikimesh, si prerje të ndryshme të drurit dhe ndërtimi me to. E lehtë në manovrim dhe përdorim, si edhe ergonomike. Ofron tendosje të shpejtë të zinxhirit STIHL, tapë serbatori pa mjete shtesë, thumba metalikë dhe është e pajisur me zinxhir prerës 3/8" PS3 për performancë shumë të lartë në prerje. Më tepër për poroshtjen dhe detajet teknike i gjeni në faqen 62.

MSA 220 C-B pa baterinë dhe karikuesin[Ⓢ]

Gjatësia e shinës 35 cm
Nr. i poroshtisë 1251 200 0072

Gjatësia e shinës 40 cm
Nr. i poroshtisë 1251 200 0078

AP 100



AP 200



AP 300



AP 300 S



FUQIA E BATERISË[Ⓢ]

94 Wh

187 Wh

227 Wh

281 Wh

LLOJET E BATERIVE[Ⓢ] (SHEMBULL PËRDORIMI) DHE KOHA E PUNËS PËR KARIKIM BATERIE[Ⓢ] (DERI NË ...)

MSA 160 C-B

MSA 161 T

MSA 200 C-B

MSA 220 C-B

Kur sharrojmë dru katror (10 x 10 cm):



	AP 100	AP 200	AP 300	AP 300 S
MSA 160 C-B	-	42 min 210 prerje	50 min 250 prerje	62 min 310 prerje
MSA 161 T	-	42 min 200 prerje	50 min 240 prerje	62 min 300 prerje
MSA 200 C-B	-	42 min 160 prerje	40 min 210 prerje	50 min 270 prerje
MSA 220 C-B	-	42 min 150 prerje	35 min 200 prerje	37 min 270 prerje

■ Bateria e rekomanduar
■ Performancë e reduktuar e veglës së punës

Ⓢ Me shinë dhe zinxhir sharre
Ⓢ E dizenuar në mënyrë për të punuar midis degëve të pemëve; duhet vetëm të përdoret nga arboristë të trajnuar.
Ⓢ Për shpjegime të treguesve të cilësisë, shihni faqen 395
Ⓢ Shpjegimi i simboleve gjendet në faqen 375

Ⓢ Avantazh në çmim kur blihen si set, krahasuar me blerjen e çdo përbërësi individualisht.
Ⓢ Kapaciteti i fuqisë në bazë të specifikimeve të prodhuesit. Kapaciteti aktual i fuqisë gjatë operimit është më i ulët, për të rritur jetëgjatësinë e shërbimit.

Ⓢ Vlerat e llogaritura janë vlerësime dhe mund të variojnë në varësi të punës së kryer.
Ⓢ Kohëzgjatjet e baterive dhe specifikimet e zonave për secilin karikim baterie janë vlerësime dhe mund të variojnë në varësi të mënyrës së përdorimit të veglës së punës dhe në varësi të çfarë po pritet me të.



ERE -
E DISPONUESHME
NGA PRANVERA
E VITIT 2021
RMA 443 PV
36 V • 24.0 kg[ⓐ]

Korrëse bari me bateri, e zhdërvjellët, me gjerësi prerjeje 41 cm për sipërfaqe mesatare. Rregullues qendror i gjatësisë së prerjes dhe timon që përshtatet dhe paloset. Me thika optimale për prerje dhe kohëzgjatje të konsiderueshme të baterisë. Me drejtim elektrik të rrotave për punë komfote. Shpejtësia maksimale e punës mund të përshtatet në 6 nivele me levën që ndodhet në timon. Me dy vende aktive për baterinë. Përfshihet koshi grumbulles i barit prej 55 litrash që mund të paloset dhe treguesi i nivelit të mbushjes së tij. Më tepër për porositjen dhe detajet teknike i gjeni në faqen 114.

RMA 443 PV pa baterinë dhe karikuesin
Nr. i porosisë **6338 011 1435**

Set RMA 443 PV me AP 200 dhe AL 300
Nr. i porosisë **6338 200 0072**

Versione shtesë: RMA 443, RMA 443 C, RMA 443 VC,
Shihni tabelën në faqen 114

C = Versioni komfort
P = Performanca

V = Shpejtësi variable
R = Dorezë rrumbullake (për motokosat)
T = Shkurtrim



ERE -
E DISPONUESHME
NGA PRANVERA
E VITIT 2021
RMA 448 PV
36 V • 24.0 kg[ⓐ]

Korrëse bari me rendiment të lartë me bateri, gjerësi prerjeje 46 cm për sipërfaqe mesatare. Me rregullues qendror të gjatësisë së prerjes dhe timon që përshtatet dhe paloset. Me thika optimale për prerje dhe kohëzgjatje të konsiderueshme të baterisë. Me drejtim elektrik të rrotave për punë komfote. Shpejtësia maksimale e punës mund të përshtatet në 6 nivele me levën që ndodhet në timon. Me dy vende aktive për baterinë. Përfshihet koshi grumbulles i barit prej 55 litrash që mund të paloset dhe treguesi i nivelit të mbushjes së tij. Më tepër për porositjen dhe detajet teknike i gjeni në faqen 114.

RMA 448 PV pa baterinë dhe karikuesin
Nr. i porosisë **6358 011 1435**

Set RMA 448 PV me AP 300 dhe AL 300
Nr. i porosisë **6358 200 0028**

Versione shtesë: RMA 448 VC, Shihni tabelën në faqen 114

ⓐ Pesha pa baterinë
ⓑ Shpjegimi i simboleve gjendet në faqen 375
ⓒ Pesha pa baterinë, mjetin prerës dhe mbrojtësen

FSA 90

36 V • 3.2 kg[ⓐ]




Motokosë me bateri për përdorim në sipërfaqe të mëdha me bar të fortë. Diametri i prerjes është 260 mm me thikën prerëse, maksimumi i diametrit të prerjes është 380 mm me fjetet kositëse. Ofron dorezë drejtuese, dorezë kontroluese me funksionin e ngarkesës së pjesshme ECOSPEED, si edhe mbrojtje të dyfishtë të shpatullave. Më tepër për porositjen dhe detajet teknike i gjeni në faqen 146.

FSA 90 pa baterinë dhe karikuesin
Nr. i porosisë
4863 200 0003

Additional versions:
FSA 90 R (loop handle)
see table, page 146

ⓐ Kur përdorni tehe prerëse me gjatësi 60 cm dhe 75 cm, nevojitet mbrojtje për veshët.



HSA 94 T

36 V • nga 3.7 kg[ⓐ]



Prerëse gardhesh me bateri, profesionale, e fuqishme, me performancë jashtëzakonisht të madhe dhe shpejtësi tehu të lartë për prerje precize. Ofron një ritëm konstant të goditjes edhe nën ngarkesë, dorezë rrotulluese shumëfunktionale me shkallë goditje me tri nivele, teh prerës dy-anësor dhe mbrojtës me vidhosje në krye të tehut prerës. Gjithashtu, ofron funksionimin e baterisë me ndihmën e këllëfit AP dhe kabllit lidhës, të përdorur me rripin e baterisë dhe rripat e sigurisë ose sistemin mbajtës AP ose një bateri të sistemit AR me çantë shpine (shihni faqen 35). Më tepër për porositjen dhe detajet teknike i gjeni në faqen 166.

HSA 94 T pa baterinë dhe karikuesin
Gjatësia e tehut prerës **50 cm**
Nr. i porosisë **4869 011 3510**

Gjatësia e tehut prerës **60 cm**
Nr. i porosisë **4869 011 3511**

Gjatësia e tehut prerës **75 cm**
Nr. i porosisë **4869 011 3512**

E RE
HLA 6636 V • 3.8 kg^①

Prerëse gardhesh me bateri, gjithashtu për prerje ferrash dhe shkurresh në lartësi ose afër tokës. Thika prerëse që përshtaten pa vegla shtesë në 115° për prerje lart, anash dhe në tokë. Thika të mprehura në të dyja anët për prerje të pastër. Goditje konstante e thikave dhe vazhdimësi pune edhe nën trysni. Dorezë e rrumbullakët, kontroll i pandryshueshëm i numrit të rrotullimeve dhe dorezë funksioni intuitive. Gjatësia gjatë transportit me thika të palosura 125 cm. Gjatësia maksimale 205 cm. Më tepër për porositjen dhe detajet teknike i gjeni në faqen 170.

HLA 66 pa baterinë dhe karikuesin
Nr. i porosisë
4859 011 2910

**AKSESORËT:
MBROJTËSE
BOSHTI**

Shihni faqen 34

AP 200

SPA 6536 V • 3.3 kg^①

Shkundëse ulliri me bateri, me nivele të ndryshueshme dhe të rregullueshme me një shpejtësi të vetme. E fuqishme, me transmision të mbrojtur nga pluhuri, motor elektrik EC, rripin e vetëm të shpatullës si një mjet mbajtës dhe tubin e dorezës në bosht. Idealisht e kombinuar me AR 2000 ose AR 3000 për punë që zgjasin gjatë gjithë ditës. Gjatësia totale është 225 cm. Më tepër për porositjen dhe detajet teknike i gjeni në faqen 177.

SPA 65 pa baterinë dhe karikuesin
Nr. i porosisë
4855 011 0700



AR 2000

E RE
HLA 8636 V • 4.8 kg^①

Prerëse gardhesh me diapazon të lartë për përdorim profesional. Veçanërisht e përshtatshme për prerje ferrash dhe shkurresh të larta ose përgjatë tokës. Punë e thjeshtëzuar nëpërmjet boshtit teleskopik me katër skaje. Gjatësia e boshtit dhe e thikave përshtaten pa patur nevojë për vegla. Thikat prerëse të përshtatshme me 115° për prerje lart, anash dhe afër tokës. Thika të mprehura në të dyja anët për prerje të pastër, kontroll i pandryshueshëm i numrit të rrotullimeve dhe dorezë funksioni intuitive. Gjatësia gjatë transportit me thika të palosura 180 cm. Gjatësia maksimale 260 - 330 cm. Më tepër për porositjen dhe detajet teknike i gjeni në faqen 170.

HLA 86 pa baterinë dhe karikuesin
Nr. i porosisë
4859 011 2930

**AKSESORËT:
MBROJTËSE
BOSHTI**

Shihni faqen 34

AP 200

E RE
HTA 6636 V • 3.3 kg^①

Krasitëse degësh shumë e lehtë dhe me rendiment të lartë me bateri, për mirëmbajtjen e pemëve frutore dhe dekorative. Me zinxhir 1/4 -PM3, buton ndezje të thjeshtë, me bosht të palëvizshëm. Gjatësia maksimale 240 cm. Më tepër për porositjen dhe detajet teknike i gjeni në faqen 64.

HTA 66 pa baterinë dhe karikuesin^②
Nr. i porosisë
LA03 200 0004

**AKSESORËT:
MBROJTËSE
BOSHTI**

Shihni faqen 34

AP 200

**BGA 100**36 V • 2.5 kg^①

Fryrëse me bateri tejet e fuqishme për përdorim profesional, si edhe e qetë në mënyrë të kënaqshme, veçanërisht në zona urbane, të ndjeshme ndaj zhurmave. Grykë rrumbullake, dorezë e butë, tri nivele fuqie me funksion shtytës shtesë. Tubi i grykës ofron tri nivele të rregullueshme të gjatësisë së tij, sipas nevojës. Gjithashtu, ofron funksionimin e baterisë me ndihmën e këllëfit AP dhe kabllit lidhës, të përdorur me rripin e baterisë dhe rripat e sigurisë ose sistemin mbajtës AP, ose një bateri të sistemit AR me çantë shpine (shihni faqen 35). Më tepër për porositjen dhe detajet teknike i gjeni në faqen 202.

BGA 100 pa baterinë dhe karikuesin
Nr. i porosisë **4866 011 5900**

AR 3000

**TSA 230**^③36 V • 3.9 kg^①

Makineri prerëse me bateri, e lehtë në manovrim, për disqe prerëse 230 mm. E përshtatshme për përdorime në ambiente të brendshme dhe të jashtme, deri në 70 mm thellësi prerje. Ofron lidhje me ujë përmes valvulës rrumbullake, bashkimin me zorrën e ujit për prerje të lagështa, si edhe drejtimin e rripit pa nevojë mirëmbajtje. Më tepër për porositjen dhe detajet teknike i gjeni në faqen 250.

TSA 230 pa baterinë dhe karikuesin
Nr. i porosisë **4864 011 6600**

**SISTEM MBAJTËS
KOMFORT**

AR 3000 L

**E RE**
BGA 20036 V • 3.2 kg^①

Aparat fryrës me rendiment të lartë me bateri nga STIHL. Me zhurmë të reduktuar për përdorim profesional në zona të banuara dhe sensitive ndaj zhurmave. Ideal për përdorim me dorë për zona të ngushta. Për sipërfaqe të mëdha ose kohëzgjatje pune, BGA 200 mund të përdoret thjesht me sistemin mbajtës përkatës. Mund të shndërrohet shumë thjesht në formën e të mbajturit me dorë ose duke e varur në qafë, duke e bërë BGA 200 një vegël fleksible të ndashme 2 në 1. Forma e lakuar e BGA 200 siguron që pavarësisht rrymës së fortë të ajrit, dridhjet dhe ndikimi në trup dhe dorë të jenë minimale. Doreza e dytë dhe bllokuesi i gazit sigurojnë komfort shtesë. Me anën e butonit mundësohet përshtatja e gjatësisë së gypit të fryrjes, në mënyrë të thjeshtë, për pastrimin në situata të ndryshme, si psh. pastrimi në cepa ose vende të ngushta. Sistemi mbajtës serial fiksohet në rripin e kofshës së baterisë AR. Më tepër për porositjen dhe detajet teknike i gjeni në faqen 202.

BGA 200 pa baterinë dhe karikuesin, Sistem mbajtës komfort
Nr. i porosisë **BA01 200 0000**



TABELË PËRMBLEDHËSE E KOHËZGJATJEVE TË KARIKIMIT TË BATERIVE, KOHËS SË PUNËS PËR NJË KARIKIM BATERIE DHE LLOJET E BATERIVE.

SHIHNI NË FAQEN 36

① Peshë duke përfshirë baterinë

② Peshë duke përfshirë baterinë, shinën dhe zinxhirin e prerjes.

③ Me shinë dhe zinxhir sharre

④ Shpjegimi i simboleve gjendet në faqen 375

⑤ Dërgesa përfshin rrotën prerëse

⑥ Peshë duke përfshirë baterinë dhe mjetin prerës



AR 1000

KMA 130 R36 V • 3.2 kg^②

Motor i sistemit Kombi me bateri, i fuqishëm dhe i lehtë. Tri nivele fuqie për punë me eficiencë të madhe dhe të ndjeshme ndaj zhurmave. Mund të kombinohet me të gjitha veglat Kombi. Gjithashtu, ofron funksionimin e baterisë me ndihmën e kapakut AP dhe kabllit lidhës, të përdorur me rripin e baterisë dhe mbrojtësin ose sistemin mbajtës AP ose nje bateri të sistemit AR me çantë shpine (shihni faqen 35). KMA 130 R nuk përdoret për kosën FSB-KM. Më tepër për porositjen dhe detajet teknike i gjeni në faqen 88.

KMA 130 R pa baterinë dhe karikuesin
Nr. i porosisë **4867 011 6820**

VEGLA PUNE KOMBI:

FS-KM
KOKË KOSITËSE PREJ
NAJLONI

HT-KM
PRERËSE DEGËSH
NË LARTËSI

FS-KM
THIKË PRERËSE PËR
BARIN

BG-KM
FRYRËS GJETHESH

HL-KM 145°
PRERËSE GARDHESH NË
LARTËSI

RG-KM
KOKË PRERËSE
RROTULLUESE

**INFORMACIONE SHITESË MBI
VEGLAT E PUNËS KOMBI**SHIHNI **NGA FAQJA 85**

R = Dorezë mbajtëse

- ① Peshë duke përfshirë baterinë
- ② Peshë duke përfshirë baterinë dhe mjetin Kombi
- ③ Mbrojtja e veshëve duhet të vishet kur përdoret fryrësi i gjetheve BG-KM
- ④ Shpjegimi i simboleve gjendet në faqen 375



AP 100

KGA 77036 V • Kapaciteti i kontejnerit 50 l • Gjerësia e fshirjes 77 cm • 16.0 kg^②

Aparat fshirjeje me bateri për hapësira të mëdha, të brendshme dhe të jashtme. Ofron sistem pastrimi STIHL MultiClean PLUS, përshtatje qendrore të gjatësisë në 8 pozicione, rrota anësore, dorezë transportimi. Qëndron vertikalisht për të kursyer hapësirën, si edhe përfshin një shufër në formë ergonomike për përshtatjen e gjatësisë në 2 nivele. Është e lehtë dhe pa mundim puna me të, në sajë të operimit me bateri të fuqave qarkore dhe fuqisë së pastrimit. Kjo mundëson pastrim të thellë të anëve dhe cepave, edhe kur aparati është është i palëvizshëm. Qimet e forta të najlonit kanë garanci katër vjeçare. Më tepër për porositjen dhe detajet teknike i gjeni në faqen 208.

KGA 770 pa baterinë dhe karikuesin
T = Drejtim me 1 marsh
V = Shpejtësi variable "Vario"
X = Model ekonomik
Ⓞ Pesha neto nuk përfshin karburantin dhe lubrifikantët



RM 448 VC

150 cm³ • 2.2 kW / 3.0 hp • 28.0 kg[Ⓞ]

Korrëse bari me benzinë, e fortë, me gjerësi prerjeje 46 cm për lëndina me sipërfaqe mesatare. Me përshtatje qendrore të lartësisë së prerjes, dorezë të rehatshme dhe të rregullueshme në dy nivele lartësie, rrota të lëvizshme lehtësisht dhe shpejtësi variable "Vario" për punë të rehatshme. Përfshin një kosh grumbullues të barit prej 55 litrash dhe treguesin e nivelit të mbushjes së tij.

Nr. i porosisë **6358 011 3451**



RM 448 PC

150 cm³ • 2.2 kW / 3.0 hp • 27.0 kg[Ⓞ]

Korrëse bari me benzinë, e fortë, me gjerësi prerjeje 46 cm për lëndina me sipërfaqe mesatare. Me përshtatje qendrore të lartësisë së prerjes, dorezë të rehatshme dhe të rregullueshme në dy nivele lartësie dhe drejtim me një marsh për punë të rehatshme. Përfshin një kosh grumbullues të barit prej 55 litrash dhe treguesin e nivelit të mbushjes së tij.

Nr. i porosisë **6358 011 3471**



FAQE 268 MOTO4PLUS



STIHL Moto4Plus është një karburant për vegla pune, i zhvilluar veçanërisht për motorët e vegjël STIHL me 4 kohë. Nuk përmban etanol dhe asnjë përbërës aromatik apo olefinë. Niveli i ulët i emetimeve e bën veçanërisht miqësor ndaj përdoruesit dhe motorit, dhe për arsye se mund të magazinohet deri në pesë vjet, karburanti gjithashtu siguron performancë maksimale në periudha afatgjata.



KORRËSE BARI ME BENZINË TË SERISË 5

- Për përdorues ambiciozë shtëpiakë
- Për korrje të lëndinave me sipërfaqe të mëdha
- Kompakte dhe të fuqishme
- Me një marsh ose me shpejtësi variable "Vario"
- Gjithashtu të disponueshme me ElectroStart
- Kapaku është i përbërë nga polimer rezistent ndaj goditjeve



RM 545 T

163 cm³ • 2.4 kW / 3.3 hp • 29.0 kg[Ⓞ]

Korrëse bari me benzinë, kompakte, e fortë, me gjerësi prerjeje 43 cm për lëndina me sipërfaqe mesatare. Me përshtatje qendrore të lartësisë së prerjes, dorezë jo të palosshme dhe të rregullueshme në tre nivele lartësie dhe drejtim me një marsh për punë të rehatshme dhe efikase. Përfshin një kosh grumbullues të barit prej 60 litrash dhe treguesin e nivelit të mbushjes së tij.

Nr. i porosisë **6340 011 3407**

Versione shtesë: RM 545 shihni tabelën, faqe 112



RM 545 VE

163 cm³ • 2.6 kW / 3.5 hp • 31.0 kg[Ⓞ]

Korrëse bari me benzinë, kompakte, e fortë, me gjerësi prerjeje 43 cm për lëndina me sipërfaqe mesatare. Me përshtatje qendrore të lartësisë së prerjes, dorezë jo të palosshme dhe të rregullueshme në tre nivele lartësie, shpejtësi variable "Vario" për punë të rehatshme dhe efikase dhe motor me funksion ElectroStart. Përfshin një kosh grumbullues të barit prej 60 litrash dhe treguesin e nivelit të mbushjes së tij.

Nr. i porosisë **6340 011 3427**

Versione shtesë: RM 545 V shihni tabelën, faqe 112

E = ElectroStart
T = Drejtim me 1 marsh
V = Shpejtësi variable "Vario"

Ⓞ Peshë neto, pa përfshirë karburantin dhe lubrifikantët

KORRËSE BARI ME BENZINË TË SERISË 6

- Për përdorues shtëpiakë të avancuar, si edhe mirëmbajtje profesionale
- Për korrje të lëndinave me sipërfaqe të mëdha
- Me funksion 3-në-1 për prerje, kapje dhe plehërim të tokës për ta bërë atë më pjellore
- Me motorë të fuqishëm
- Me kapak të përbërë nga alumin rezistent dhe i fortë



RM 650 T

173 cm³ • 2.6 kW / 3.5 hp • 45.0 kg[Ⓞ]

Korrëse bari me benzinë, e fuqishme, me gjerësi prerjeje 48 cm për lëndina me sipërfaqe më të mëdha. E pajisur me shumë thika për prerje, kapje dhe plehërim të tokës, me qëllim për ta bërë tokën më pjellore. Me përshtatje qendrore të lartësisë së prerjes, dorezë të rehatshme dhe shumë të butë dhe drejtim me një marsh për punë të rehatshme dhe efikase. Përfshin një kosh grumbullues të barit prej 70 litrash dhe treguesin e nivelit të mbushjes së tij.

Nr. i porosisë **6364 011 3441**



RM 650 VE

163 cm³ • 2.6 kW / 3.5 hp • 43.0 kg[Ⓞ]

Korrëse bari me benzinë, e fuqishme, me gjerësi prerjeje 48 cm për lëndina me sipërfaqe më të mëdha. E pajisur me shumë thika për prerje, kapje dhe plehërim të tokës, me qëllim për ta bërë tokën më pjellore. Me përshtatje qendrore të lartësisë së prerjes, dorezë të rehatshme dhe shumë të butë, me shpejtësi variable "Vario" për punë të rehatshme dhe efikase, e pajisur me motor me funksion ElectroStart. Përfshin një kosh grumbullues të barit prej 70 litrash dhe treguesin e nivelit të mbushjes së tij.

Nr. i porosisë **6364 011 3451**

Versione shtesë: RM 650 V shihni tabelën, faqe 112

KORRËSE BARI ME BENZINË TË SERISË 7

- Për mirëmbajtje profesionale të tokës
- Për korrje të zonave me sipërfaqe shumë të mëdha
- Jashtëzakonisht shumë rezistente, me strukturë të fuqishme për të plotësuar kërkesa të avancuara
- Me motorë shumë të fuqishëm
- Me kapak shumë të fortë, të përbërë nga magnezi me shtresë të zëvendësueshme polimeri



RM 756 GS

179 cm³ • 2.9 kW/3.9 hp • 60.0 kg[Ⓞ]

Korrëse bari me benzinë, profesionale dhe shumë e fuqishme, me gjerësi prerjeje 54 cm për zona me sipërfaqe të mëdha. Ofron bashkim të funksioneve të teheve prerës dhe frenave, si edhe mbrojtëse të boshtit motorik. E pajisur me përshtatje qendrore të lartësisë së prerjes nga rrotat, dorezë me lartësi të rregullueshme dhe shumë të butë, si edhe drejtim me tre marshe për punë të rehatshme dhe efikase. Përfshin një kosh grumbullues të barit prej 80 litrash.

Nr. i porosisë **6378 011 3411**



RM 756 GC

179 cm³ • 2.9 kW/3.9 hp • 60.0 kg[Ⓞ]

Korrëse bari me benzinë, profesionale dhe shumë e fuqishme, me gjerësi prerjeje 54 cm për zona me sipërfaqe të mëdha. Ofron bashkim të funksioneve të teheve prerës dhe frenave, si edhe mbrojtëse të boshtit motorik. E pajisur me përshtatje qendrore të lartësisë së prerjes nga rrotat, dorezë me lartësi të rregullueshme dhe shumë të butë, si edhe drejtim me tre marshe për punë të rehatshme dhe efikase. Përfshin një kosh grumbullues të barit prej 80 litrash dhe treguesin e nivelit të mbushjes së tij.

Nr. i porosisë **6378 011 3431**

C = Versioni Komfort
G = Drejtim me 3 marshe
S = Bashkim i teheve prerëse me frenat

Y = Me drejtim hidrostatik
Ⓞ Pesha neto, pa përfshirë karburantin dhe lubrifikantët



RM 756 YS

179 cm³ • 2.9 kW/3.9 hp • 60.0 kg[Ⓞ]

Korrëse bari me benzinë, profesionale dhe shumë e fuqishme, me gjerësi prerjeje 54 cm për zona me sipërfaqe të mëdha. Ofron bashkim të funksioneve të teheve prerës dhe frenave, si edhe mbrojtëse të boshtit motorik. E pajisur me përshtatje qendrore të lartësisë së prerjes nga rrotat, dorezë me lartësi të rregullueshme dhe shumë të butë, si edhe drejtim hidrostatik për punë të rehatshme dhe efikase. Përfshin një kosh grumbullues të barit prej 80 litrash.

Nr. i porosisë **6378 011 3401**




RM 756 YC

179 cm³ • 2.9 kW/3.9 hp • 61.0 kg[Ⓞ]

Korrëse bari me benzinë, profesionale dhe shumë e fuqishme, me gjerësi prerjeje 54 cm për zona me sipërfaqe të mëdha. Ofron bashkim të funksioneve të teheve prerës dhe frenave, si edhe mbrojtëse të boshtit motorik. E pajisur me përshtatje qendrore të lartësisë së prerjes nga rrotat, dorezë me lartësi të rregullueshme dhe shumë të butë, si edhe drejtim hidrostatik për punë të rehatshme dhe efikase. Përfshin një kosh grumbullues të barit prej 80 litrash dhe treguesin e nivelit të mbushjes së tij.

Nr. i porosisë **6378 011 3421**



1
2
3
4
5
6
7
8
9
10
11
12
13
14
15
16
17

KORRËSE BARI ME BENZINË TË SERISË R

- Për përdorues shtëpiakë, si edhe mirëmbajtje profesionale
- Korrëse bari speciale për qëllime të veçanta
- Ideale për plehërimin e tokës, me qëllim për ta bërë tokën më pjellore, si edhe korrje me shkarkim anësor



RM 2 RT

149 cm³ • 2.2 kW / 3.0 hp • 30.0 kg[Ⓞ]

Korrëse për plehërim të tokës, e lehtë në manovrim dhe efikase, me gjerësi prerjeje 46 cm për zona me sipërfaqe mesatare. Me përshtatje të lartësisë prerëse nga boshti, me dorezë shumë të butë dhe drejtimi me rrotat e përparme mundëson punë të rehatshme. Ofron tendosje të shpejtë Quick Fix, e cila bën të mundur palosjen e dorezave për transportim praktik. E pajisur me dorezë palosëse.

Nr. i porosisë **6357 011 3415**

Versione shtesë: RM 2 R shihni tabelën, faqe 112



RM 3 RT

163 cm³ • 2.4 kW / 3.3 hp • 30.0 kg[Ⓞ]

Korrëse shumëfunktionale për plehërim të tokës, e lehtë në manovrim, me shkarkim anësor dhe gjerësi prerjeje 48 cm për zona me sipërfaqe më të mëdha. Me strukturë me tre rrota, ku një prej të cilave është drejtuese. Me përshtatje të lartësisë prerëse nga rrota në anën e përparme, dhe nga boshti në anën e pasme. Me dorezë shumë të butë dhe drejtim me një marsh, i cili mundëson punë të rehatshme.

Nr. i porosisë **6361 011 3415**



KARBURANTE DHE LUBRIFIKANTË TË PËRSHTATSHËM

SHIHNI NGA FAQJA 262

C = Versioni Komfort
R = Korrje për plehërim të tokës
T = Drejtim me 1 marsh

Ⓞ Peshë neto, pa përfshirë karburantin dhe lubrifikantët

KORRËSE BARI ME BATERI

- Për kopshtarë dhe përdorues profesionistë për mirëmbajtjen e tokës
- Punë pa zhurmë dhe pa emetime, falë baterive STIHL me jone litiumi
- Shumë fleksible dhe të thjeshta në manovrim
- Korrje pa kabëll dhe fleksible



AKM SYSTEM
AK 20

RMA 235

36 V • 14.0 kg[Ⓞ]



Korrëse bari me bateri, shumë e lehtë, thjeshtësisht e manovrueshme me një gjerësi prerjeje 33 cm për hapësira të vogla lëndine. Me kontroll automatik shpejtësie dhe thikë të optimizuar për jetëgjatësi baterie më të madhe. Ofron përshtatje qendrore të gjatësisë së prerjes. Me timon drejtues të palosshëm në 2 nivele të rregullueshme gjatësie, me kosh grumbullues prej 30 litrash, të palosshëm, si edhe me treguesin e nivelit të mbushjes së tij.

RMA 235 pa baterinë dhe karikuesin

Nr. i porosisë **6311 011 1410**

RMA 235 set me AK 20 dhe AL 101

Nr. i porosisë **6311 200 0010**

RMA 235 set me AK 30 dhe AL 101

Nr. i porosisë **6311 200 0007**



AKM SYSTEM
AK 20

RMA 339 C

36 V • 16.0 kg[Ⓞ]



Korrëse bari me bateri, shumë e lehtë, thjeshtësisht e manovrueshme, me një gjerësi prerjeje prej 37 cm, për hapësira lëndine nga ato me përmasa të vogla deri në ato me përmasa mesatare. Me kontroll automatik shpejtësie dhe thikë të optimizuar për jetëgjatësi baterie më të madhe. Ofron përshtatje qendrore të gjatësisë së prerjes, si edhe dorezë timoni të rehatshme dhe të rregullueshme sipas gjatësisë. Përfshin koshin grumbullues prej 40 litrash, të palosshëm, si edhe treguesin e nivelit të mbushjes së tij.

RMA 339 C pa baterinë dhe karikuesin

Nr. i porosisë **6320 011 1420**

RMA 339 set C me AK 20 dhe AL 101

Nr. i porosisë **6320 011 1442**

RMA 339 set C me AK 30 dhe AL 101

Nr. i porosisë **6320 011 1443**

Versione shtesë: RMA 339 shihni tabelën, faqe 114

Ⓞ Peshë pa përfshirë baterinë

Ⓢ Shpjegimi i simboleve në faqen 375



ERE -
E DISPONUESHME
NGA PRANVERA
E VITIT 2021
RMA 443 PV
36 V • 24.0 kg^①

Korrëse bari me bateri, e zhdërvjellët, me gjerësi prerjeje 41 cm për sipërfaqe mesatare. Rregullues qendror i gjatësisë së prerjes dhe timon që përshtatet dhe paloset. Me thika optimale për prerje dhe kohëzgjatje të konsiderueshme të baterisë. Me drejtim elektrik të rrotave për punë komforte. Shpejtësia maksimale e punës mund të përshtatet në 6 nivele me levën që ndodhet në timon. Me dy vende aktive për baterinë. Përfshihet koshi grumbullues i barit prej 55 litrash që mund të paloset dhe treguesi i nivelit të mbushjes së tij.

RMA 443 PV pa baterinë dhe karikuesin
Nr. i porosisë **6338 011 1435**

RMA 443 PV set me AP 200 dhe AL 300
Nr. i porosisë **6338 200 0072**

Versione shtesë: RMA 443, RMA 443 C, RMA 443 VC
Shihni tabelën në faqen 114



ERE -
E DISPONUESHME
NGA PRANVERA
E VITIT 2021
RMA 448 PV
36 V • 24.0 kg^①

Korrëse bari me rendiment të lartë me bateri, gjerësi prerjeje 46 cm për sipërfaqe mesatare. Me rregullues qendror të gjatësisë së prerjes dhe timon që përshtatet dhe paloset. Me thika optimale për prerje dhe kohëzgjatje të konsiderueshme të baterisë. Me drejtim elektrik të rrotave për punë komforte. Shpejtësia maksimale e punës mund të përshtatet në 6 nivele me levën që ndodhet në timon. Me dy vende aktive për baterinë. Përfshihet koshi grumbullues i barit prej 55 litrash që mund të paloset dhe treguesi i nivelit të mbushjes së tij.

RMA 448 PV pa baterinë dhe karikuesin
Nr. i porosisë **6358 011 1435**

RMA 448 PV set me AP 300 dhe AL 300
Nr. i porosisë **6358 200 0028**

Versione shtesë: RMA 448 VC Shihni tabelën në faqen 114

C = Versioni Komfort
P = Performanca
V = Shpejtësi variable "Vario"

① Peshë pa përfshirë baterinë
② Shpjegimi i simboleve në faqen 375

KORRËSE BARI ELEKTRIKE

- Për përdorues shtëpiakë
- Për mirëmbajtjen e lëndinave me sipërfaqe mesatare dhe të madhe
- Motorë elektrikë me kapacitet të lartë
- Funksionim pa zhurmë
- Peshë e lehtë për transportim të thjeshtë



RME 235
1.2 kW • 13.0 kg

Korrëse bari elektrike, e lehtë dhe kompakte, me një gjerësi prerjeje 33 cm për lëndina të vogla. Me përshtatje qendrore të lartësisë së prerjes, si edhe me dorezë të palosshme dhe të rehatshme me gjatësi të rregullueshme në 2 nivele. Përfshin koshin grumbullues të barit prej 30 litrash dhe treguesin e nivelit të mbushjes së tij.

Nr. i porosisë **6311 011 2410**



RME 443 C
1.5 kW • 21.0 kg

Korrëse bari elektrike, e lehtë dhe kompakte, me një gjerësi prerjeje 41 cm për lëndina mesatare. Me përshtatje qendrore të lartësisë së prerjes, si edhe me dorezë të palosshme dhe të rehatshme me gjatësi të rregullueshme në 2 nivele. Përfshin koshin grumbullues të barit prej 55 litrash dhe treguesin e nivelit të mbushjes së tij.

Nr. i porosisë **6338 011 2415**

Versione shtesë: RME 443 shihni tabelën, faqe 114



RME 339 C
1.2 kW • 15.0 kg

Korrëse bari elektrike, e lehtë dhe kompakte, me një gjerësi prerjeje 37 cm për lëndina të vogla. Me përshtatje qendrore të lartësisë së prerjes, si edhe me dorezë të rehatshme me gjatësi të rregullueshme në 2 nivele. Përfshin koshin grumbullues të barit prej 40 litrash dhe treguesin e nivelit të mbushjes së tij.

Nr. i porosisë **6320 011 2415**

Versione shtesë: RME 339 shihni tabelën, faqe 114

AKSESORË PËR KORRËSE ME SHTYRJE

- Set zgjatues për kapje dhe plehërim të tokës
- Pajisje për ta bërë punën më të thjeshtë
- Mjete mbrojtëse



SET PLEHËRIMI

Set plehërimi me shumë tehe dhe komponentë të nevojshëm për plehërim.



AMK 039 për modele me gjerësi prerjeje 37 cm
Nr. i porosisë **6909 007 1081**

AMK 043 për modelet me gjerësi prerjeje 41 cm, përveç korrëseve me bateri RMA 443 VC (6338 011 1430) dhe RMA 443 PV (6338 011 1435)
Nr. i porosisë **6909 007 1083**

AMK 045 për modelet e serisë 5 me gjerësi prerjeje 43 cm
Nr. i porosisë **6909 007 1047**

AMK 048 për modelet me gjerësi prerjeje 46 cm, përveç serisë 2 dhe korrëseve me bateri RMA 448 VC (6358 011 1430) dhe RMA 448 PV (6358 011 1435)
Nr. i porosisë **6909 007 1034**

AMK 056 për modele me benzinë të serisë 7 me gjerësi prerjeje 54 cm
Nr. i porosisë **6909 007 1024**

AMK 065 për RMA 765 V
Nr. i porosisë **6909 007 1063**

SET KAPËS

Veçori të përmirësuara kapëse për lëndina të vështira.



ACK 050 për modele të serisë 6 me gjerësi prerjeje 48 cm
Nr. i porosisë **6909 007 1036**

ACK 055 për modele të serisë 6 me gjerësi prerjeje 53 cm
Nr. i porosisë **6909 007 1037**

ADC 048

Pllakë disku prerës me 4 tehe lëkundëse (Ø 48 cm), për RM 3 RT.

Nr. i porosisë
6909 700 5107



Nr. i porosisë	Lëndina deri në ... (m ²)	Gjerësia e prerjes (cm)	Gjatësia e prerjes (mm)	Funksion plehërimi		Shpejtësia (km/h)	Lloji i motorit	Cilindrata (cm ³)	Fuqia (kW / hp)	Shpejtësia e punës (rpm)	Pesha [ⓐ] (kg)	Fuqia e siguruar e presionit të zërit L _{WA} (dB(A))	Niveli i llogaritur i presionit të zërit L _{pA} (dB(A))	Faktori i pasigurisë në nivelin e presionit të zërit K _{pA} [ⓑ] (dB(A))	Niveli i dridhjes (m/s ²)	Faktori i pasigurisë K [ⓑ] (m/s ²)	Doreza e rehatshme	Koshi grumbullues i barit, me palosje	Përshtatja qendrore e lartësisë së prerjes	Dorezë shumë e butë	Shumë tehe prerës	Bashkimi i funksioneve të teheve prerës me frenat	
				Koshi grumbullues i barit (l)	Funksion plehërimi																		
KORRËSE BARI ME BENZINË																							
RM 248	6350 011 3425	1,200	46	25 - 75 (7x, qendrore)	-	55	-	STIHL EVC 200	139	2.1 / 2.8	2,800	26.0	96	83	2	4.00	2.00	-	-	●	-	-	-
RM 248 T	6350 011 3450	1,200	46	25 - 75 (7x, qendrore)	-	55	T / 3.7	STIHL EVC 200	139	2.1 / 2.8	2,800	28.0	96	82	2	4.85	2.43	-	-	●	-	-	-
RM 253	6371 011 3425	1,800	51	25 - 75 (7x, qendrore)	-	55	-	STIHL EVC 200	139	2.1 / 2.8	2,800	27.0	98	85	2	5.00	2.50	-	-	●	-	-	-
RM 253 T	6371 011 3430	1,800	51	25 - 75 (7x, qendrore)	-	55	T / 3.7	STIHL EVC 200	139	2.1 / 2.8	2,800	29.0	98	85	2	5.00	2.50	-	-	●	-	-	-
RM 443 T	6338 011 3415	1,200	41	25 - 75 (6x, qendrore)	○	55	T / 3.5	Seria B&S 575 EX OHV RS	140	2.1 / 2.8	2,800	25.0	94	81	2	4.10	2.05	-	●	●	●	-	-
RM 448 T	6358 011 3411	1,200	46	25 - 75 (6x, qendrore)	○	55	T / 3.5	Seria B&S 575 EX OHV RS	140	2.1 / 2.8	2,800	26.0	96	83	2	3.90	1.95	-	●	●	●	-	-
RM 448 VC	6358 011 3451	1,200	46	25 - 75 (6x, qendrore)	○	55	V / 2.4 - 4.6	Seria B&S 625 E OHV RS	150	2.2 / 3.0	2,800	28.0	96	83	2	3.00	1.50	●	●	●	-	-	-
RM 448 TC	6358 011 3421	1,200	46	25 - 75 (6x, qendrore)	○	55	T / 3.5	Seria B&S 575 EX OHV RS	140	2.1 / 2.8	2,800	27.0	96	83	2	3.50	1.75	●	●	●	-	-	-
RM 448 TX	6358 011 3431	1,200	46	25 - 75 (6x, qendrore)	○	55	T / 3.5	Seria B&S 550 EX OHV RS	140	2.1 / 2.8	2,800	26.0	96	83	2	4.10	2.05	-	●	●	●	-	-
RM 448 PC	6358 011 3471	1,200	46	25 - 75 (6x, qendrore)	○	55	T / 3.5	Seria B&S 625 E OHV RS	150	2.2 / 3.0	2,800	27.0	96	83	2	3.00	1.50	●	●	●	-	-	-
RM 545	6340 011 3402	1,200	43	25 - 80 (7x, qendrore)	○	60	-	Seria B&S 650 EXi OHV	163	2.4 / 3.3	2,800	27.0	95	82	2	4.10	2.05	-	●	●	-	-	-
RM 545 T	6340 011 3407	1,200	43	25 - 80 (7x, qendrore)	○	60	T / 3.6	Seria B&S 650 EXi OHV	163	2.4 / 3.3	2,800	29.0	95	82	2	4.10	2.05	-	●	●	-	-	-
RM 545 V	6340 011 3417	1,200	43	25 - 80 (7x, qendrore)	○	60	V / 2.2 - 3.8	Seria B&S 650 EXi OHV	163	2.4 / 3.3	2,800	29.0	95	82	2	4.10	2.05	-	●	●	-	-	-
RM 545 YE	6340 011 3427	1,200	43	25 - 80 (7x, qendrore)	○	60	V / 2.2 - 3.8	Seria B&S 675 InStart OHV	163	2.6 / 3.5	2,800	31.0	96	83	2	4.10	2.05	-	●	●	-	-	-
RM 650 V	6364 011 3401	2,000	48	25 - 85 (7x, qendrore)	●	70	V / 2.6 - 4.6	Seria Kohler HD 775 OHV SC	173	2.6 / 3.5	2,800	46.0	95	81	2	3.40	1.70	●	●	●	●	●	-
RM 650 T	6364 011 3441	2,000	48	25 - 85 (7x, qendrore)	●	70	T / 3.5	Seria Kohler HD 775 OHV SC	173	2.6 / 3.5	2,800	45.0	95	81	2	3.40	1.70	●	●	●	●	●	-
RM 650 VE	6364 011 3451	2,000	48	25 - 85 (7x, qendrore)	●	70	V / 2.6 - 4.6	Seria B&S 675 InStart OHV	163	2.6 / 3.5	2,800	43.0	96	82	2	3.40	1.70	●	●	●	●	●	-
RM 756 GS	6378 011 3411	3,000	54	25 - 90 (6x, single-wheel)	○	80	G / 2.5 / 3.7 / 5	Kawasaki FJ 180 V KAI OHV	179	2.9 / 3.9	2,800	60.0	98	86	2	2.40	1.20	-	-	-	●	-	●
RM 756 GC	6378 011 3431	3,000	54	25 - 90 (6x, single-wheel)	○	80	G / 2.5 / 3.7 / 5	Kawasaki FJ 180 V KAI OHV	179	2.9 / 3.9	2,800	60.0	98	86	2	2.40	1.20	●	-	-	●	-	●
RM 756 YS	6378 011 3401	3,000	54	25 - 90 (6x, single-wheel)	○	80	Y / 0.5 - 6	Kawasaki FJ 180 V KAI OHV	179	2.9 / 3.9	2,800	60.0	98	86	2	2.40	1.20	-	-	-	●	-	●
RM 756 YC	6378 011 3421	3,000	54	25 - 90 (6x, single-wheel)	○	80	Y / 0.5 - 6	Kawasaki FJ 180 V KAI OHV	179	2.9 / 3.9	2,800	61.0	98	86	2	2.40	1.20	●	-	-	●	-	●
RM 2 R	6357 011 3406	1,500	46	28 - 85 (4x, by axle)	●	-	-	STIHL EVC 200	139	2.1 / 2.8	2,800	23.0	94	81	2	7.90	3.16	-	-	-	-	-	-
RM 2 RT	6357 011 3415	1,500	46	28 - 85 (4x, by axle)	●	-	T / 3.5	Seria Kohler HD 675 OHV SC	149	2.2 / 3.0	2,800	30.0	94	81	2	5.90	2.36	-	-	-	-	-	●
RM 3 RT	6361 011 3415	2,000	48	25 - 80 (5x, axle, single-wheel)	●	-	T / 3.5	Seria B&S 650 EXi OHV	163	2.4 / 3.3	2,800	30.0	96	82	2	4.80	2.40	-	-	-	-	-	●

● E pajisur si standard
○ I modernizuar (si aksesor)

Llojet e motorit
B&S = Briggs&Stratton
RS = ReadyStart
SC = SmartChoke
OHV/DOV = Valvula ajrore

Strukturat e modeleve
C = Versioni komfort
E = ElectroStart
G = Drejtim me 3 marshe
P = Performanca

S = Bashkimi i funksioneve të teheve prerës me frenat
T = Drejtim me 1 marsh

V = Shpejtësi variable "Vario"
X = Model ekonomik
Y = Me drejtim hidrostatik

ⓐ Pesha neto pa përfshirë karburantin dhe lubrifikantët
ⓑ K_{pA}/K faktorët e pasigurisë në përshtatje me Dir. 2006/42/ECRS

	Nr. i porosisë	Lëndina deri në ... (m ²)	Gjerësia e prerjes (cm)	Gjatësia e prerjes (mm)	Funksion plehërimi	Koshi grumbullues i barit (l)	Shpejtësia (km/h)		Lloji i baterisë	Fuqia (W)	Shpejtësia e punës (rpm)	Pesha (kg)	Fuqia e siguruar e presionit të zërit L _{WA} (dB(A))	Niveli i llogaritur i presionit të zërit L _{PA} (dB(A))	Faktori i pasigurisë në nivelin e presionit të zërit K _{PA} (dB(A))	Niveli i dridhjes (m/s ²)	Faktori i pasigurisë K [Ⓞ] (m/s ²)	Mënyra Eco	Doreza e rehatshme	Koshi grumbullues i barit, me palosje	Përshtatja qendrore e lartësisë së prerjes	Teh me qarkullim të optimizuar	Dorzë shumë e butë
KORRËSE BARI ME BATERI																							
RMA 235	6311 011 1410	-	33	25 - 65 (5x, qendrore)	-	30	-	Bateri AK	-	3,400	14.0 [Ⓞ]	89	76	2	1.80	0.90	● [Ⓞ]	-	●	●	●	-	
RMA 235 set me AK 20 + AL 101	6311 200 0010	300 [Ⓞ]	33	25 - 65 (5x, qendrore)	-	30	-	Bateri AK	-	3,400	15.0 [Ⓞ]	89	76	2	1.80	0.90	● [Ⓞ]	-	●	●	●	-	
RMA 235 set me AK 30 + AL 101	6311 200 0007	400 [Ⓞ]	33	25 - 65 (5x, qendrore)	-	30	-	Bateri AK	-	3,400	15.0 [Ⓞ]	89	76	2	1.80	0.90	● [Ⓞ]	-	●	●	●	-	
RMA 339	6320 011 1415	-	37	30 - 70 (5x, qendrore)	○	40	-	Bateri AK	-	3,350	14.0 [Ⓞ]	90	76	2	1.60	0.80	●	-	●	●	●	-	
RMA 339 set me AK 20 + AL 101	6320 011 1440	250 [Ⓞ]	37	30 - 70 (5x, qendrore)	○	40	-	Bateri AK	-	3,350	15.0 [Ⓞ]	90	76	2	1.60	0.80	●	-	●	●	●	-	
RMA 339 set me AK 30 + AL 101	6320 011 1441	330 [Ⓞ]	37	30 - 70 (5x, qendrore)	○	40	-	Bateri AK	-	3,350	15.0 [Ⓞ]	90	76	2	1.60	0.80	●	-	●	●	●	-	
RMA 339 C	6320 011 1420	-	37	30 - 70 (5x, qendrore)	○	40	-	Bateri AK	-	3,350	16.0 [Ⓞ]	90	76	2	1.60	0.80	●	●	●	●	●	-	
RMA 339 C set me AK 20 + AL 101	6320 011 1442	250 [Ⓞ]	37	30 - 70 (5x, qendrore)	○	40	-	Bateri AK	-	3,350	17.0 [Ⓞ]	90	76	2	1.60	0.80	●	●	●	●	●	-	
RMA 339 C set me AK 30 + AL 101	6320 011 1443	330 [Ⓞ]	37	30 - 70 (5x, qendrore)	○	40	-	Bateri AK	-	3,350	17.0 [Ⓞ]	90	76	2	1.60	0.80	●	●	●	●	●	-	
RMA 443	6338 011 1401	-	41	25 - 75 (6x, qendrore)	○	55	-	Bateri AP	-	3,150	20.0 [Ⓞ]	92	78	2	1.80	0.90	●	-	●	●	●	-	
RMA 443 C	6338 011 1411	-	41	25 - 75 (6x, qendrore)	○	55	-	Bateri AP	-	3,150	21.0 [Ⓞ]	92	78	2	1.40	0.70	●	●	●	●	●	-	
E RE RMA 443 C set me AP 200 + AL 300	6338 200 0048	360 [Ⓞ]	41	25 - 75 (6x, qendrore)	○	55	-	Bateri AP	-	3,150	22.0 [Ⓞ]	92	78	2	1.40	0.70	●	●	●	●	●	-	
E RE[Ⓞ] RMA 443 VC	6338 011 1430	-	41	25 - 75 (6x, qendrore)	-	55	V / 2,0 - 4.5	Bateri AP	-	3,150	23.0 [Ⓞ]	91	77	2	1.80	0.90	●	●	●	●	●	-	
E RE[Ⓞ] RMA 443 PV	6338 011 1435	-	41	25 - 75 (6x, qendrore)	-	55	V / 2,0 - 4.5	Bateri AP	-	3,150	24.0 [Ⓞ]	91	77	2	1.80	0.90	●	●	●	●	●	-	
E RE[Ⓞ] RMA 443 PV set me AP 200 + AL 300	6338 200 0072	420 [Ⓞ]	41	25 - 75 (6x, qendrore)	-	55	V / 2,0 - 4.5	Bateri AP	-	3,150	25.0 [Ⓞ]	91	77	2	1.80	0.90	●	●	●	●	●	-	
E RE[Ⓞ] RMA 448 VC	6358 011 1430	-	46	25 - 75 (6x, qendrore)	-	55	V / 0 - 4.5	Bateri AP	-	3,150	24.0 [Ⓞ]	95	82	2	1.80	0.90	●	●	●	●	●	-	
E RE[Ⓞ] RMA 448 PV	6358 011 1435	-	46	25 - 75 (6x, qendrore)	-	55	V / 2,0 - 4.5	Bateri AP	-	3,150	24.0 [Ⓞ]	95	82	2	1.80	0.90	●	●	●	●	●	-	
E RE[Ⓞ] RMA 448 PV set me AP 300 + AL 300	6358 200 0028	400 [Ⓞ]	46	25 - 75 (6x, qendrore)	-	55	V / 2,0 - 4.5	Bateri AP	-	3,150	26.0 [Ⓞ]	95	82	2	1.80	0.90	●	●	●	●	●	-	
KORRËSE BARI ELEKTRIKE																							
RME 235	6311 011 2410	300	33	25 - 60 (5x, qendrore)	-	30	-	-	1,200	3,200	13.0	93	80	2	1.40	0.70	-	-	●	●	-	-	
RME 339	6320 011 2405	500	37	30 - 70 (5x, qendrore)	○	40	-	-	1,200	3,200	14.0	93	79	1	0.82	0.41	-	-	●	●	-	-	
RME 339 C	6320 011 2415	500	37	30 - 70 (5x, qendrore)	○	40	-	-	1,200	3,200	15.0	93	79	1	0.50	0.25	-	●	●	●	-	-	
RME 443	6338 011 2405	600	41	25 - 75 (6x, qendrore)	○	55	-	-	1,500	2,900	19.0	96	82	2	1.40	0.70	-	-	●	●	-	-	
RME 443 C	6338 011 2415	600	41	25 - 75 (6x, qendrore)	○	55	-	-	1,500	2,900	21.0	96	82	2	1.30	0.65	-	●	●	●	-	-	

● E pajisur si standard
○ I modernizuar (si aksesor)
C = Versioni komfort
P = Performanca
V = Shpejtësi variable "Vario"

Ⓞ K_{PA}/K faktori i pasigurisë në përshtatje me Dir. 2006/42/ECRS
Ⓞ Mbulimi i sipërfaqes nga një sesion karikimi i baterisë në kushte optimale. Përveç llojit të baterisë së përdorur, faktorë të tjerë ndikojnë mbulimin real të sipërfaqes së barit, si psh. karakteristikat e sipërfaqes së lëndinës (pengesat, gjeometria), gjatësia e barit dhe niveli i lagështisë, shpejtësia e punës, plehërimi, etj. Mbulimi i sipërfaqes mund të rritet duke rikarikuar baterinë ose duke përdorur shumë bateri të karikueshme.

Ⓞ Pesha pa përfshirë baterinë
Ⓞ Pesha duke përfshirë baterinë dhe duke përjashtuar karikuesin
Ⓞ Mënyra Eco nuk mund të fiket tek RMA 235
Ⓞ E disponueshme nga pranvera e vitit 2021

DETAJET E TRAKTORËVE KORRËS

04 POZICION ULJE SHUMË I REHATSHËM

06 ZBRAZJE PRAKTIKE



03 PUNË PRECIZE

01 FUQI KONSTANTE

05 SHPEJTËSI INTUITIVE NË DREJTIM

02 AKTIVIZIM I THJESHTË I TEHEVE PRERËS

TEKNOLOGJIA

01 NJËSIA E SINKRONIZUAR KORRËSE

Dy tehet prerëse të njësisë së sinkronizuar korrëse janë vendosur në 90°. Sinkronizimi i tyre rezulton në ndërthurjen pa kontakt të teheve prerëse, që do të thotë cilësi prerjeje konsistente dhe transportim optimal i barit në kanalën e shkarkimit.

02 FRIKSIONI ELEKTROMAGNETIK I TEHEVE

Tehet e njësisë korrëse mund të fikën dhe ndizen lehtësisht nga sedilja e shoferit.

03 SISTEM UDHËZUES I BARIT

Kap barin edhe në cepa dhe e drejton atë drejt teheve prerëse, në mënyrë që cepat të priten në mënyrë shumë precize.

KOMFORTI

04 SEDILJE E MONTUAR ME SUSTA DHE E RREGULLUESHME

Pozicioni i uljes mund të rregullohet individualisht në pothuajse çdo gjatësi përdoruesi, pa patur nevojë për mjete shtesë.

05 DREJTIMI I PAJISJES STIHL ME NJË PEDALE TË VETME

Mundëson manovrim të shpejtë në sajë të ndërrimit të lehtë midis marshit të përpara dhe të pasëm, duke përdorur levën e dorës. Pedalja sensitive ndaj presionit lejon për rregullime të vogla të shpejtësisë ndërmjet shpejtësisë maksimale dhe asaj fikse. Pedalja e veçantë e frenave mund të përdoret për të ndaluar mjetin në mënyrë direkte.

06 ZBRAZJE E LEHTË

Koshi plastik grumbullues i barit në strukturën e lopatës së ekskavatorit mundëson zbrazje të lehtë nga sedilja e shoferit dhe struktura e tij inteligjente e bën shumë të thjeshtë pastrimin e tij.

Lutemi vini re se jo të gjitha produktet janë të pajisura me të gjitha veçoritë e prezantuara këtu. Vetëm karakteristikat më të rëndësishme janë përshkruar në këtë faqe. Për më shumë shpjegime dhe informacione, shihni nga faqja 374 ose në faqen e internetit www.stihl.com.

TRAKTORË KORRËS TË SERISË T4

- Për përdorues shtëpiakë, si edhe mirëmbajtje profesionale
- Shumë të lehtë në manovrim
- Shkarkim anësor kompakt - pa përfshirë modelin RT 4082
- Performancë e lartë korrëse në sajë të gjerësive prerëse



RT 4082

452 cm³ • 8,2 kW / 11,1 hp • 202,0 kg[Ⓞ]

Traktor korrës kompakt, i lehtë në manovrim dhe gjithashtu i rehatshëm në përdorim. Për mirëmbajtjen e sipërfaqeve të mëdha të lëndinave me shumë kënde të vështira. Përfshin drejtimin STIHL me një pedale të vetme.

Nr. i porosisë 6140 200 0005



RT 4097 SX

452 cm³ • 8,9 kW / 12,1 hp • 202,0 kg[Ⓞ]

Traktor korrës me shkarkim anësor, i cili ofron një përdorim të rehatshëm dhe të thjeshtë. Përfshin drejtimin STIHL me një pedale të vetme për manovrim të lehtë.

Nr. i porosisë 6165 200 0012



RT 4112 SZ

656 cm³ • 9,3 kW / 11,6 hp • 224,0 kg[Ⓞ]

Traktor korrës me shkarkim anësor, i cili ofron një përdorim të lehtë dhe të rehatshëm. Për mirëmbajtjen e sipërfaqeve shumë të mëdha me bar. Përfshin drejtimin STIHL me një pedale të vetme.

Nr. i porosisë 6165 200 0013

S = Shkarkim anësor
X = Model ekonomik
Z = Motor me 2 cilindra

Ⓞ Peshë neto pa përfshirë karburantin dhe lubrifikantët

TRAKTORË KORRËS TË SERISË T5

- Për përdorues shtëpiakë, si edhe mirëmbajtje profesionale
- Performancë e lartë korrëse në sajë të gjerësive prerëse
- Motor me 1 cilindër ose 2 cilindra
- Koshi grumbullues i barit me kapacitet deri në 350 litra



RT 5097 Z

656 cm³ • 8.7 kW / 11.8 hp • 236.0 kg[Ⓞ]

Traktor i fuqishëm korrës, i cili është shumë i rehatshëm gjatë përdorimit. Për mirëmbajtjen e sipërfaqeve të mëdha të barit. Me drejtim STIHL me një pedale të vetme dhe kosh grumbullues të barit me kapacitet 250 litra.

Nr. i porosisë **6160 200 0024**

Versione shtesë: RT 5097 shihni tabelën, faqe 122



RT 5112 Z

656 cm³ • 8.7 kW / 11.8 hp • 246.0 kg[Ⓞ]

Traktor i fuqishëm korrës, i cili është shumë i rehatshëm gjatë përdorimit. Për mirëmbajtjen e sipërfaqeve shumë të mëdha të barit. Me drejtim STIHL me një pedale të vetme dhe kosh grumbullues të barit me kapacitet 350 litra.

Nr. i porosisë **6160 200 0025**

Z = Motor me 2 cilindra
L = Veçori luksoze (kontroll në drejtim)
Ⓞ Peshë neto pa përfshirë karburantin dhe lubrifikantët

TRAKTORË KORRËS TË SERISË T6

- Për përdorues shtëpiakë ambiciozë, si edhe mirëmbajtje profesionale
- Performancë maksimale korrëse në sajë të gjerësive prerëse shumë të mëdha
- Kontroll në drejtim
- Njësi e sinkronizuar korrje



RT 6112 ZL

656 cm³ • 8.7 kW / 11.8 hp • 263.0 kg[Ⓞ]

Traktor i fuqishëm korrës, i cili është jashtëzakonisht i rehatshëm gjatë përdorimit. Për mirëmbajtjen e sipërfaqeve shumë të mëdha të barit. Me drejtim STIHL me një pedale të vetme dhe kosh grumbullues të barit me kapacitet 350 litra.

Nr. i porosisë **6170 200 0029**



RT 6127 ZL

724 cm³ • 14.7 kW / 20.0 hp • 269.0 kg[Ⓞ]

Traktor korrës, shumë i fuqishëm, i cili është jashtëzakonisht i rehatshëm gjatë përdorimit. Për mirëmbajtjen e sipërfaqeve veçanërisht të mëdha të barit. Me drejtim STIHL me një pedale të vetme dhe kosh grumbullues të barit me kapacitet 350 litra.

Nr. i porosisë **6170 200 0030**

AKSESORËT PËR TRAKTORËT KORRËS

- Pajisje shtesë gjatë korrjes së barit
- Për përdorim në dimër
- Për mbrojtje nga moti



SET PLEHËRIMI

Set pajisjesh shtesë për prerjet e plehërimit.



AMK 082 Shumë tehe prerëse dhe pajisje plehërimi për një gjerësi prerjeje 80 cm për RT 4082
Nr. i porosisë **6907 007 1024**

AMK 097 Pajisje plehërimi për një gjerësi prerjeje 95 cm, për modele të veçanta të serisë T5
Nr. i porosisë **6907 007 1029**

AMK 097 S Pajisje plehërimi për një gjerësi prerjeje 95 cm, për modele të veçanta të serisë T4
Nr. i porosisë **6907 007 1012**

AMK 112 S Pajisje plehërimi për një gjerësi prerjeje 110 cm, për modele të veçanta të serisë T4
Nr. i porosisë **6907 007 1014**

AMK 127 Pajisje plehërimi për një gjerësi prerjeje 110 cm dhe 125 cm, për modele të veçanta të serive T5 dhe T6
Nr. i porosisë **6907 007 1032**

ZINXHIRA BORE

Për përdorim të sigurt në sipërfaqe me borë.



ASK 016 për RT 4082
Nr. i porosisë **6907 730 3445**

ASK 018 për RT 4097 SX, RT 5097, RT 5097 Z dhe RT 5112 Z
Nr. i porosisë **6907 730 3432**

ASK 020 për RT 4112 SZ, RT 6112 ZL dhe RT 6127 ZL
Nr. i porosisë **6907 730 3437**

DEFLEKTOR

Për shkarkim të pasëm të prerjeve.



ADF 400 për RT 4082
Nr. i porosisë **6907 760 6926**

ADF 500 për seritë T5 dhe T6
Nr. i porosisë **6907 760 6931**

SET PASTRUES BORE

Pajisje shtesë për pastrimin e borës me rregullim të thjeshtë, gjatësi praktike dhe anësore nga sedilja e shoferit.



ASP 100 100 cm gjerësi e pastruesit të borës, për RT 4082
Nr. i porosisë **6907 730 3012**

ASP 125 125 cm gjerësi e pastruesit të borës për seritë T4 (duke përfshirë RT 4082), T5 dhe T6.
Nr. i porosisë **6907 730 3018**

MBULESË PËR MAGAZINIM

Për përdorim gjatë magazinimit, mbron kundër papastërtive dhe elementeve përçark.



AAH 200 për serinë T4
Nr. i porosisë **6907 900 3506**

AAH 300 për seritë T5 dhe T6
Nr. i porosisë **6907 700 2101**

FH 010

Karikues për mirëmbajtje, për të gjitha bateritë e traktorëve korrës.



Nr. i porosisë **6907 430 2520**

ADL 012

Karikues diagnostikues për të gjithë traktorët korrës; për karikim të optimizuar dhe riaktivizim të baterive 12 V.



Nr. i porosisë **6907 430 2507**

AGW 098

Rrotull kopshti, 98 cm e gjerë, për të gjithë traktorët korrës.



Nr. i porosisë **6907 760 3601**

APU 300


Karrocë tërheqëse për transportim fleksibël në kopsht dhe mund të përdoret edhe si karrocë dore. Kapaciteti 150 litra.



Nr. i porosisë **6907 730 5003**

Nr. i porosisë

		Lëndina deri në ... (m ²)	Gjerësia e prerjes (cm)	Gjatësia e prerjes (mm)	Funksioni i plehërimit	Koshi grumbullues i barit (l)	Transmisioni	Kapaciteti i serbatorit (l)	Lloji i motorit	Cilindrata (cm ³)	Fuqia (kw/hp)	Shpejtësia e punës (rpm)	Pajisja Gjerësi x Gjatësi x Lartësi (cm)	Pesha ^① (kg)	Fuqia e siguruar e presionit të zërit L _{WA} (dB(A))	Niveli i llogaritur i presionit të zërit L _{PA} (dB(A))	Faktori i pasigurisë në nivelin e presionit të zërit K _{PA} ^② (dB(A))	Niveli i dridhjes (m/s ²)	Faktori i pasigurisë K ^③ (m/s ²)	Drejtim me një pedale të vetme	Njësi e sinkronizuar korrëse	Friksion elektromagnetik i teheve prerës	Sistemi i udhëzimit të barit	Sedilje e rregullueshme, e montuar me susta	Shkarkim anësor	Zbraze e thjeshtë e koshit grumbullues të barit	Kontroll në drejtim
TRAKTORË KORRËS																											
RT 4082	6140 200 0005	4,000	80	35 - 90	o	250	Hidrostatik	6	STIHL EVC 4000	452	8.2 / 11,1	2,700	213 × 90 × 117	202.0	100	86	2	0.60 / 3.00	0.30 / 1.50	●	-	●	●	●	-	●	-
RT 4097 SX	6165 200 0012	6,000	95	35 - 90	o	-	Hidrostatik	9	STIHL EVC 4000	452	8.9 / 12.1	3,100	191 × 116 × 115	202.0	100	85	2	0.50 / 2.80	0.25 / 1.40	●	-	●	●	●	●	-	-
RT 4112 SZ	6165 200 0013	8,000	110	35 - 90	o	-	Hidrostatik	9	Seria BS 7160 Intek OHV (2 cilindra)	656	9.3 / 11.6	2,950	191 × 132 × 118	224.0	100	86	1	0.50 / 2.50	0.25 / 1.25	●	-	●	●	●	●	-	-
RT 5097	6160 200 0023	6,000	95	30 - 100	o	250	Hidrostatik	9	STIHL EVC 4000	452	8.2 / 11,1	2,700	242 × 101 × 115	228.0	100	86	2	0.98 / 2.60	0.49 / 1.30	●	-	●	●	●	-	●	-
RT 5097 Z	6160 200 0024	6,000	95	30 - 100	o	250	Hidrostatik	9	Seria BS 7160 Intek OHV (2 cilindra)	656	8.7 / 11.8	2,700	242 × 101 × 116	236.0	100	86	2	0.98 / 2.20	0.49 / 1.10	●	-	●	●	●	-	●	-
RT 5112 Z	6160 200 0025	8,000	110	30 - 100	o	350	Hidrostatik	9	Seria BS 7160 Intek OHV (2 cilindra)	656	8.7 / 11.8	2,700	260 × 117 × 116	246.0	100	86	2	0.98 / 4.40	0.49 / 2.20	●	●	●	●	●	-	●	-
RT 6112 ZL	6170 200 0029	8,000	110	30 - 100	o	350	Hidrostatik	9	Seria BS 7160 Intek OHV (2 cilindra)	656	8.7 / 11.8	2,700	260 × 117 × 118	263.0	100	86	2	0.50 / 4.40	0.25 / 2.20	●	●	●	●	●	-	●	●
RT 6127 ZL	6170 200 0030	10,000	125	30 - 100	o	350	Hidrostatik	9	Seria BS 8240 Intek OHV (2 cilindra)	724	14.7 / 20.0	3,000	260 × 132 × 118	269.0	105	89	2	0.50 / 4.40	0.25 / 2.20	●	●	●	●	●	-	●	●



● E pajisur si standard
o E modernizuar (si aksesor)

Llojet e motorit
B&S = Briggs&Stratton
OHV = Valvula ajrore

Strukturat e modeleve
C = Versioni komfort
L = Veçori luksoze (kontrolli në drejtim)
S = Shkarkim anësor

X = Model ekonomik
Z = Motor B&S me 2 cilindra

① Pesha neto pa përfshirë karburantin dhe lubrifikantët
② K_{PA}/K faktori i pasigurisë në përshtatje me Dir. 2006/42/ECRS
③ Këto vlera i referohen sediljes/timonit respektivisht

DETAJET E PAJISJEVE AJROSËSE



TEKNOLOGJIA

- 01 KAPAK POLIMERI**
Struktura e materialit të teknologjisë së lartë të përdorur për kapakun e polimerit është e lehtë, ndërkohë që është gjithashtu rezistente dhe e fuqishme.
- 02 MOTOR ME SISTEM NDEZJEJE TË THJESHTË**
Falë teknologjisë SmartChoke, motori ndizet me mundim minimal në çdo temperaturë.
- 03 TEKNOLOGJIA STIHL E BATERIVE ME JONE LITIUMI**
Përdorimi i baterive STIHL AK mundëson punë të rehatshme dhe pa zhurmë.
- 04 NJËSIA SHKRIFTUESE/NJËSIA KREHËSE**
Tehet e fiksuar të njësive shkriftuese sigurojnë ventilimin efektiv të lëndinës dhe kanë një strukturë të mprehtë dhe të fuqishme që rezultojnë në punë efikase në mënyrë të vazhdueshme. Rrotulla krehëse përdor dhëmbëzat e saj fleksible për të krehur butësisht materialet e bimëve të vdekura dhe myshkun nga sipërfaqet e lëndinave, pa prerë terrenin përçark.

KOMFORTI

- 05 AKTIVIZIMI I THJESHTË I TEHEVE PRERËSE**
E thjeshtë për t'u ndërruar nga pozicioni i transportimit në pozicionin e punës.
- 06 PËRSHTATJA E THELLËSISË SË PUNËS**
Tek RL 540 dhe RLE 540, thellësia e punës së teheve prerëse mund të përshtatet sipas njërës prej gjashtë niveleve të disponueshme, për t'u përshtatur sipërfaqeve, nëpërmjet dorezës rrotulluese të dizenuar ergonomikisht. Tek RLA 240 dhe RLE 240, thellësia e punës mund të përshtatet në mënyrë pafundësisht të ndryshueshme, duke përdorur çelësin rrotullues tek kapaku. Kjo do të thotë se edhe njësia shkriftuese, bashkë me rrotullën krehëse mund t'i përshtaten sipërfaqeve të ndryshme sipas kërkesës.
- 07 DOREZË ME GJATËSI TË RREGULLUESHME**
Tek RLA 240 dhe RLE 240, doreza mund të përshtatet lehtësisht në katër gjatësi të ndryshme. Gjithashtu, është e palosshme në tre vende, duke mundësuar kështu transportim të thjeshtë dhe magazinim duke kursyer hapësirën.
- 08 KOSHI GRUMBULLUES I BARIT**
Koshi grumbullues i barit prej 50 litrash është i përbërë nga një copë e endur, rezistente ndaj dëmtimeve. Korniza e çeliktë me dorezën mbajtëse sigurojnë qëndrueshmëri dhe rehati në transportim.

Lutemi vini re se jo të gjitha produktet janë të pajisura me të gjitha veçoritë e prezantuara këtu. Vetëm karakteristikat më të rëndësishme janë përshkruar në këtë faqe. Për më shumë shpjegime dhe informacione, shihni nga faqja 374 ose në faqen e internetit www.stihl.com.

PAJISJE AJROSËSE DHE AKSESORËT

- Për përdorues shtëpiakë
- Për të hequr kashtat e lëndinave dhe myshkun
- Për të përmirësuar cilësinë e lëndinës
- E thjeshtë në manovrim



RL 540

149.0 cm³ • 2.2 kW / 3.0 hp • 33.0 kg[ⓐ]

Pajisje e fuqishme ajrosëse me benzinë për shkriftimin e lëndinave me sipërfaqe më të mëdha. Gjerësia e punës 38 cm, me 7 tehe të dyfishta prerëse.

Nr. i porosisë **6290 011 3105**

AKILL
SYSTEM
AK 30



E RE RLA 240

36 V • 15.0 kg[ⓑ]

Pajisje ajrosëse me bateri, kompakte, për shkriftimin dhe krehjen e lëndinave me sipërfaqe më të vogla. Me përshtatës qendror të thellësisë së punës duke përdorur çelësin rrotullues në kapak, dorezë me 4 nivele të rregullueshme gjatësie, gjerësi pune prej 34 cm, 16 tehe prerëse, duke përfshirë një rrotull ventilimi dhe koshin grumbullues të barit prej 50 litrash.

RLA 240 pa baterinë dhe karikuesin

Nr. i porosisë **6291 011 6600**

RLA 240 set me AK 30 dhe AL 101

Nr. i porosisë **6291 200 0000**

ⓐ Peshë neto duke përjashtuar karburantin dhe lubrifikantët

ⓑ Peshë duke përjashtuar baterinë

ⓐ Shpjegimi i simboleve në faqen 375



RLE 240

230 V • 1.5 kW • 16.0 kg

Pajisje kompakte ajrosëse elektrike për shkruftimin dhe krehjen e lëndinave me sipërfaqe më të vogla. Gjerësia e punës 34 cm, me 20 tehe prerëse. Përfshin rrotullën e ventilimit dhe koshin grumbullues.

Nr. i porosisë **6291 011 5610**



RLE 540

230 V • 1.6 kW • 28.0 kg

Pajisje efikase ajrosëse elektrike për shkruftimin e lëndinave me sipërfaqe mesatare. Gjerësia e punës 38 cm, me 7 tehe të dyfishta prerëse.

Nr. i porosisë **6290 011 5610**



AFK 050

Kosh grumbullues me kapacitet 50 litra, për RL 540 dhe RLE 540.

Nr. i porosisë **6910 700 9601**



Nr. i porosisë

Lëndina deri në ... (m²)

Gjerësia e punës (cm)

Rangu i thellësisë së punës (mm)

Koshi grumbullues

Lloji i motorit/lloji i baterisë

Cilindrata (cm³)

Fuqia/Shpejtësia (kW / hp)

Fuqia (W) / Shpejtësia (rpm)

Pesha (kg)

Fuqia e siguruar e presionit të zërit L_{WA} (dB(A))

Niveli i llogarituar i presionit të zërit L_{PA} (dB(A))

Faktori i pasigurisë në nivelin e presionit të zërit^① (dB(A))

Niveli i dridhjes (m/s²)

Faktori i pasigurisë^② (m/s²)

Përshtatja e thellësisë së punës në dorezë/kapak

Rrotulla e ventilimit

PAJISJE AJROSËSE ME BENZINË

RL 540	6290 011 3105	2,000	38	25, 6 nivele të rregullueshme	○ Kohler HD 675 OHV SC	149	2.2 / 3.0	2,800	33.0 ^③	94	81	2	4.12	2.06	● / -	-
---------------	----------------------	-------	----	-------------------------------	------------------------	-----	-----------	-------	-------------------	----	----	---	------	------	-------	---

PAJISJE AJROSËSE ME BATERI

E RE RLA 240	6291 011 6600	-	34	- 7,5 to +7,5 mm qendrore, pafundësisht e ndryshueshme	● bateri AK	-	-	900 / 3,650	15.0 ^③	92	75	3	4.8	2.4	- / ●	●
E RE RLA 240 set me AK 30 + AL 101	6291 200 0000	500 ^③	34	5 to -10 mm qendrore, pafundësisht e ndryshueshme	● bateri AK	-	-	900 / 3,650	16.0	92	75	3	4.8	2.4	- / ●	●

PAJISJE AJROSËSE ELEKTRIKE

RLE 240	6291 011 5610	500	34	- 7,5 to +7,5 mm qendrore, pafundësisht e ndryshueshme	● -	-	-	1,500 / 4,100	16.0	94	78	3	5.80	2.32	- / ●	●
RLE 540	6290 011 5610	800	38	25, 6 nivele të rregullueshme	○ -	-	-	1,600 / 2,840	28.0	89	72	2	1.95	0.98	● / -	-

● E pajisur si standard
○ E modernizuar (si aksesor)

Llojet e motorëve
SC = SmartChoke
OHV = Valvula ajrore

① K_{PA}/K faktori i pasigurisë në përshtatje me Dir. 2006/42/ECRS
② Pesha neto duke përfshirë karburantin dhe lubrifikantët
③ Pesha duke përfshirë baterinë

④ Pesha duke përfshirë baterinë dhe duke përfshirë karikuesin
⑤ Kur përdoret AK 30 me një sesion karikimi, sipërfaqja përpunohet vetëm në një drejtim (pa kalim)

SFIDONI TERRENE TË VËSHTIRA ME LEHTËSI.

MOTOKOSA TË FUQISHME ME BENZINË **131**

MOTOKOSA ME BATERI **136**

MOTOKOSA ELEKTRIKE **138**

MOTOKOSA ME BENZINË QË
MBAHEN NË SHPINË **139**

AKSESORË PËR MOTOKOSA DHE
SHARRA PASTRIMI **140**

VEGLA PRERËSE DHE FIJE KOSITËSE **148**

AKSESORË PËR VEGLAT PRERËSE **156**



DETAJET E MOTOKOSAVE DHE SHARRAVE TË PASTRIMIT



TEKNOLOGJIA

01 MOTOR STIHL 2-MIX

Motori STIHL 2-MIX është i fuqishëm dhe ekonomik. Ndarja e emetimeve të shkarkimit nga gazi i padjegur minimizon humbjet, duke rritur në këtë mënyrë fuqinë e punës dhe duke ulur konsumin.

02 STIHL M-TRONIC (M)

Në ndezje të ftohta me STIHL M-Tronic, ju duhet vetëm një pozicion ndezje në levën kombi. Pas ndezjes, mund të kaloni direkt në përdorim me shpejtësi maksimale. Sasia e nevojitur e karburantit llogaritet në mënyrë precize nga sistemi dhe furnizohet sipas nevojës. Përndryshe, ndizeni në pozicionin I, si zakonisht.



KOMFORTI

03 STIHL ERGOSTART (E)

Siguron ndezje të lehtë dhe të pamundimshme, pa patur nevojë për të tërhequr dhe tundur fort kordonin - susta midis boshtit motorik dhe kordonit të ndezësit bën pjesën tjetër të punës gjatë ndezjes.

04 SISTEMI STIHL KUNDËR DRIDHJES

E bën mjetin e punës të rehatshëm për t'u përdorur. Elementet e amortizatorit dhe sustës reduktojnë transferimin e dridhjeve të motorit. E disponueshme si standard me versionin 1-pikësh dhe nga FS 311 gjithashtu disponohet si version 4-pikësh.

05 DOREZË SHUMËFUNKSIONALE

Përdorim i lehtë dhe i besueshëm: gjithë funksionet e kontrollit të motorit, duke përfshirë funksionin e pjesshëm të ngarkesës ECOSPEED, mund të kontrollohen vetëm me një dorë.

Lutemi vini re se jo të gjitha produktet janë të pajisura me të gjitha veçoritë e prezantuara këtu. Vetëm karakteristikat më të rëndësishme janë përshkruar në këtë faqe. Për më shumë shpjegime dhe informacione, shihni nga faqja 374 ose në faqen e internetit www.stihl.com.

MOTOKOSA ME BENZINË PËR SHKURTIMIN E BARIT

- Vegla të fuqishme për përdorues privatë pa përvojë
- Për kositjen e sipërfaqeve të vogla të barit
- Për kositje në anë të kopshtit
- Të lehta për t'u ndezur
- Me bosht të lakuar ose të drejtë



FS 38

27.2 cm³ • 0.65 kW / 0.9 hp • 4.2 kg[Ⓞ]

Motokosa më e lehtë në gamën e STIHL. Ideale për të shkurtuar barin nëpër cepa. E pajisur me dorezë shumëfunktionale, dorezë të rrumbullakët dhe motor 2-MIX.

Nr. i porosisë
4140 012 2353




FS 55 R

27.2 cm³ • 0.75 kW / 1.0 hp • 4.4 kg[Ⓞ]

Për përdorim të rehatshëm në hapësira të kufizuara. E pajisur me dorezë shumëfunktionale, dorezë të rrumbullakët, si edhe me motor 2-MIX dhe rrip mbajtës. Ofron rregullimin e dorezës pa përdorur mjete shtesë.

Nr. i porosisë
4140 200 0529

Versione shtesë:
FS 55 shihni tabelën, faqe 144.



R = Dorezë rrumbullake Ⓞ Peshë pa karburantin, veglën prerëse dhe mbrojtësen

MOTOKOSA ME BENZINË PËR MIRËMBAJTJE KOPSHTI

- Për kopshte dhe prona të mëdha
- Për kositjen e sipërfaqeve të mëdha të barit
- Vegla me rendiment të lartë me mjete të ndryshme prerëse



FS 56 R

27.2 cm³ • 0.8 kW / 1.1 hp • 4.7 kg[Ⓞ]

Për përdorim të rehatshëm në hapësira të kufizuara. Me dorezë shumëfunktionale, dorezë rrumbullake, si edhe me motor 2-MIX dhe rrip mbajtës.

Nr. i porosisë
4144 200 0096



FAQE **271**

CARE & CLEAN KIT FS / FS PLUS

Mirëmbajtje perfekte për motokosat STIHL dhe sharrat e pastrimit. E disponueshme si paketë testuese dhe si ofertë speciale.

Ⓞ Pësha pa karburantin, veglën prerëse dhe mbrojtësen

R = Dorezë rrumbullake



MOTOKOSA ME BENZINË PËR MIRËMBAJTJE SIPËRFAQESH TË MËDHA

- Shumë të forta dhe të fuqishme
- Për kositjen e sipërfaqeve të mëdha me bar të gjatë
- Për pastrimin e barërave të këqija
- Për kultivimin e pemëve
- Edhe për shkurret që janë rritur së tepërmi



FS 94 C-E

24.1 cm³ • 0.9 kW / 1.2 hp • 4.9 kg[Ⓞ]

Motokosa më e lehtë në këtë kategori. Me sistem STIHL kundër dridhjes 1-pikësh, STIHL ErgoStart për ndezje praktike, dorezë si timon biçiklete, dorezë kontrolli me funksionin e pjesshëm të ngarkesës ECOSPEED. Gjithashtu e pajisur me motor 2-MIX, bosht të drejtë dhe rrip sigurie për të dyja shpatullat.

Nr. i porosisë
4149 200 0076

Versione shtesë:
FS 94 RC-E, shihni tabelën, faqe 144



FS 120

30.8 cm³ • 1.3 kW / 1.8 hp • 6.3 kg[Ⓞ]

Për të punuar në zona me sipërfaqe të mëdha dhe bar të fortë. E pajisur me sistemin STIHL kundër dridhjeve, STIHL ElastoStart, dorezë shumëfunktionale, dorezë në trajtë timoni për biçikleta dhe me mbrojtje. Ofron gjithashtu rregullimin e dorezës pa mjete shtesë.

Nr. i porosisë
4134 200 0074



FS 120 R

30.8 cm³ • 1.3 kW / 1.8 hp • 6.0 kg[Ⓞ]

Për të punuar në zona me sipërfaqe të mëdha dhe bar të fortë. E pajisur me sistemin STIHL kundër dridhjeve, STIHL ElastoStart, dorezë shumëfunktionale, dhe me mbrojtje. Ofron gjithashtu rregullimin e dorezës pa mjete shtesë.

Nr. i porosisë
4134 200 0411



FS 13136.3 cm³ • 1.4 kW / 1.9 hp • 5.8 kg[Ⓞ]

Motokosë veçanërisht e fuqishme, për të punuar në zona me sipërfaqe të mëdha dhe bar të fortë. Ofron një procedurë të lehtësuar ndezje fillestare për ndezje praktike dhe dorezë kontrolli me buton ndalues. E pajisur me dorezë në trajtë timoni për biçikleta, motor 4-MIX me serbator të madh për jetëgjatësi pune të madhe, bosht drejtues të palëvizshëm dhe mbrojtje për të dyja shtatullat.

Nr. i porosisë
4180 200 0572

**FS 350**40.2 cm³ • 1.6 kW / 2.2 hp • 7.3 kg[Ⓞ]

Sharrë pastrimi, dinamike dhe e fuqishme për punë kositëse në sipërfaqe të mëdha. Me sistem kundër dridhjes 4-pikësh, dorezë shumëfunktionale dhe me dorezë në trajtë timoni biçiklete.

Nr. i porosisë
4134 200 0399

**FS 250**40.2 cm³ • 1.6 kW / 2.2 hp • 6.3 kg[Ⓞ]

Për punë kositëse të vështira në sipërfaqe të mëdha. Me sistemin STIHL kundër dridhjes 1-pikësh, STIHL ElastoStart, dorezë shumëfunktionale, si edhe me dorezë në trajtë timoni biçiklete. Ofron rregullimin e dorezës pa mjete shtesë.

Nr. i porosisë
4134 200 0090

**FS 450**44.3 cm³ • 2.1 kW / 2.9 hp • 8.0 kg[Ⓞ]

Sharrë pastrimi, veçanërisht e fuqishme, për të punuar në zona sfiduese me bar të fortë dhe shkurre. Shumë e mirë për punë kositëse. Me sistem kundër dridhjes 4-pikësh, dorezë shumëfunktionale dhe dorezë në trajtë timoni biçiklete.

Nr. i porosisë
200 0172

**FS 260 C-E**41.6 cm³ • 2.0 kW / 2.7 hp • 7.7 kg[Ⓞ]

Për punë kositëse të vështira në sipërfaqe të mëdha. Me sistemin STIHL kundër dridhjes 1-pikësh, STIHL ErgoStart, dorezë shumëfunktionale, si edhe me dorezë në trajtë timoni biçiklete. Ofron rregullimin e dorezës pa mjete shtesë dhe është e pajisur me motor 2-MIX dhe rripin e sigurisë universal ADVANCE.

Nr. i porosisë
4147 200 0039

Versione shtesë:
FS 260 shihni tabelën, faqe 144

**KARBURANTE DHE LUBRIFIKANTË TË PËRSHTATSHËM**

SHIHNI NGA FAQJA 262

**C NË EMRIN E PRODUKTIT NËNKUPTON KARAKTERISTIKËN E KOMFORTIT**

Shumë vegla pune STIHL përmbajnë karakteristika të veçanta komforti dhe rehatie si standard, dhe këto mund të identifikoohen përmes "C" në emrin e produktit, si psh. FS 460 C-EM. "E" qëndron për STIHL ErgoStart dhe "M" qëndron për M-Tronic.

SHARRAT E PASTRIMIT

- Vegla profesionale të rehatshme, të forta dhe të fuqishme
Një kapuç fantastik me një mesazh të fortë! Material prej poliakriliku i thurur me kujdes. Në pjesën e palosur gjendet mbishkrimi "KISS MY AXE", i cili tregon se ku qëndron pasioni juaj!

E zezë
Përmasa **Një masë përshtatet për të gjithë**
Nr. i porosisë **0421 600 0008**

KAPELE »KISS MY AXE« UNISEX

100% pambuk



Për të gjithë të apasionuarit pas sporteve ekstreme: me këtë kapele të STIHL TIMBERSPORTS®, ju do të jeni të pajisur për çdo event! Kjo kapele me kontrastin e ngjyrave që ka në brendësi të saj, jep një mesazh të qartë - veçanërisht përmes shkrimit të madh të qëndisur në pjesën e përparme "KISS MY AXE". Më shumë se një kapele bejsbolli - është një mënyrë jetese!

E zezë
Përmasa **një masë përshtatet për të gjithë**
Nr. i porosisë **0464 021 0070**

KAPELE »AXE« UNISEX

100% pambuk



Kjo kapele e zezë me sēpatat e qëndisura në gri është e rregullueshme në madhësi të ndryshme me anë të kapësës metalike në pjesën e pasme. Është shoqëruesi juaj perfekt për sezonin pasardhës të STIHL TIMBERSPORTS®.

E zezë
Përmasa **Një masë përshtatet për të gjithë**
Nr. i porosisë **0420 540 0013**

KAPELE »CHOP« UNISEX

100% poliestër



Një kapele e shkëlqyer! Ju do të jeni të kompletuar me kapelen tonë të zezë - dhe jo vetëm për evente. Dizajni i tij modest përshtatet me çdo lloj veshjeje. Në pjesën e përparme të saj janë qëndisur gërmat "SHUT UP AND CHOP". Madhësia e kapeles mund të rregullohet duke përdorur shiritin shtrëngues në pjesën e pasme të saj.

E zezë
Përmasa **Një masë përshtatet për të gjithë**
Nr. i porosisë **0420 540 0002**



RRIP PANTALLONASH »AXE«

100% pambuk

Një rrip perfekt me pamje perfekte: jo vetëm siguron xhinset dhe pantallonat e punës të qëndrojnë në vendin e tyre, por ka gjithashtu një dizajn me sèpata të kryqëzuara mbi pllakën metalike. Ky rrip që mund të vendoset përditë, është i lehtë për t'u shkurtuar, ndërkohë që metali i qëndrueshëm siguron që rripi të mos çahet.

E zezë
Gjatësia **120 cm (mund të shkurtohet)**
Nr. i porosisë **0464 081 0030**



ÇANTË PËR SPORTE

Mbani gjithçka pranë dorës - gjatë trajnimit, garave apo dhe në palestër: çanta sportive STIHL TIMBERSPORTS® është gjithmonë ajo që ju duhet. Falë hapësirës së madhe kryesore, xhepave anësorë dhe ndarjes shtesë për këpucët, çdo gjë ka vendin e vet në këtë çantë.

E zezë
Përmasa **60 x 30 x 30 cm, afërsisht 54 l në volum**
Nr. i porosisë **0420 560 0000**



ÇANTË PËR SPORTE »COMPACT«

Gjithçka futet në çantën tonë sportive. Me dimensionet prej 25 x 50 x 23 cm, ka hapësirë të mjaftueshme për të gjitha nevojat tuaja sportive - peshqirin tuaj, veshjen dhe këpucët, secila në vendin e saj. Kjo çantë mund të mbahet në dorë me anë të rripave të shkurtër, ose direkt në shpatull me anë të rripit me gjatësi të rregullueshme. Emblema e STIHL TIMBERSPORTS® e kompletton pamjen e kësaj çante.

E zezë
Përmasa **25 x 50 x 23 cm**
Nr. i porosisë **0420 560 0006**

PESHQIR DUSHI

100% pambuk

Pavarësisht nëse jeni në plazh, sauna, apo në banjën e shtëpisë suaj, peshqiri jonë është një pjesë e rëndësishme e kompletit tuaj. Jo vetëm që është elegant me kombinimin e sfondit gri me sèpatat e kryqëzuara në ngjyrë gri të errët, por është edhe shumë i butë dhe absorbues i mirë i lagështisë.

Gri
Përmasa **afërsisht 70 x 140 cm**
Nr. i porosisë **0420 560 0004**

PESHQIR DUARSH

100% pambuk

Peshqiri i dorës STIHL TIMBERSPORTS® është perfekt për aktivitete sportive, sepse fijet e tij të buta janë të rehatshme në lëkurë, si dhe është absorbuese të mira të lagështisë. Dimensionet e tij prej 50 x 100 cm, janë fiks për çantën tuaj të sportit.

E zezë
Përmasa **afërsisht 50 x 100 cm**
Nr. i porosisë **0420 560 0001**

ÇANTË PËR PALESTËR »KISS MY AXE«

Çantë për palestër super elegante prej poliuretani me mbishkrimin e STIHL TIMBERSPORTS® dhe rripa ngjyrë portokalli. Kjo çantë mund të mbahet në çdo kohë, në kurriz ose në shpatulla dhe është vërtet një shoqërues praktik, kur jeni jashtë shtëpisë.

Përmasa **afërsisht 45 x 35 cm**
Nr. i porosisë **0420 560 0009**



SHALL TIPOZËSH

100% poliakrilik

Për adhuruesit e vërtetë! Xhakard i zi i thurur me logon e STIHL TIMBERSPORTS® dhe sèpata në ngjyrë portokalli dhe të bardhë.

E zezë
Përmasa **afërsisht 150 x 15 cm**
Nr. i porosisë **0420 560 0002**



ORË DORE

Kjo orë dore me dizajnin e STIHL TIMBERSPORTS® është e domosdoshme për aktivitete në natyrë. Me bazament prej çeliku të pa-ndryshkshëm, rripa najloni dhe xham të përbërë prej Crys-tex-i të përforcuar, e bëjnë këtë orë sportive veçanërisht të fortë. Dizajni i saj minimal do të thotë se mund të vishet gjithashtu si një orë klasike për meshkuj. Prodhuar prej Jacques Lemans.

Nr. i porosisë **0464 585 0040**



FILXHAN PËR KAFE

Filxhani i kafes, i përbërë prej porcelani, me dizajnin e STIHL TIMBERSPORTS®, jo vetëm që duket bukur, por është edhe shumë praktik. Ka një volum prej 300 ml dhe një kapak prej silikoni izolues, pra filxhani juaj i ri-përdorshëm do e mbajë pijen tuaj të preferuar të nxehtë.

E zezë
Nr. i porosisë **0464 283 0000**



JASTËK PËR T'U ULUR

Edhe tifozët më të zjarrtë e pëlqejnë rehatinë! Kjo e bën ndenjës tonë me diametër prej 34 cm, aksesori perfekt për çdo konkurs! Dizajn praktik me Velcro dhe lak në të cilin mund të varet.

Kafe
Përmasa **Ø 34 cm**
Nr. i porosisë **0464 765 0010**



POSTER METALIK

Vare në mur! Një aksesori i domosdoshëm për të gjithë të apasionuarit e STIHL TIMBERSPORTS®. Një poster me cilësi të lartë, me katër vrima për t'u varur në mur.

Përmasa **afërsisht 30 x 40 cm**
Nr. i porosisë **0420 560 0003**



STILOLAPS

Stilolapsi i preferuar i fansave, me bojë të zezë, majë metalike dhe prekje të butë është qershia mbi tortë për këdo që pëlqen STIHL TIMBERSPORTS®!

E zezë
Nr. i porosisë **0464 516 0060**



MBAJTËSE TARGE

Një përçasje e re për makinën tuaj. Mbjajtëse targash bërë prej cilësie të lartë dhe të fortë plasike ABS, me kornizë të mbyllshme, mentesha cilësore të zeza dhe dizajn të STIHL TIMBERSPORTS®. Pako me dy copë. Këto mbajtëse targash janë të përshtatshme për tregun gjerman, të dizajnuara për targat gjermane me buzë të ngritura dhe dimensione 112 x 520 mm.

Nr. i porosisë **0420 560 0008**



Krenaria për STIHL është motoja e këtij koleksioni. STIHL FAN është një angazhim ndaj markës, e cila tregohet qartë nga një logo e madhe mbi veshjet. Me aksesore praktikë për kyçet, kurrizin dhe xhepat.



XHAKETË ME JAKË TË BUTË »LOGO CIRCLE« PËR MESHKUJ

96% poliestër, 4% elastan

Ngrohtësi funksionale! Xhaketa jonë e re me jakë të butë është një bashkëudhëtar i përdoruesit gjatë gjithë vitit. Seksioni i shpatullës në ngjyrë gri, pjesët portokalli te kapuçi dhe xhepat anësore, si edhe zinxhiri STIHL ElastoStart janë detaje të përzgjedhura me kujdes dhe e bëjnë këtë xhakete një veshje tejet speciale.

E zezë/gri

Përmasat e meshkujve S-XXL
Nr. i porosisë 0420 910 01..



XHAKETË ME ZINXHIR »LOGO CIRCLE« PËR MESHKUJ

100% pambuk

Xhaketa jonë me zinxhir, me jakë të ngritur dhe masheta me shirita, kompletton çdo veshje. Pjesët portokalli te mashetat dhe logoja "LEGENDARY PERFORMANCE" në pjesën e kraharorit e bëjnë një veshje praktike dhe të detyrueshme për fansat e STIHL.

E zezë

Përmasat e meshkujve S-XXL
Nr. i porosisë 0420 910 02..



XHAKETË ME PELLUSH »STIHL« UNISEX

100% pambuk

Një dizajn klasik me material të testuar e provuar: kjo xhakete pel-lushi, e përbërë prej fibrash polies-tre të ngrohta dhe të buta, mbron kundër të ftohtit, dhe gjithashtu ofron lehtësi absolute në lëvizje. Logoja e STIHL në pjesën e kraharorit kompletton dizajnin.

E zezë

Përmasat XS-3XL
Nr. i porosisë 0421 100 00..



E RE BLUZË »LOGO« UNISEX

100% pambuk

Pulovër e zakonshme me masë të rregullt, me logo të dallueshme STIHL të printuar në pjesën e gjoksit. Me qepje të kryqëzuar dekorative në pjesën e rrumbullakët të qafës dhe shirit portokalli në pjesën e brendshme, krahas etiketës tonë klasike.

E zezë/ e zezë

Përmasat XS-XXL
Nr. i porosisë 0420 900 15..

E zezë/ e bardhë

Përmasat XS-XXL
Nr. i porosisë 0420 900 16..



E RE XHAKETË KUNDËR ERËS »LOGO CIRCLE« PËR MESHKUJ

100% poliestër

Xhakete sportive me kapuç, kundër erës, dhe me logo portokalli STIHL të një cilësie të lartë në pjesën e gjoksit. Me shtresë rrjete me kontrast të dallueshëm, në ngjyrë portokalli të ndezur. Qepjet elastike në mëngë ofrojnë rehati maksimale në të veshur, si edhe ka xhepa me zinxhir në anë.

E zezë/portokalli

Përmasat e meshkujve S-XXL
Nr. i porosisë 0420 910 03..



BLUZË T-SHIRT »LOGO CIRCLE« PËR MESHKUJ

Çfarë i duhet çdo fansi në garderobën e tij? Kjo bluzë t-shirt legjendare, patjetër. Ofron një veshje të rehatshme dhe sipas trupit. Me shkrimin e madh "LEGENDARY PERFORMANCE" në pjesën e pasme dhe logon STIHL në pjesën e majtë të kraharorit, do e thoni me zë të lartë: "Jam një fans i STIHL!"

Gri

90% pambuk, 10% viskozë
Përmasat e meshkujve S-XXL
Nr. i porosisë 0420 900 05..

E zezë

100% pambuk
Përmasat e meshkujve S-XXL
Nr. i porosisë 0420 900 06..



BLUZË T-SHIRT »MS 500i« PËR MESHKUJ

MS 500i është një sinonim i inovacionit, shpejtësisë dhe precizionit - pikërisht çfarë kjo bluzë e re t-shirt tregon. Jeni të siguar se do të tërhiqni vëmendjen me motosharrën e madhe të printuar në pjesën e përparme.

Gri

90% pambuk, 10% viskozë
Përmasat e meshkujve S-XXL
Nr. i porosisë 0420 900 07..

E zezë

100% pambuk
Përmasat e meshkujve S-XXL
Nr. i porosisë 0420 900 08..



E RE BLUZË T-SHIRT »LOGO CIRCLE« UNISEX

100% pambuk

Bluzë me jakë të rrumbullakët prej pambuku cilësor në masë të rregullt dhe logo 3-D në ngjyrën tradicionale portokalli. Etiketa e brendshme me logo plotëson strukturën e veshjes.



Portokalli
Përmasat XS-XXL
Nr. i porosisë 0420 600 37.

E RE BLUZË T-SHIRT »LOGO« UNISEX

100% pambuk

Bluzë e bardhë me jakë të rrumbullakët prej pambuku cilësor me stampim të madh me ngjyrë portokalli me kontrast. Me etiketën me logo STIHL në pjesën e brendshme dhe logon shtesë në ngjyrë portokalli në pjesën e jashtme.



E bardhë
Përmasat XS-XXL
Nr. i porosisë 0420 900 11.

E RE BLUZË POLO »LOGO CIRCLE« UNISEX

100% pambuk

Bluzë Polo me masë normale prej pambuku, çarje anësore, rripa në mëngë dhe vija në ngjyrë portokalli. Në pjesën e gjoksit ndodhet e printuar logoja STIHL me një copë të një cilësie të lartë. Me qepje të sheshta në pjesën e brendshme, të përfunduara në mënyrë dekorative në portokalli të ndezur.



E zejë
Përmasat XS-XXL
Nr. i porosisë 0420 900 13.

E RE KAPELE »LOGO CIRCLE« UNISEX

100% pambuk i përpunuar;
rrjetë: 100% poliestër

Kapele me 6 panele me simbol dekorativ të STIHL, të endur dhe të madh, dhe shirita të sheshtë. Me shtresa të brendshme dhe të jashtme në ngjyrë portokalli. Në pjesën e pasme ndodhet struktura e rrjetës për ajrosje optimale, si dhe rregulluesi për përshtatjen e madhësisë.



E zejë
Përmasat një masë përshtatet për të gjithë
Nr. i porosisë 0420 940 0007

KAPELE »LOGO CIRCLE« UNISEX

100% pambuk

Kapelja "LEGENDARY PERFORMANCE" në ngjyrë të zejë dhe gri, me një logo të madhe në pjesën e parme dhe shkrimin portokalli, kompletton çdo veshje në mënyrë perfekte. Me kapëse për përshtatjen e madhësisë.



E zejë/gri
Përmasa një masë përshtatet për të gjithë
Nr. i porosisë 0420 940 0002

KAPELE »LOGO« UNISEX

100% pambuk

Kapele e zejë me detaje të vijëzuara me stil në ngjyrë portokalli, si dhe mbishkrimi STIHL në pjesën ballore, ndërsa në pjesën e pasme, viti i prodhimit dhe në pjesën anësore mbishkrimi »LEGENDARY PERFORMANCE«.



E zejë
Përmasa një masë përshtatet për të gjithë
Nr. i porosisë 0420 940 0006

KAPELE BEJSBOLLI UNISEX

100% poliestër

Kjo kapele e zejë bejsbolli me logon e madhe, zburuese STIHL i përshtatet kujtdo! Kështu, është e qartë nga distanca - ajo është STIHL!



E zejë
Përmasa një masë përshtatet për të gjithë
Nr. i porosisë 0464 015 0030

KAPELE BEJSBOLLI »LOGO CIRCLE« UNISEX

100% pambuk

Kjo kapele e zejë bejsbolli me logon "LEGENDARY PERFORMANCE" mund t'i përshtatet çdo përmase koke, duke përdorur kapësen e metalit në pjesën e pasme.



E zejë
Përmasa një masë përshtatet për të gjithë
Nr. i porosisë 0420 940 0001

KAPUÇ I THURUR »MULTI LOGO« UNISEX

100% akrilik

Kapuç i zi me tonalitete në ngjyrë të zejë, me logo STIHL në madhësi të ndryshme. Pjesa e brendshme e ballit, e pajisur me një shtresë të veçantë për lehtësi në veshje. Kapuçi perfekt për ditë të ftohta!



E zejë
Përmasa një masë përshtatet për të gjithë
Nr. i porosisë 0420 940 0004

E RE ÇANTË SHPINE STIHL

100% poliestër

Për përdorim të shumëllojshëm - në zyrë, për punë në natyrë ose për kohë të lirë - çanta e zejë e shpinës është shoqëruesi juaj perfekt. Me ndarje praktike për shishe në pjesën e brendshme, xhep për çelësa, dhe pjesën për dokumenta ose kompjuter. Zinxhiri plastik me logo STIHL, dhe elastik. Pjesa e poshtme dhe rripat që mund të hiqen për t'u larë dhe stampa e shkruar »LEGENDARY PERFORMANCE« e plotësojnë më së miri formën e çantës. Rripat e mbushur mundësojnë mbajtje shumë komforte.



Nr. i porosisë 0421 600 0005

KAPUÇ »LOGO« UNISEX

100% akrilik

Aksesorë për kohë të ftohtë: kapuç me xhufkë portokalli, model bardhë-zinorvegjez, me logo të gjerë STIHL.




E zejë
Përmasa një masë përshtatet për të gjithë
Nr. i porosisë 0420 940 0005

ÇORAPE »STIHL« UNISEX

33% lesh merino (pa kokrra dhe pesticide),
32% poliamid, 20% poliakrilik,
13% poliestër, 2% elastan

Këto çorape të gjata dhe sportive, të përbëra prej kombinimit special të Primaloft dhe Merino, ofrojnë rregullim optimal të temperaturës, edhe kur jeni duke punuar intensivisht. Në veçanti me çizme, teknologjia Cell Tech dhe kanalet fleksible sigurojnë rehati, reduktim të lodhjes dhe veshje optimale.



Përmasat 35-38
Nr. i porosisë 0420 950 0038

Përmasat 39-42
Nr. i porosisë 0420 950 0042

Përmasat 43-46
Nr. i porosisë 0420 950 0046



ÇADËR ME DOREZË DRURI

Çadra e fortë e cilësisë së lartë, me hapje automatike, ka një dorezë të përbërë prej druri të certifikuar me FSC. Një çadër tërësisht normale? Aspak! Sepse në sajë të dy segmenteve me emblemën STIHL, çadra jonë ka edhe dy segmente të tjera shtesë me emblema të printuara mbi to. Kjo do të thotë se dy logot shtesë STIHL duken çartë kur çadra laget - por shpresojmë të mos bjerë shi së shpejti!

Përmasa **Ø afërsisht 113 cm**
Nr. i porosisë **0420 960 0009**



USB 16 GB PREJ DRURI

Me këtë USB me lidhës USB 3.0, mund të jeni të sigurt se do të keni të dhënat e juaja gjithmonë me vete. Me dorezë prej druri arre dhe ka kapacitet prej 16 GB. Kapaku i lëvizshëm prej argjendi me logon STIHL, siguron se lidhësi i USB nuk dëmtohet nga papastërtitë.

Nr. i porosisë **0420 360 0007**



USB 8 GB NË TRAJTË MOTOSHARRE

Për këdo që i mungojnë motosharrat në shtëpi: USB-ja jonë në trajtë motosharre ka një lidhje USB 3.0 dhe një kapacitet prej 8 GB. Mbrojtësja e zinxhirit është e lëvizshme dhe mbron lidhësin USB kundër papastërtive.

Nr. i porosisë **0420 360 0008**

SHISHE VAKUUMI

E nxehtë apo e ftohtë? Shishja jonë e vakuumit i përballon të dyja. Me mure të dyfishta, të izoluar me vakuum, e përbërë prej çeliku, i mban lëngjet e ftohta, të freskëta dhe lëngjet e nxehta, të ngrohta. Edhe praktike, edhe elegante, me gotë të përfshirë.



500 ml
Nr. i porosisë **0464 251 0010**

KULETË PËR MESHKUJ

Dizajn i jashtëm kulete, në ngjyrë kafe të errët dhe i përbërë prej lëkure premium. Pjesa e brendshme ka emblemat e fshehura STIHL dhe mbrojtjen e integruar RFID.



12.5 x 10 cm (e mbyllur)
Nr. i porosisë **0420 960 0005**

E RE ORË DORE STIHL

Ora e dorës STIHL, e prodhuar nga firma Jacques Lemans, është matës kohe tradicional në design klasik. Kasa masive prej çeliku të fortë ka një diametër 40 mm, fusha e numrave me ngjyrë të zezë, treguesi i datës në pozicionin e orës 3 janë të thjeshta, por shumë të dallueshme. Ky model ka mekanizëm kuarci, formë të rrumbullakët dhe shtresën e poshtme të fiksuar me vida, xhami mbrojtës i markës Crystex dhe është rezistente ndaj ujit deri në 10 ATM. Rripi i orës përbëhet nga çelik i fortë inox i lëmuar. Kjo orë dore është bashkëshoqërues i përsosur për çdo ditë.

Nr. i porosisë **0421 600 0000**



E RE CHRONOGRAPH STIHL

STIHL Chronograph është e prodhuar nga firma Jacques Merat dhe ka nota elegante dhe sportive. Fusha e zezë e numrave me detaje në ngjyrë portokalli bën përshtypje nga një kombinim i indeksve të thjeshta me numrat arabe. Treguesi i datës është i vendosur pjerrësisht ndërmjet pozicionit të orës 4 dhe 5. Treguesi chrono me format 24-orësh, akrepat e sekondave dhe minutave kanë pamje elegante. Kasa përbëhet nga çelik inox IP-Black me diametër 44mm. Kjo bën të mundur një pamje të veçantë të kësaj ore. Modeli ka mekanizëm kuarci, xham të përforcuar Crystex Glas, shtresa e poshtme e fiksuar me vida, rezistente ndaj ujit deri në 10 ATM. Rripi i orës prej silikonit me kunj shtrëngues mundëson një prezantim të arritur - kjo orë është kombinimi perfekt ndërmjet elegancës dhe sportivitetit.

Nr. i porosisë **0421 600 0001**



STILOLAPS PREJ DRURI

Ky stilolaps prej druri është dhurata ideale e një cilësie të lartë. Pjesa e poshtme e stilolapsit përbëhet prej druri arre të vajosur, ndërkohë që pjesa e sipërme është metalike dhe krijon një kontrast modern. Ky stilolaps me mbushje në ngjyrë blu është i rehatshëm në përdorim dhe shkruan bukur.

Nr. i porosisë **0464 516 0080**



SET SHKRIMI

Seti jonë i ri i shkrimit, i pakeluar në një kuti të zezë dhurate, përmban një stilolaps dhe një laps mekanik. Detajet me kontrast në ngjyrë portokalli dhe veshja e butë në prekje sigurojnë një mbajtje të rehatshme.

Nr. i porosisë **0420 360 0006**



STILOLAPS ME PREKJE MIQËSORE NDAJ EKRENEVE

Stilolapsi jonë, miqësor ndaj ekraneve, është një urë midis botëve analoge dhe digjitale! Njëra anë e stilolapsit mund të përdoret me celularë dhe tableta, ndërsa ana tjetër përmban majën e çeliktë të stilolapsit, e cila është e fshehur nën një kapak. Prej materiali mat të kromuar, me logon portokalli STIHL dhe me sipërfaqen e gomuar për një mbajtje sa më të rehatshme.

Nr. i porosisë **0464 516 0070**

MBAJTËSE ÇELËSASH METALIKE NË TRAJTË MOTOSHARRE



Mban së bashku të gjitha gjërat e duhura! Metali jonë me cilësi të lartë në formë motosharre ka një gjatësi totale prej 9.5 cm, bashkë me unazën për të mbajtur çelësat.

Nr. i porosisë **0420 960 0008**

MBAJTËSE ÇELËSASH NË TRAJTË MOTOSHARRE



Jo pa motosharrën time! Mbani gjithmonë pajisjen tuaj të preferuar me vete, me mbajtësen e çelësave në formë motosharre dhe me efekte zanore reale. Ky mbajtës çelësash është bërë prej çeliku të galvanizuar me shkëlqim. Përfshin butonin e baterisë (të ndërrueshme).

Nr. i porosisë **0420 960 0003**

MBAJTËSE ÇELËSASH »FORESTRY WORKER«

Punonjësi jonë i pylltarisë është anëtar i më i ri në serinë e mbajtësëve të çelësve! Detaje të menduara me dashuri si helmata, kufjet dhe motosharra, e bëjnë atë, aksesoren e ri të preferuar të çdo fansi të STIHL.



Nr. i porosisë **0420 960 0002**

MBAJTËSE ÇELËSASH »SAFETY HELMET«



Kjo mbajtëse çelësash në formë helmete është vërtet e kënaqshme për syrin, si edhe praktike. Helmata është bërë prej akriliku të qëndrueshëm, ndërkohë që mbajtësja e çelësave dhe unaza përbëhen prej çeliku të galvanizuar me shkëlqim. Mbajtësja praktike e çelësave me dizajn helmete është e domosdoshme për çdo fans.



Nr. i porosisë **0464 118 0020**

HAJMALI NË TRAJTË MOTOSHARRE



Si në një byzylyk apo në një varëse, kjo hajmali në formë motosharre është një aksesor vërtet i veçantë. Bërë prej argjendi të mbuluar me rodium 925, ajo është një pjesë e jashtëzakonshme e cila mund të vendoset e sigurt në çdo byzylyk apo varëse femrash me anë të mbërthyesit të sigurtë.

Nr. i porosisë **0464 120 0070**

ZBUKURIM / HAJMALI »AXE«



Po kërkoni diçka për t'i shtuar byzylykut ose varësës suaj? Hajmاليا jonë e re me dy sëpata të kryqëzuara me gjatësi 18 mm është e prodhuar prej argjendi të mbuluar me rodium 925 dhe vjen e paketuar me dashuri në një kuti dhuratash.

Nr. i porosisë **0420 560 0007**

HAPËSE SHISHESH »CUT-OFF MACHINE«



Sillni gamën e produkteve STIHL në sirtarin e kuzhinës suaj. Një hapëse shishesh solide dhe e rehatshme për t'u mbajtur, bërë prej metali në formën e prerëses së betonit.

Përmasa **afërsisht 90 x 50 x 2 mm**
Nr. i porosisë **0420 960 0012**

XHUXH KOPSHTI

Ky xhuxh që mban një motosharrë e ka vendin përpara çdo kopshti! Xhuxhi afërsisht 20 cm i gjatë, vjen i veshur me rroba pune, kapuçin e detyrueshëm me majë dhe shumë detaje të tjera të punuara me dashuri, të cilat do e zbukuronin kopshtin tuaj të luleve.



Nr. i porosisë **0420 360 0010**

MODELI »MS 500i«



Një koleksion i mirëfilltë nga Schuco! Modeli i zvogëluar në shkallën 1:10 i motosharrës inovative MS 500i, i prodhuar me derdhje zinku dhe pjesë plastike, i lyster me dashuri me ngjyrat origjinale është i domosdoshëm në çdo vitrinë ekspozuese.

Nr. i porosisë **0420 960 0001**

MODELI »MS 881«



Koleksion nga firma Schuco! Modeli i motosharrës më të fortë STIHL MS 881 në shkallën 1:10, i prodhuar me derdhje zinku dhe pjesë plastike, në ngjyrë portokalli, nuk duhet të mungojë në asnjë vitrinë.

Nr. i porosisë **0420 960 0017**

LOJË LUDO PREJ DRURI



Nuk këshillohet për personat me zemër të dobët! Një version STIHL i lojës legjendare me eliminime, "mos u nxeh". Bërë prej druri të çertifikuar prej FSF, kjo lojë klasike është argëtuese për çdo moshë. Të gjithë gurët e lojës janë sigurisht të pikaturuar me motosharrat përkatëse dhe me dy zara në ngjyrë portokalli.

Përmasa **20 x 20 cm**
Nr. i porosisë **0420 360 0002**

ELEKTRIK DORE ME DRITË LED



Elektrik dore 3W LED i zi, i anodizuar, prej alumini të qëndrueshëm me mbishkrimin STIHL të gdhendur. Me buton praktik ndezjeje dhe fikjeje në pjesën e sipërme të trupit. Përfshin 3 bateri AAA dhe rripin.

Nr. i porosisë **0420 360 0009**

MATËS I LAGËSHTISË SË DRURIT



Ky matës praktik lagështie nuk mat vetëm nivelin e lagështisë në dru zjarri ose lëndë drusore ndërtimore, por gjithashtu mund të përdoret si një mjet i besueshëm për të kontrolluar nivelin e lagështisë në materiale të tjera, të tilla si suva ose çimento. Pajisja portative matëse tregon edhe temperaturën e ajrit të ambientit. Vjen me 4 bateri (1.5V, LR44).

Nr. i porosisë **0464 802 0010**

PESHQIR PLAZHI



100% cotton

Është koha për plazh! Peshqiri i madh me përbërje pambuku, me doreza kapëse është shoqëruesi perfekt për në plazh, sauna dhe aktivitetet e tjera. Forma elegante »LEGENDARY PERFORMANCE« e ben një produkt unik. Ngjyrë e zezë dhe portokalli.

Përmasa **180 x 80 cm**
Nr. i porosisë **0420 960 0018**

RRIP PËR VALIXHEN



100% polyester

Na merrni me vete kur të udhëtoni! Rripi jonë për valixhet me logon e qëndisur STIHL, është shoqëruesi perfekt për udhëtimin tuaj të rradhës. Kombinimi TSA i kyçit siguron që valixhja juaj të jetë e mbrojtur mirë.

Nr. i porosisë **0464 081 0020**

ENË PËR PJEKJE NË TRAJTË MOTOSHARRE



Edhe druvarët më të përkushtuar mund të shijojnë gatimin e ëmbëlsirave! Kjo enë për pjekje, është bërë nga çelik i karbonizuar, çka e bën rezistente ndaj nxehtësisë, dhe të sigurt për të gatuar ëmbëlsira në formë motosharre në cdo kohë. Veshja e brendshme siguron që asgjë të mos digjet. Rezistente ndaj nxehtësisë deri në 220 ° C.

Përmasa **afërsisht 40 x 36 x 4.5 cm**
Nr. i porosisë **0420 360 0000**

FILXHAN

Kafe ose çaj, kapuçino ose çokolatë e nxehtë, filxhani prej porcelani, i dizajnuar prej STIHL, është i një cilësie të lartë, njëkohësisht një aksesori i domosdoshëm në tryezën tuaj të mëngjesit. Madhësi e përsosur për pijen tuaj të preferuar, i përshtatshëm për t'u larë në makinën larëse të enëve.



Nr. i porosisë **0464 257 0000**

FILXHAN PËR KAFE SET PREJ 2 COPËSH

Seti prej dy filxhanësh ekspresi, dizajnuar me elegancë nga STIHL, e bën shijimin e kafes edhe më të lezetshëm. Filxhanët nuk kanë doreza mbajtëse, por janë përshtatur me një unazë plastike, të ideuar për të mbrojtur gishtat tuaj nga nxehtësia.



Nr. i porosisë **0464 257 0040**

KUTI DREKE



Kjo kuti dreke, e dizajnuar nga Koziol, ofron hapësirë të mjaftueshme për të gjitha llojet sanduiçeve, mes-vakteve dhe frutave. Dizajni i rrumbullakosur i kutisë parandalon ngjitjen në anët e saj, ndërsa modelimi i saj në formën e një motosharre nën logon e STIHL janë nuancat e fundit drejt perfekte.

Përmasa **afërsisht 17 x 12.5 x 6.5 cm**
Nr. i porosisë **0464 259 0010**

SET ME DY GOTA BIRRASH

Organizoni një festë me miqtë tuaj! Gotat tona janë perfekte për të gjitha llojet e birrave. Pjesa mbështetëse i jep gotave qëndrueshmëri, ndërsa logo e STIHL gjendet e gdhendur vertikalisht në secilën prej tyre. Të përshtatshme për t'u larë në makinën larëse të enëve. Paketim me dy gota.



Nr. i porosisë **0464 767 0010**

ORË MURI

Aty ku dizajni takohet me precizionin! Kjo orë muri është dizajnuar nga Jacques Lemans. Dizajni minimalist i orës, me akrepa argjendi në një fushë të zezë, bën të mundur që ju ta përqendroni vëmendjen në atë çfarë vërtetë ka rëndësi: tek koha. Logot e STIHL dhe Jacques Lemans janë nuancat e fundit drejt perfekte.



Nr. i porosisë **0464 401 0020**



KIDS

XHAKETË KUNDËR SHIUT »PACKABLE« PËR FËMIJË

100% poliamid rezistent ndaj ujit

E ideuar për të mbajtur të vegjlit të thatë edhe në reshje të papritura shiu. Xhaketa e gjelbër me zinxhir portokalli është dizajnuar me një stil sa elegant, aq edhe praktik. Mëngët elastike, kapuçi dhe jaka e gjatë parandalojnë futjen e ujit në brendësi. Dhe më e mira nga të gjitha: kjo xhaketë shiu mund të paktohet në xhepin anësor, duke formuar kështu një pako të vogël. Nuk ka gjë më të bukur sesa të kënaqesh edhe në ditët me shi!

Jeshile		Përmasat	
Përmasat	110-116	Përmasat	134-140
Nr. i porosisë	0420 410 0316	Nr. i porosisë	0420 410 0340
Përmasat	122-128	Përmasat	146-152
Nr. i porosisë	0420 410 0328	Nr. i porosisë	0420 410 0352



KAPUÇ »SAW« PËR FËMIJË

100% akrilik

Për mot të freskët, kemi kapuçin perfekt për të rinjtë aventuri-erë. Me vija blu dhe portokalli, një brez blu i errët dhe një top portokalli në majë, ky kapuç me siguri do t'i mbajë veshët e fëmijëve të ngrohtë gjatë dimrit.

Blu
Përmasa **një masë përshtatet për të gjithë (48-56 cm)**
Nr. i porosisë **0420 440 0000**



KAPUÇ »ADVENTURE« PËR FËMIJË

100% poliakrilik

Prindërit gjithmonë thonë: "Mos harroni kapuçin!" Të jeni të sigurt se nuk do ta harroni kapuçin tonë jeshil me topin portokalli. Ky kapuç do ta mbajë fëmijën tuaj ngrohtë përgjatë gjithë stinës së dimrit.

Jeshile
Përmasa **një masë përshtatet për të gjithë (48-56 cm)**
Nr. i porosisë **0420 440 0002**





KAPELE »LUMBERJACK« PËR FËMIJË

100% pambuk

Kapelja jonë e kuqe me qepje, me logon "FUTURE LUMBER-JACK" në pjesën e përparme të saj, është dizenuar me shumë stil dhe njëkohësisht praktike edhe në mot me diell. Kjo kapele përshtatet për të gjitha masat, nëpërmjet rripit të pasëm.

E kuqe
Përmasa një masë përshtatet për të gjithë (52-55 cm)
Nr. i porosisë 0420 440 0006



KAPELE »ADVENTURE« PËR FËMIJË

100% pambuk

Kapelja jonë e gjelbër me qepje, me logon në pjesën e përparme të saj, është dizenuar me shumë stil dhe njëkohësisht praktike edhe në mot me diell. Kjo kapele përshtatet për të gjitha masat, nëpërmjet rripit të pasëm.

Jeshile
Përmasa një masë përshtatet për të gjithë (52-55 cm)
Nr. i porosisë 0420 440 0005



KAPELE PËR FËMIJË

100% pambuk

E bukur dhe praktike. Kapelja jonë gri, me strehën blu, e dizenuar me logon e një motoshtarre, do të bëhet e preferuara juaj, jo vetëm në ditët me diell.

Blu/jeshile
Përmasa një masë përshtatet për të gjithë (52-55 cm)
Nr. i porosisë 0420 440 0001



KAPUÇ »ADVENTURE« PËR FËMIJË

100% poliakrilik rezistent ndaj ujit

Kur të bëhet vërtet ftohtë, do t'ju duhet një kapuç dimri. Ky kapuç është komod dhe i ngrohtë, i dizenuar për të mbrojtur jo vetëm kokën, por edhe veshët tuaj nga i ftohti - ideal për të gjithë aventurierët që duan të eksplorojnë natyrën edhe gjatë dimrit. Mbrojtëset e veshit mund të palosen ose të ulen poshtë duke përdorur rripin që pozicionohet nën mjekër.

Blu
Përmasat **XXS/51** Përmasa **XS/53**
Nr. i porosisë **0420 450 0551** Nr. i porosisë **0420 450 0553**



SHALL SHUMËFUNKSIONAL PËR FËMIJË

100% poliestër

Ky shall shumëfunktional për fëmijë është prodhuar në Gjermani dhe ofron mbrojtje të lartë ndaj rrezeve UV - karakteristike kjo që e bën tepër të përdorshëm sidomos në muajt më të nxehtë të vitit. Ky artikull shumëfunktional nuk lejon aromet e pakëndshme, dhe thahet lehtësisht pas larjes.

Jeshile
Përmasa një masë përshtatet për të gjithë
Nr. i porosisë 0420 460 0014



VESHJE PËR BEBET »BEAVER«

54% pambuk, 46% poliestër;
pantallona 100% pambuk

Dëgjoni me vëmendje!
Pavarsisht se ku ndodhet, në karrocë, në krahët e nënës apo të babait, bebi juaj do të dojë të eksplorojë botën në hapat e tij të parë me veshjen tonë.

Gri/blu
Sizes **62-68** Përmasat **86-92**
Nr. i porosisë **0420 450 0468** Nr. i porosisë **0420 450 0492**

Sizes **74-80**
Nr. i porosisë **0420 450 0480**



E RE VESHJE PËR BEBET »LUMBERJACK« PËR FËMIJË

100% pambuk

Kostum pambuku i dizenuar me stil, me sharrë të pozicionuar në një xhep të vogël në pjesën e gjoksit.

E kuqe/e zezë
Përmasat **62-68** Përmasat **86-92**
Nr. i porosisë **0420 450 0668** Nr. i porosisë **0420 450 0692**

Përmasat **74-80**
Nr. i porosisë **0420 450 0680**



KËPUCË NË TRAJTË ÇORAPESH PËR BEBET

75% pambuk, 25% poliestër

Këpucë të buta të ideuara për të mbajtur këmbët e bebit të ngrohta, pa i kufizuar ato. Motivet zbukuruese tregojnë qartë se cila prej këpucëve është e majta dhe cila është e djathta - detaj ky që i vjen në ndihmë prindërve të rinj!

Jeshile/portokalli
Size **17** Përmasa **19**
Nr. i porosisë **0420 450 0317** Nr. i porosisë **0420 450 0319**

Size **18**
Nr. i porosisë **0420 450 0318**



BIBERON PREJ DRURI

Mbajeni aty ku ju nevojitet! Ky biberon prej druri ah është aksesor i perfekt për fansat e vegjël të STIHL. Biberoni përbëhet nga rruaza të trasha druri që mbajnë motive STIHL, të tilla si Tim Timber, kastori STIHL dhe motoshtarra. Një kapëse metalike cilësore mban zinxhirin të fiksuar.

Nr. i porosisë **0464 095 0050**



SET BIBERONASH

Për të vënë bebet në gjumë: set biberonash për fansat e vegjël të STIHL të moshës 6 deri në 18 muaj. Ky biberon prej silikoni është i sigurt për shëndetin e bebeve dhe përputhet me standardin europian EN 1400.

Nr. i porosisë **0464 095 0070**



100% pambuk; mbushje: 100% poliestër

Kjo batanije për bebe jo vetëm që duket e mahnitshme, por është gjithashtu ideale për të përqafuar bebin apo për të luajtur dhe relaksuar me të. Pëlhura e kësaj batanije është 100% pambuk, dhe do të përbëjë një detaj të lezetshëm në dekorimin e çdo dhome. Përmbytja 100% pambuk e bën këtë batanije komode dhe të butë, duke e bërë vogëlushin tuaj të ndjehet si në shtëpi.

Përmasat **60 x 80 cm**
Nr. i porosisë **0420 460 0013**



ÇANTË SHPINE

100% poliestër

Duke ofruar 7,5 l hapsirë, plus një xhep të jashtëm, kjo çantë ka gjithë hapësirën e nevojshme për të cilën ka nevojë i vogli juaj. Pësja është shpërndarë nëpërmjet rripave, dhe materiali 100% poliestër është konform gjithë standardeve të sigurisë - ndërsa logo "WILD KIDS" është një detaj që e bën këtë çantë të duket edhe më e veçantë.

Blu
Përmasa **23 x 31 x 11 cm**
Nr. i porosisë **0420 460 0002**



ÇANTË LARJEJE

100% poliestër

Çanta e larjes ka një ndarje të madhe me zinxhir dhe rretë që bën të mundur që gjithcka të qëndrojë e rregullt.

Blu
Përmasa **23 x 16 cm**
Nr. i porosisë **0420 460 0003**



LIBËR ME OBJEKTE TË FSHEHURA

Vëmendje, eksplorues! Dilni dhe eksploronini të katër stinët me kastorin miqësor; shijoni disa mini-aventura dhe zbuloni sa emocionues është Kampionati Botëror i STIHL TIMBERSPORTS® me të vërtetë. Libri jonë me figura dhe objekte të fshehura, Katër Stinët, është 12 faqe i gjatë dhe i përshtatshëm për fëmijët e moshës 2 deri në 6 vjeç.

Nr. i porosisë **0420 460 0006**



ÇANTË PALESTRE »LUMBERJACK«

100% poliestër

Unë paketoj çantën e palestrës dhe shkoj...! Çanta jonë e palestrës ofron hapësirë për kompletin tuaj të palestrës dhe gjithashtu duket shkëlqyeshëm. E përsosur për t'ju shoqëruar në çdo aventurë. Logot "CRAZY BEAVER" dhe "FUTURE LUMBERJACK" e bëjnë këtë çantë edhe më të veçantë.

Blu
Përmasat **35 x 30 cm**
Nr. i porosisë **0420 460 0007**



KULETË AVENTURASH

100% poliestër

Për të parandaluar humbjen e gjërave personale në udhëtime, ne ju sugjerojmë portofolin e ri që lidhet rreth qafës e do t'ju shoqërojë në aventurat tuaja. I dizenuar me logon "FUTURE LUMBERJACK", me një kombinim të ngjyrës blu me atë portokalli, ky portofol do të jetë një vend i sigurt që ju të ruani paratë tuaja.

Blu
Përmasat **14 x 10 cm**
Nr. i porosisë **0420 460 0008**



SET DISTINKTIVËSH

100% poliestër

Seti i distinktivëve të qëndisur është diçka që aventurierët e rinj duhet ta kenë patjetër. Mund të përdoret për të dekoruar çdo veshje tuajën, duke e bërë atë speciale. Seti konsiston në tre distinktivë dekorues me motive të mrekullueshme. Pavarësisht nëse është një "Future Lumberjack", "Adventure Camp" ose "Crazy Beaver", ka diçka për të gjithë në këtë set.

Nr. i porosisë **0420 460 0009**



DRE I BUTË LODËR

Lodër për përkëdhelje! Ky dre shumë i butë, i bërë nga pellushi, do të jetë lodra e preferuar e fëmijës tuaj.

Përmasa **afërsisht 20 cm**
Nr. i porosisë **0420 460 0012**



KASTOR LODËR TIM TIMBER

Një mik për gjithë jetën. Kastori "TIM TIMBER", i dizenuar nga Steiff është lodra e preferuar e shumë fëmijëve të vegjël. Lodra është e bërë nga pellush shumë i butë, çka e bën të rehatshme për ta mbajtur pranë. Lodra mund të lahet në lavatrice në 30 °C.

Përmasa **afërsisht 22 cm**
Nr. i porosisë **0464 971 0200**



JASTËK NË TRAJTË MOTOSHARRE

Tani është e mundur që të merrni me vete në shtrat motosharrën tuaj të preferuar: motosharra STIHL është në dispozicion në formën e jastëkut! Jastëku-motosharrë përbëhet nga pellush i butë, dhe është një domosdoshmëri për këdo që do të ëndërojë me STIHL çdo natë.

Përmasat **52 x 21 cm**
Nr. i porosisë **0464 095 0200**



MOTOSHARRË LODËR ME BATERI



Kjo motosharrë lodër nuk do të impresionojë vetëm fëmijët! Zinxhiri lëvizës dhe tingulli që lëshon kjo motosharrë, bën që loja të jetë sa më reale. Motosharra lodër vjen e pajisur me bateri, kështu që argëtimi mund të fillojë menjëherë.

Nr. i porosisë **0464 934 0000**

AKSESORËT: SET ZINXHIRËSH I ZËVENDËSUESHËM PËR MOTOSHARRËN LODËR (JO NË FIGURË)

Katër zinxhirë gome, një pajisje.

Nr. i porosisë **0464 934 0095**



MOTOKOSË LODËR ME BATERI



Kjo motokosë lodër me tingull real është perfekte për fëmijë të cilët duan t'ju "ndihmojnë", kur ju të jeni duke punuar në ambientet e jashtme.

Motokosa lodër është e manovrueshme për të gjitha gjatësitë, që do të thotë se fëmijët tuaj do të mund të argëtohen me të, edhe për vitet në vijim. Volumi i kësaj motokose mundet gjithashtu të përshtatet sipas dëshirës suaj.

Nr. i porosisë **0464 937 0000**



HELMETË LODËR

Kopja identike e helmetës profesionale të STIHL, plastikë ABS, mburojë e lëvizshme, madhësi e përshtatshme, e bashkangjitur me mbrojtësen e veshëve. Kjo helmetë nuk ka funksion mbrojtës dhe është e përshtatshme për fëmijë mbi moshën 3 vjeç.

Nr. i porosisë **0420 460 0001**



DOREZA PUNE PËR FËMIJË

Pjesa e pasme e dorës dhe gishtat: elastan (97% poliestër, 3% akrilik)
Pëllëmba e dorës: lëkurë sintetike (50% najlon, 50% poliuretani)
Mbrojtëset e kyçeve dhe manshetat: neopren (SBR dhe poliestër)

Pjesa e pasme e dorezës përbëhet nga një material elastik dhe mansheta e kyçit përmban një logo të dukshme të STIHL, ndërkohë që pëllëmba e dorezës përbëhet nga një lëkurë sintetike rezistente. Ato e bëjnë lojën në natyrë edhe më argëtuese!

E zezë/portokalli

Përmasa **S (5-7 vjeç)**
Nr. i porosisë **0421 500 0104**

Përmasa **M (7-10 vjeç)**
Nr. i porosisë **0421 500 0105**

Përmasa **L (10 vjeç e sipër)**
Nr. i porosisë **0421 500 0106**



TOP FUTBOLLI

Top futbollit lëkure me një dizajn klasik që ofron argëtim si për fëmijët, ashtu edhe për të rriturit. Topi është i qepur me dorë, dhe ka në përbërje një gomë të brendshme, të pajisur me valvul sigurie që bën të mundur që topi të mos shfryhet.

Nr. i porosisë **0464 936 0020**



BIÇIKLETË E BALANCUAR PËR FËMIJË

Vëmendje, çiklistë! Biçikleta jonë është e bërë nga dru ahu i certifikuar nga FSC dhe është perfekte për të mësuar të vegjlit përpara se ata të marrin biçikletën e tyre të parë "të vërtetë". Lartësia e shalës mund të rregullohet sipas dëshirës. E përshtatshme për fëmijë nga 3 deri në 6 vjeç.

Nr. i porosisë **0464 944 0000**



LODËR PREJ DRURI PËR FËMIJË

Nerva të forta dhe një dorë e qëndrueshme janë të nevojshme për këtë lojë klasike. Kulla e pirgjeve është e bërë nga dru pishe i certifikuar nga FSC, kërkon një dorë të sigurt gjatë lojës dhe njëkohësisht, është një lojë popullore që kërkon aftësi si tek fëmijët, ashtu edhe tek të rriturit. Në të 54 blloqet, si edhe në kutinë mbajtëse është e gdhendur logo e STIHL.

Nr. i porosisë **0464 959 0010**



PUZZLE 3D

Ndërto motosharrën tënde! Puzzle 3D prej druri që tregon motosharrën, i përbërë nga 4 panele druri, secila 21 x 34 x 0.3 cm, të bëra nga dru i certifikuar nga FSC.

Nr. i porosisë **0420 460 0011**



DETAJET E TEKNOLOGJIVE KRYESORE.

1 VEGLAT E PUNËS ME BATERI

Modelet me bateri

Veglat e punës STIHL të cilat funksionojnë përmes teknologjive inovative me bateri dallohen nga simboli i baterisë. Duke shtuar pjesën e llojit të baterisë, ky simbol ilustron cilit sistem me bateri i përket secili produkt. Të gjitha bateritë përmbajnë vetëm qeliza të zgjedhura litiumi të cilat plotësojnë standardet e larta të sigurisë. Ato mund të rimbushen plotësisht deri në 1200 herë me një humbje tejet të vogël të kapacitetit. Struktura e saktë bazohet në llojin e baterisë dhe zonën e aplikimit, si edhe në llojin e ndërtimit të baterisë dhe performancën.

ASIII SYSTEM Për modelet në Sistemin AS, një bateri me jone litiumi e llojit AS përdoret në të gjitha veglat e punës. Për ta bërë edhe më praktike, treguesi i karikimit mund të shfaqet me shtypjen e një butoni dhe tregohet përmes disa dritave LED në veglën e punës (përveç HSA 25).

AI III Veglat e punës në linjën AI përmbajnë një bateri me jone litiumi dhe karikohen duke përdorur tensionin në rrjet. Për praktikitet të shtuar, treguesi i karikimit mund të shfaqet përmes disa dritave LED.

AKIII SYSTEM Për pajisjet në Sistemin AK, një bateri e ndër-rueshme AK me jone litiumi mund të përdoret në të gjitha veglat e punës përgjatë kësaj kategorie. Për praktikitet të shtuar, treguesi i karikimit mund të shfaqet përmes disa dritave LED.

APIII SYSTEM Veglat e punës në Sistemin AP janë kompatibël me bateritë AP dhe AR. Këto bateri përmbajnë kapacitet të zgjeruar në fuqi dhe në jetëgjatësi. Kjo i bën ato veçanërisht të dobishme për aplikime profesionale.

Sistem i karikimit të shpejtë të baterisë

Procesi inovativ i karikimit të baterisë, i përdorur në karikuesit tanë të shpejtë shkurton kohën totale të karikimit deri në 30%, krahasuar me karikuesin tradicional që përdor të njëjtën sasi energjie. Procesi gjithashtu siguron karikim të butë, pa mbingarkuar baterinë.

Çelësi i aktivizimit



Është e mundur të vihen në punë veglat e punës që kanë bateri të integruar, vetëm nese keni çelësin e aktivizimit. Nëse hiqni çelësin e aktivizimit, vegla e punës nuk furnizohet me energji. Në këtë gjendje, mjetet mund të pastrohen, magazinohen dhe transportohen në mënyrë të sigurt.

Teknologjia STIHL EC



Motori elektrik (EC) nga STIHL është efikas në energji dhe pothuajse totalisht rezistent ndaj konsumimit falë veçorive në elektronikën e STIHL EC. Si një qendër komutuese inteligjente, ai zbulon baterinë e vendosur në trupin e mjetit në çdo pikë kohore dhe furnizon motorin EC me fuqinë e duhur nga bateria. Kjo siguron dhe mundëson që mjeti të ketë gjithmonë në dispozicion fuqinë optimale të disponueshme.

Përdorimi në kohë me shi



Veglat e punës me bateri STIHL, të pajisura me këtë simbol mund të përdoren edhe në shi. Shenjat e informacionit në mjet dhe në manualin e përdorimit duhen marrë në konsideratë gjithashtu.

Të gjitha aparatet me bateri brenda sistemit AP STIHL janë konceptuar për përdorues profesionistë, për përdorim të përditshëm edhe në kushte moti të këqija.

Për rrjedhojë, këto produkte janë të pajisura me sistem mbrojtës nga lagështia. Efikasiteti vërtetohet nga kontrollet e brendshme rigorozë. Testi i mbrojtjes nga lagështia, ndër të tjera orientohet nga standarti IPX4.

Mbajini bateritë larg nga ambientet me kripë dhe nga lëngjet e kontaminuara. Thajeni baterinë dhe veglën e punës pas përdorimit. Në përgjithësi, karikuesit duhet të përdoren vetëm në zona të thata.

Përdorimi pa mbrojtjet e veshëve



Teknologjia me bateri i bën këto mjete pune ideale për zona sensitive ndaj zhurmave, si kopshte spitalesh, parqe dhe zona rezidenciale. Shihni udhëzimet në manualin e përdorimit.

2 MOTOSHARRA DHE KRASITËSE DEGËSH NË LARTËSI

MOTOSHARRA ME BENZINË

Leva kryesore e kontrollit


Të gjitha funksionet, si ndezja, operimi dhe ndalimi mund të kryhen me vetëm një dorë.

Doreza të ngrohura me elektricitet (W)



Dorezat e ngrohura në mënyrë elektrike (W) i mbajnë duart tuaja të ngrohta e të thata për shtrëngim më të mirë, duke e bërë punën tuaj më të sigurt gjatë dimrit. Fletët ngrohëse për mirëmbajtje në rast nevojë mund të ndizen duke e mbajtur dorezën të ngrohtë dhe të thatë.

Ngrohja e karburatorit elektrik (V)



Karburatori me ngrohje elektrike (V) i pajisur me termostate e parandalon ngrirjen e karburatorit në stinën e dimrit.

Struktura ergonomike e dorezës

Lejon mbajtje të thjeshtë të sharrës në çdo pozicion pune.

Guida për rrëzimin e pemëve

Linjat e ngritura që veprojnë si guida për rrëzimin e pemëve janë integruar në strukturën e motosharrës për kontroll më të mirë në drejtim gjatë rrëzimit të pemëve.

Filtri HD2

Filtri HD2 përbëhet nga material filtri prej polietileni me pore deri në 70% më të holla se filtrat e tjerë. Si rrjedhojë, ai kap edhe pluhurat më të imta. Ai është gjithashtu i papërshkueshëm nga uji dhe vaji. Bobina e filtrit rrumbullak është e veshur nga mbrojtja PET me kyçin me shpërhapje të shpejtë dhe mundëson për filtrin të montohet dhe çmontohet brenda një kohe shumë të shkurtër dhe pa nevojë për mjete shtesë.

Doreza e pasme e dorës

Mbron dorën e përdoruesit kundër degëve ose pjesëve të zinxhirit të sharrës nëse bien ose prishen.

Kompensues

Ky e mban konstant përzierjen karburant-ajër kur filtri i ajrit ndotet gjithmonë e më shumë.

Sistem filtrimi ajri me kohëzgjatje të lartë

Motosharra STIHL është e pajisur me sistem filtrimi ajri me kohëzgjatje të lartë, dhe përmban sistem filtrimi me ndarje paraprake ose me filtër ajri HD2. Koha e përdorimit të filtrave është shumë e gjatë, në krahasim me sistemet e zakonshme të filtrimit. Sistemi i filtrimit me kohëzgjatje të lartë siguron jetëgjatesinë e motorit dhe parandalon mbylljen e para-kohshme të pistonit dhe cilindrave dhe ndotjen e mishelës.

Pistona magnezi

Për herë të parë në mbarë botën, STIHL ka ndërtuar motorin MS 400 C-M me pistona magnezi. Ky motor peshon 20 gramë më pak se motori i ngjashëm me pistona alumini, çfarë sjell si pasojë reduktimin e peshës me 25%, vetëm përse i përket kësaj pjese qendrore të produktit. Përdorimi i materialeve të lehta, duke u ndërthurur me strukturën e qëndrueshme të MS 400 C-M e bëjnë peshën e motorit vetëm 5.8 kilogramë, duke e reduktuar peshën e rendimentit më pak se 1.5 kilogram për kilowatt. Në të njëjtën kohë, kjo pjesë e re e produktit mundëson xhiro maksimale, veçanërisht efikase në vazhdimësinë e thjeshtë të punës gjatë krasitjes së degëve.

Pompë karburanti manuale

Sharrat me zinxhir STIHL dhe gërrshërët me bosht me pompa manuale karburanti mundësojnë ndezje të përmirësuar me numër më të vogël tërheqjesh. Shtypja e ushqyesit e mbush dhomëzën e karburatorit me karburant.

Kjo siguron që të ketë karburant të mjaftueshëm për të krijuar përzierjen e ndezshme ajër-karburant për ndezje, duke nevojitur shumë më pak tërheqje ndezëse.

Pompë vaji me dërgim të kontrolluar


Gjatësitë e shiritit, llojet e drurit dhe teknikat e ndryshme të sharrimit kërkojnë sasi të ndryshme vaji. Pompa e vajit me çlirim të kontrolluar i mundëson përdoruesit të zgjedhë sasinë e duhur të vajit për punën që po kryen.

Tendosje e zinxhirit e montuar në anë

Kjo mundëson një mënyrë të volitshme për tendosjen e zinxhirit të sharrës pa rrezikuar kontaktin me zinxhirin e mprehtë.

Udhëzues prerjeje

Për kontroll më të mirë gjatë drejtimit të prerjes, vija të ngritura që veprojnë si udhëzues prerjeje janë integruar në modelin e boshtit.

Motor STIHL 2-MIX

Motori STIHL 2-MIX është i fuqishëm dhe ekonomik. Ndarja e emetimeve nga gazi i padjegur minimizon mbetjet e lëshuara, duke rritur në këtë mënyrë fuqinë dhe duke ulur konsumin.

Sistemi STIHL kundër dridhjeve

Zonat ndarëse të përlogaritura në mënyrë precize, minimizojnë transferimin e dridhjeve të motorit dhe zinxhirit të sharrës tek dorezat e parme dhe të pasme. Kjo nënkupton se motosharra funksionon shumë më butë dhe lejon përdoruesin të kursejë forcën e ushtruar dhe të punojë më gjatë.

STIHL ElastoStart

Për shkak të presionit të ngjeshjes, ushtrime force ndodhin kur tentojmë të ndezim motorët me djegie të brendshme. Elementi amortizues në litarin special të ndezjes me ElastoStart absorbon dhe lëshon forcën në mënyrë të alternuar, në përputhje me modelin e ngjeshjes. Rezultati është ndezje e butë dhe e njëtrajtshme.

STIHL ErgoStart (E)

Tërheqja e njëtrajtshme në litarin e ndezjes tensionon sustën përkundrejt presionit të ngjeshjes. Presionet e shkaktuara nga lëvizjet e vrullshme shmangen. Susta automatikisht lëshon energjinë e ruajtur tek boshti motorik, e lëviz dhe siguron që motori të ndizet në mënyrë të besueshme. Kjo lejon litarin e ndezjes të tërhiqet dy të tretat më ngadalë.

STIHL Injection (i)**STIHL INJECTION**

Teknologjia e injektimit mundëson funksionim shumë të thjeshtë. Leva combi nuk është më e nevojshme - gjithçka i duhet përdoruesit të fikë veglën e punës është një buton ndalues. Menaxhimi totalisht elektronik i motorit me karakteristikat e sensorëve garanton performancë optimale të motorit dhe përshpejtim të shkëlqyeshëm në çdo kusht përdorimi. Njësia e kontrollit përdor matje në kohë reale për të llogaritur sasinë e saktë të karburantit dhe kohën ideale të ndezjes. Karburanti injektohet direkt në shasi me anë të valvulës së injektimit. Kombinimi unik i inxhinierisë së lehtë dhe i teknologjisë së avancuar të motorit siguron raportin më të mirë peshë-fuqi në treg, të kombinuar me një strukturë kompakte të veglës së punës.

Tendosje e shpejtë e zinxhirit STIHL (B)

Zinxhiri i sharrës mund të tendoset shpejt dhe thjesht, duke kthyer rrotën rregulluese. Po të kthejmë rrotën rregulluese në të majtë lirojmë zinxhirin, ndërsa po ta kthejmë në të djathtë e shtrëngojmë zinxhirin. Shina sigurohet automatikisht në vend kur kapaku i yllzës ritendoset.

STIHL M-Tronic (M)**STIHL M-TRONIC**

Menaxhimi tërësisht elektronik rregullon ritmin e ndezjes dhe matjes së karburantit në të gjitha kushtet e përdorimit, duke marrë parasysh faktorët e jashtëm si temperatura, lartësia dhe cilësia e karburantit. Vazhdimisht garanton performancë optimale të motorit, xhiro maksimale konstante dhe performancë përshpejtimi shumë të mirë. Nuk nevojitet rregullim manual i karburatorit me M-Tronic. Falë dallimit elektronik të ndezjes së ftohtë/ngrohtë, leva combi tashmë ka vetëm një pozicion ndezjeje. Motori ndizet me më pak tërheqje dhe pa e ndryshuar pozicionin, si dhe mund të përshpejtohet menjëherë, madje edhe pas ndezjes së ftohtë. Gjithashtu, funksioni M-Tronic kujton parametrat e herës së fundit të përdorimit të veglës. Në këtë mënyrë, kur faktorët e jashtëm janë njësoj, performanca e plotë e motorit ju vihet në dispozicion menjëherë pas çdo ndezjeje.

Funksioni i butonit ndalues

Pasi makineria fiket, leva e kontrollit lëviz pas në pozicion operimi. Kjo lejon që një makineri e ngrohtë të rindizet direkt.

Serbator karburanti transparent

Lejon përdoruesin të kontrollojë nivelin e karburantit thjesht dhe shpejt, pa patur nevojë të hapë serbatorin e karburantit.

Sistemi para-ndarës


Sistemi para-ndarës në motosharrat STIHL shërben për pastrimin paraprak të ajrit duke mundësuar ndjeshëm lehtësimin e sistemit të filtrimit. Ajri i thithur kalon fillimisht nëpërmjet ventilatorit. Kjo bën të mundur nxjerrjen jashtë të copave të mëdha dhe të rënda të pjesëve të papastra. Ajri i para-pastruar kalon prapa ventilatorit nëpërmjet kanalit të para-ndarjes në filtrin e ajrit, psh në filtrin e ajrit HD2 e më pas direkt në motosharrë. Sistemi para-ndarës është i thjeshtë në servis dhe mirëmbajtje, duke mos patur nevojë për trajtim të veçantë.

Kapak i depozitës së karburantit që hiqet pa vegla

Tapat speciale ju lejojnë të hapni dhe mbyllni tapat e serbatorit shpejt, thjesht dhe pa vegla shtesë.

SHARRË ELEKTRIKE ME ZINXHIR**Mbrojtje mbingarkese**

Në rast mbingarkese, motori elektrik fiket automatikisht për t'u mbrojtur nga dëmtimet e shkaktuara nga mbinxehja. Tek veglat nga MSE 141 tek MSE 210, aktivizohet një buton mbingarkese. Nëse çelësi shtypet pas një periudhe të shkurtër pritjeje, makineria mund të rindizet. MSE 230 dhe MSE 250 kanë monitorim elektronik për temperaturën e motorit. Nëse kjo temperaturë është shumë e lartë, një dritë e kuqe LED ndizet, duke treguar kështu gjendjen korresponduese të motorit. Pas rreth 1 minute, motori do të jetë ftohur dhe sharra me zinxhir mund të përdoret përsëri.

3 MJETE PRERËSE**ZINXHIRËT E SHARRËS****Perçina të përforcuara**

Çdo perçinë në një sharrë me zinxhir STIHL është përforcuar me induksion, duke e ndryshuar strukturën e konstruktit metalik. Si rrjedhim perçinat janë bërë më të forta dhe rezistente ndaj konsumimit.

Dhëmbëza shpimi të lëmuara

Është përdorur një teknikë speciale stampimi për t'u dhënë dhëmbëzave të shpimit të STIHL një lëmim si pasqyrë. Kjo përmirëson vetitë e zinxhirit dhe rrit jetëgjatësinë e shërbimit.

Shtresë e kromuar e fortë

Të gjithë dhëmbët e zinxhirit të sharrës STIHL përbëhen prej çeliku special. Një shtresë kromi është galvanizuar në shtresat e sipërme të prerësit për të arritur rezistencë të lartë kundër konsumimit. Kjo do të thotë se dhëmbët mbeten të mprehtë për kohë më të gjatë.

Tensioni

Hapi i fundit për prodhimin e zinxhirëve të sharrës STIHL përfshin ekspozimin ndaj një ngarkese të lartë dhe të qëndrueshme zgjatimi. Kjo tendosje ul çdo zgjatim të mëpasshëm të zinxhirit kur përdoret për herë të parë deri në një minimum absolut, rrit jetëgjatësinë e tij dhe minimizon konsumimin dhe këputjen.

Sistem lubrifikimi STIHL Oilomatic

Kanalet e ngushta të vajit në zinxhirin e sharrës drejtojnë lubrifikantin e zinxhirit direkt në nyjet e veshura të zinxhirit. Vrimat në të cilat mund të mblidhet lubrifikanti i zinxhirit janë stampuar në të dyja fundet e lidhjeve të dhëmbëve prerës. Kjo lejon një shpërndarje më të mirë të vajit përgjatë sipërfaqeve të rrëshkitshme të shinave dhe përmirëson lubrifikimin me 10% krahasuar me veglat pa vrima në dy anët fundore.

SHINAT DREJTUESE

Përshkrimin e hollësisëm të shinave STIHL mund ta gjeni në faqen 72 dhe 73.

Grykë shine e zëvendësueshme

Nëse gryka e shinës konsumohet, mund të zëvendësohet lehtë plotësisht bashkë me kushinetat rul (që ndodhen te shinat Rollomatic ES dhe Rollomatic ES Light).

Shina me konstruktion të lehtë

Shinat e lehta E Light dhe ES Light të STIHL ndryshojnë si strukturë. Shinat E Light përbëhen nga pllakëza çeliku të salduara në mënyrë elektrike, shumë të gërryera dhe të mbushura me poliamid fibrash xhami të përforcuar. Kjo i bën shinat tepër të lehta. Te shinat ES Light, boshllëqet priten dhe saldoohen përmes një procesi special me lazer. Kjo prodhon një trup bosh tepër të fortë me strukturë elastike të jashtme e të brendshme. Të dyja modelet kanë peshë më të lehtë dhe ekuilibër më të mirë të sharrës me zinxhir. Qendra e gravitetit të sharrës suaj me zinxhir zhvendoset drejt trupit tuaj, duke e ulur së tepërmi ngarkesën në kurriz.

Gjatësia e shinës

Gjatësia aktuale e prerjes është më e shkurtër se gjatësia e specifikuar e shinës dhe ndryshon në varësi të modelit të motosharrës.

Sistemi STIHL Ematic

Sistemi STIHL Ematic redukton konsumin e vajit të zinxhirit sipas mënyrës së prerjes dhe llojit të drurit deri në 50% në krahasim me mënyrën e prerjes pa Ematic. Ky sistem përmban një shinë STIHL Ematic ose Ematic S, një sharrë me zinxhir STIHL Oilomatic dhe një pompë vaji me rrjedhje të ndryshueshme ose të pakësuar. Si rezultat, gati çdo pikë e lubrifikuesit të zinxhirit shpërndahet pikërisht në vendin e duhur.

Ingranazh maje me kushineta rul të puthitura

Kushinetat e puthitura parandalojnë ndryshkjen duke bllokuar ndotjet dhe papastërtitë. Nevojitet më pak mirëmbajtje sepse lubrifikimi zgjat për gjithë jetëgjatësinë e përdorimit të shinës. Kjo rrit jetëgjatësinë e përdorimit të kushinetave deri në 80% në krahasim me kushinetat me vrimë vaji. Ingranazhi në majë është i zëvendësueshëm.

4 SISTEMI KOMBI DHE SISTEMI MULTI

Dekompresim automatik

Sistemi i dekompresimit hap automatikisht valvulën e hyrjes gjatë ndezjes së motorit. Kjo parandalon pikun e presionit dhe ul së tepërmi forcën e nevojitur për tërheqjen e kordonit të ndezjes.

Dorezë në formë laku (R) me shufër pengese

Shufra pengesë në dorezën rrumbullake parandalon afrimin e këmbëve dhe shputave tek tehet ose kokat kositëse.

Funksioni i shpërhapjes së shpejtë me vidhë flutur me vidhë flutur

Lidhja novatore me shkëputje të shpejtë mundëson që të gjithë motorët Kombi dhe veglat Kombi të çmontohen dhe rimontohen shpejt, pa nevojën e veglave.

5 KORRËSE ROBOTIKE, KORRËSE ME SHTYRJE, TRAKTORË KORRËS DHE PAJISJE AJROSËSE

KORRËSET ROBOTIKE

Plan i fuqishëm korrjeje

Koha javore kur korrësja robotike iMow është aktive shfaqet e organizuar tek plani i fuqishëm i korrjes. Brenda kësaj kohe aktive, korrëset robotike kryejnë punën dhe karikojnë bateritë mbi një bazë fleksible. Nëse ndalojnë korrjen për shkak të shiut për shembull, ato përfundojnë korrjen në mënyrë të pavarur më vonë, brenda kornizës kohore të specifikuar.

KORRËSET ME SHTYRJE

Bashkimi i teheve prerëse me frenat

Bashkimi i teheve prerëse me frenat përdoret në modelet e korrëseve më të mira me benzinë të kësaj kategorie. Ky funksion ndan tehet prerëse nga motori, në të tillë mënyrë që korrësja përdoret edhe pa funksionuar tehet prerëse. Koshi grumbullues i barit mund të boshatiset pa patur nevojë të rindezim motorin. Gjithashtu, kombinimi i frenave me tehet prerëse siguron mbrojtje efikase të boshtit motorik.

Dorezë e rehatshme

Dorezat e rehatshme mund të përshtaten sipas gjatësive të ndryshme të përdoruesve pa patur nevojë për mjete shtesë, duke mundësuar kështu punë ergonomike. Pjesa e palosshme e dorezës nënkupton se korrëset e barit me këtë veçori mund të transportohen më thjesht dhe mund të ruhen duke kursyer hapësirën. Kjo strukturë e veçantë bën gjithashtu të lehtë edhe heqjen e kosit grumbullues të barit.

Tehet prerëse Multi

Forma e teheve prerëse Multi mundëson që prerjet njëkohësisht të kapen, pastrohen apo të plehërohen - që do të thotë se nuk është më e nevojshme të ndryshohen tehet prerëse për të kryer detyra të ndryshme. Tehu prerës grin barin dhe e kalon në një rrymë ajri ose për plehërim e shpërndan atë në mënyrë të njëtrajtshme, në sipërfaqet jeshile.

Shfaqja e nivelit të mbushjes

Qarkullimi i ajrit të gjeneruar nga tehu prerës ngren treguesin e nivelit të mbushjes. Nëse koshi është plot, qarkullimi i ajrit ndalon. Nëse ka shumë pak ajër, treguesi i nivelit të mbushjes kthehet në një gjendje boshe, që do të thotë se koshi grumbullues duhet zbratur. Treguesi i nivelit të mbushjes punon pa kufizime vetëm nëse ka qarkullim optimal të ajrit. Faktorë të jashtëm, si lagështia, densiteti apo bari i gjatë, nivelet e ulta të prerjes, papastërtitë apo faktorë të tjerë të ngjashëm mund të kufizojnë qarkullimin e ajrit dhe të ndalojnë treguesin e nivelit të mbushjes së funksionuarit në mënyrë normale.

Dorezë shumë e butë

Doreza ergonomike, shumë e butë, është e kënaqshme për t'u mbajtur dhe siguron një eksperiencë të rehatshme korrjeje, duke ndaluar kështu edhe lodhjen e tepërt për përdoruesin.

Shpejtësi variable e rrotës Vario

Shpejtësia e rrotës mund të përshtatet, pavarësisht shpejtësisë së motorit, që do të thotë se performanca e prerjes dhe kapjes qëndrojnë konstante. Vënia në punë e këtij funksioni kryhet nëpërmjet një leve në timonin e drejtimit ose në bosht.

TRAKTORËT KORRËS

Amortizues dridhjes rrotulluese

Amortizuesi i dridhjeve rrotulluese redukton nivelin e dridhjeve që ndodhin - jo vetëm në sedilje, por gjithashtu në rrotën drejtuese dhe në vendin e këmbëve.

6 MOTOKOSA DHE SHARRA PASTRIMI

Dekompresim automatik

Sistemi i dekompresimit ul presionin e kompresimit dhe nëpërmjet kësaj edhe forcën e nevojitur për tërheqjen e kordonit të ndezjes. Kjo bën të mundur që motori të ndizet më lehtë.

ECOSPEED

Me funksionin ECOSPEED, mund ta përdorni sharrën pastruese në një modalitet përdorimi më ekonomik. Thjesht rrotullojeni rrotën në drejtimin minus, duke ulur si rrjedhim xhivot maksimale të motorit. Kjo bën që sharra pastruese të funksionojë me fuqi të pjesshme. Sidoqoftë, pavarësisht nga ky parametër i kufizuar mund të kaloni në kapacitet të plotë duke shtypur levën e gazit. Duke e përdorur me fuqi të pjesshme, ulet konsumi i karburantit dhe mund të punoni më gjatë me një serbator karburanti. Gjithashtu mjete ka një prirje të dukshme më të ulët për të rrëshqitur kur funksionon me fuqi të pjesshme në krahasim me fuqinë e plotë.

Dorezë ergonomike në formë biçiklete

Doreza në formë biçiklete mundëson lëvizje natyrale të fshirjes kur kositni dhe është zgjedhja më e mirë për kositjen e zonave të gjera. Kombinojeni me sistemin e rripave universalë ADVANCE ose rripa pylltarie ADVANCE dhe veglën e duhur për ta bërë kositjen edhe më pak të mundimshme.

Fijet e kositjes

Fijet e kositjes disponohen në forma dhe fortësi të ndryshme për zbatime të ndryshme. Një gjurmë spirale e stampuar në fijen e kositjes i bën disa fije më pak të zhurmshme se fijet rrethore të zakonshme të kositjes.

Gjurmët në sipërfaqen e fijes ndërpresin rrymën uniforme të ajrit. Krijohet turbulencë, efekti fishkëllyes pakësohet dhe zhurma e kositjes bëhet shumë më e qetë.

Përshtatja e dorezës në formë biçiklete

Morseta qendrore i mundëson dorezës në formë biçiklete të ndryshohet lehtësisht, pa vegla shtesë, për t'iu përshtatur gjatësisë së përdoruesit. Doreza mund të rrotullohet me 90°, duke e bërë më kompakte për transport dhe magazinim.

Motor STIHL 2-MIX

Motori STIHL 2-MIX është i fuqishëm dhe ekonomik. Ndarja e emetimeve nga gazi i padjegur minimizon mbetjet e lëshuara, duke rritur në këtë mënyrë fuqinë dhe duke ulur konsumin.

Motori STIHL 4-MIX®

Motori STIHL 4-MIX® përdor kombinimin standard të benzinës me vajin (1:50). Kjo përzierje shpërndahet përgjatë motorit përmes një kanali kalimi në kokën cilindrike, duke siguruar lubrifikim të gjithanshëm. Ky sistem i përzierjes dhe lubrifikimit shmang nevojën për komponentë, si pompa e vajt, e thithjes dhe serbatori i vajit.

STIHL ElectroStart (F)

Mundëson përdoruesit të rindezin veglën shpejt dhe thjesht me shtypjen e një butoni, në temperatura mbi 0°C, pa patur nevojën ta heqin nga kurrizi si fillim.

STIHL M-Tronic (M)**STIHL M-TRONIC**

Menaxhimi tërësisht elektronik rregullon ritmin e ndezjes dhe matjes së karburantit në të gjitha kushtet e përdorimit, duke marrë parasysh faktorët e jashtëm si temperatura, lartësia dhe cilësia e karburantit. Vazhdimisht garanton performancë optimale të motorit, xhiro maksimale konstante dhe performancë përsheptimi shumë të mirë. Nuk nevojitet rregullim manual i karburatorit me M-Tronic. Falë dallimit elektronik të ndezjes së ftohtë/ngrohtë, leva combi tashmë ka vetëm një pozicion ndezjeje. Motori ndizet me më pak tërheqje dhe pa e ndryshuar pozicionin, si dhe mund të përsheptohet menjëherë, madje edhe pas ndezjes së ftohtë. Gjithashtu, funksioni M-Tronic kujton parametrat e herës së fundit të përdorimit të veglës. Në këtë mënyrë, kur faktorët e jashtëm janë njësoj, performanca e plotë e motorit ju vihet në dispozicion menjëherë pas çdo ndezjeje.

7 PRERËSE GARDHESH DHE PRERËSE GARDHESH NË LARTËSI**Mbrojtëse e vidhosur tek maja e tehut prerës**

Ky komponent në formë T-je, i përbërë nga fletë çeliku i bashkohet majës së tehut prerës me dy vidha. Mbron majën e tehut prerës nga kontakti me tokën ose muret dhe mund të zëvendësohet lehtësisht nëse konsumohet. It can be replaced easily if it becomes worn.

Sistem i lehtë ingranazhesh

Magnezi është një material i rëndësishëm për motosharrat STIHL. Është afërsisht një të tretat më i lehtë se alumini dhe mundëson forcë të madhe në raport me peshën e tij. Krahasuar me materialet e tjera, magnezi pozicionohet veçanërisht mirë për përpunim dhe gdhendje me precizion të lartë, për shembull në prodhimin e kapakëve të motorit. Këto cilësi e bëjnë materialin e duhur për të prodhuar një njësi transmisioni dinamike. Mundet gjithashtu të riciklohet - pjesët e konsumuara mund të shkrihen dhe ripërdoren pa humbje cilësie.

Pompë karburanti manuale

Prerëset e gardheve dhe prerëset e gardheve në lartësi, me pompa manuale karburanti mundësojnë ndezje të përmirësuar me numër më të vogël tërheqjesh. Shtypja e ushqyesit e mbush dhomëzën e karburatorit me karburant. Kjo siguron që të ketë karburant të mjaftueshëm për të krijuar përzierjen e ndezshme ajër-karburant për ndezje, duke nevojitur shumë më pak tërheqje ndezëse.

STIHL ErgoStart (E)

Tërheqja e njëtrajtshme në litarin e ndezjes tensionon sustën përkundrejt presionit të ngjeshjes. Presionet e shkaktuara nga lëvizjet e vrullshme shmangen. Susta automatikisht lëshon energjinë e ruajtur tek boshti motorik, e lëviz dhe siguron që motori do të ndizet në mënyrë të besueshme. Kjo lejon litarin e ndezjes të tërhiqet dy të tretat më ngadalë.

Kapak i depozitës së karburantit që hiqet pa vegla

Tapat speciale ju lejojnë të hapni dhe mbyllni tapat e serbatorit shpejt, thjesht dhe pa vegla shtesë.

PRERËSE GARDHESH**Dorezë rrotulluese multifunkionale**

Doreza rrotulluese e kontrollit mundëson shtrëngim optimal për çdo përdorues - për përdorim të thjeshtë dhe të sigurt.

HS 82 R dhe HSA 94 R, versioni krasitës (R)

Për prerjen e sasive të mëdha dhe pastrimin e shkurreve të mëdha në gardhet e gjera dhe të trasha:



- Hapësirë e gjerë ndërmjet dhëmbëve
- Dhëmbë të mëdhenj
- Raport ingranazhesh për fuqi të lartë prerëse

HS 82 T dhe HSA 94 T, versioni prerës (T)

Për prerje dhe konturim perfekt:



- Hapësirë e ngushtë ndërmjet dhëmbëve
- Dhëmbë të vegjël
- Raport ingranazhesh për ritëm goditjeje të lartë

PRERËSE GARDHESH NË LARTËSI**Gjatësi boshti sipas nevojës**

Prerëset e gardheve në lartësi me bosht të zgjatur përdoren kryesisht për gardhe të lartë e të gjerë. Versionet K më të shkurtra me një tub doreze të zgjatur janë vegla praktike për të punuar me gardhet e shkurtra.

ECOSPEED

Me funksionin ECOSPEED, mund ta përdorni prerësen e gardhit në lartësi, në një mënyrë më ekonomike. Thjesht rrotullojeni rrotën në drejtimin minus, duke ulur si rrjedhim xhirot maksimale të motorit. Kjo bën që prerësja e gardhit në lartësi të funksionojë në fuqi të pjesshme. Sidoqoftë, pavarësisht nga ky parametër i kufizuar mund të kaloni në kapacitet të plotë, duke shtypur levën e gazit. Duke e përdorur në fuqi të pjesshme, ulet konsumi i karburantit dhe mund të punoni më gjatë me një serbator karburanti ose me një karikim të vetëm baterie.

Sistem përshtatjeje me shkëputje të shpejtë të kokës prerëse

Tehu prerës mund të përshtatet me rritje deri në 130° (HL 91), deri në 145° (HL 94, HLA 135), deri në 115° (HLA 66, HLA 86), deri në 135° (HLA 56),

deri në 125° (HLE 71)

dhe mund të paloset e bllokohet paralelisht me boshtin për t'u transportuar.

Doreza rrumbullake

Doreza kompakte rrumbullake përbëhet nga plastikë rezistente e zezë. Kurba pothuajse 180° C lejon dorezën të përshtatet në pozicione të ndryshme, veçanërisht kur punohet në zona ku hapësira është e kufizuar.

8 GRIRËSE DEGËSH**TEKNOLOGJIA RROTULLUESE BRS**

Drejtimi i teheve grirëse mund të ndryshohet lehtësisht. Kur thikat rrotullohen në krah orar, makineria mund të grijë materiale të forta si degë të trasha dhe të dendura, ndërsa kur rrotullohen në krah të kundërt me akrepat e orës, kthejnë mbetjet e buta në lëndë të dekompozueshme. Duke e përdorur pajisjen në këtë mënyrë, ju mbron tehet prerëse në mënyrë efikase.

9 KULTIVATORË**Sistemi kundër dridhjes**

Sistemi kundër dridhjes është i integruar në pajisje. Ai redukton dridhjet në dorezë, që do të thotë se gjithashtu kërkohet më pak mundim kur përdorim pajisjen.

Tehet grirëse

Tehet grirëse kanë formë të zhvilluar veçanërisht për kultivatorët dhe gërmojnë tokën, në mënyrën më efikase të mundshme me një procedurë optimale veprimi.

10 SISTEME PASTRIMI**FRYRËSET****Komplet pastrimi i brazdave**

Kompleti i dobishëm për pastrim, afërsisht 3 m i gjatë, për fryrëset dhe copëzuesit me vakuum ju mundëson të pastroni brazdat, madje edhe ato që janë të vështira për t'u arritur.

Konvertues katalitik (D)

Ul së tepërmi sasinë e ndotësve në emetimet e shkarkuara.

Pompë karburanti manuale

Fryrëset STIHL me pompa manuale karburanti mundësojnë

ndezje të përmirësuar me numër më të vogël tërheqjesh. Shtypja e ushqyesit e mbush dhomëzën e karburatorit me karburant. Kjo siguron që të ketë karburant të mjaftueshëm për të krijuar përzierjen e ndezshme ajër-karburant për ndezje, duke nevojitur shumë më pak tërheqje ndezëse.

STIHL ElastoStart

Ky amortizator special mbi kordonin e motorinos garanton ndezjen pa ngecje dhe pa ngarkesë maksimale. Elementi i brendshëm zbutës zbut forcën e gjeneruar gjatë ndezjes. Dhe kjo e bën procedurën e ndezjes akoma më të lehtë.

STIHL ElectroStart (F)

Mundëson përdoruesit të rindezin veglën shpejt dhe thjesht me shtypjen e një butoni, në temperatura mbi 0° C, pa patur nevojën ta heqin nga kurrizi si fillim.

COPËZUESIT**Copëzues në formë ylli**

Copëzuesi në formë ylli i përbërë me çelik të pandryshkshëm të cilësisë së lartë siguron copëzim të sigurt të fragmenteve të SH 56 dhe SH 86.

MAKINERITË FSHIRËSE**STIHL MultiClean përfaqëson një sistem fshirjeje të zgjuar.**

Furçat qarkore pastrojnë papastërtitë përpara makinerisë fshirëse, para se të kapen poshtë saj.

PASTRUESIT ME PRESION TË LARTË**Dorezë teleskopike prej alumini**

Doreza teleskopike prej alumini mund të tërhiqet për t'u transportuar lehtësisht dhe kursyer hapësirë magazinimi.

Funksion kundër përdredhjeve

Parandalon përdredhjet e tubit me presion të lartë. Kjo do të thotë se mund të përdoret gjithmonë gjatësia e plotë.

Mbajtëse e dyfishtë për tuba

Për mbajtjen e volitshme, si të tubit spërkatës, edhe të grykës rrotulluese të tubit.

Kapak i përpamë me palosje

Mbajtësit e integruar të grykës nën kapakun e përpamë sigurojnë ruajtjen e sigurt dhe pa pluhur të grykave rrotulluese dhe të rrymës së ujit. Kjo mundëson ruajtje të lehtë dhe përdorim të shpejtë të të dyja grykave kur nevojiten.

Matësi i presionit

Me matësin e presionit, ju gjithmonë shikoni presionin aktual të funksionimit.

Modelet PLUS



Variantet e modeleve me PLUS në emrin e modelit kanë një mbështjellëse tubi të integruar për magazinim të rehatshëm dhe të sigurt të tubit me presion të lartë. Doreza mund të paloset për transportim dhe magazinim më të thjeshtë.

Sistem matës detergjenti

Sistemi matës ju mundëson të shtoni lehtësisht sasinë e duhur të agjentit pastrues në ujë. Kjo nuk shkakton ndotje të ambientit dhe është efikase. Të gjitha modelet me rezervuar detergjenti mund të lidhen edhe me rezervuarë të jashtëm të detergjentit.

Fikje sigurie

Për mjetet e pajisura me fikje sigurie, mjeti i ndezur stakohet automatikisht nga burimi i energjisë pas 30 minutash nëse nuk është në funksionim.

Tub tekstil i sheshtë me mbajtëse



Tub më i lehtë dhe më elastik me presion të ulët për lidhjen e pastruesit me presion të lartë me ujin e rrjetit shpërndarës. Duke përdorur mbajtësin e dhënë, tubi tekstil i sheshtë mund të mblidhet dhe shpëstillet lehtësisht si dhe të ruhet në këtë dhomëz. Në këtë mënyrë do të keni gjithshka që ju duhet aty ku ju duhet.

FSHIRËSE ELEKTRIKE PËR SIPËRFAQE TË THATA DHE TË LAGËSHTA

Përshtatës për veglat motorike



Ky përshtatës i mundëson veglën motorike të lidhet direkt me tubin e vakuumit. Më pas pluhuri dhe ndotjet fshihen direkt me vakuum gjatë sharrimit ose gërryerjes.

Dorezë prej çeliku të pandryshkshëm me funksion me shpërhapje të shpejtë

Ky funksion me shpërhapje të shpejtë bën të mundur bashkimin e shpejtë dhe të lehtë të tubit thithës me dorezën.

Sistem me shumë filtra

Një shkallë më e madhe filtrimi arrihet duke kombinuar çantën e filtrit me elementin filtrues.

Fikje me vonesë

Një shkallë veçimi akoma më e lartë arrihet nga kombinimi i trastës së filtrit dhe filtrit kryesor. Fisheku i filtrit që mund të lahët është higjienik, ekonomik dhe nuk ndot ambientin.

Ndezje e butë

Ndezja e butë kufizon korrentin fillestar kur vakuumi është ndezur, duke rritur jetëgjatësinë e funksionimit të motorit.

11 PAJISJE SPËRKATËSE

Gryka e spërkatësit me ventilator



- Për spërkatjen e zonave dhe radhëve të gjera
- I përshtatshëm për shtretër lulesh, kultivimin e frutave dhe perimeve nëpër serra dhe kopshte
- Ideal për spërkatjen e zonave të gjera me insekticide, herbicide dhe fungicide

Grykë me zgavër në formë konike



- Për spërkatjen e shkurreve, pemëve dhe bimëve të veçuara
- Perfekt për përhapjen e insekticideve, herbicideve dhe fungicideve te bimët e veçuara të kopshtit
- Gryka ju mundëson të spërkatni bimët e gjethet nga sipër ose nga poshtë

Grykë e rregullueshme



- Mund të përshtatet me kushte të ndryshme dhe aplikime të ndryshme.
- Këndi spërkatës mund të rregullohet për një trend spërkatjeje optimal, nga grykë e plotë (0°) në grykë konike (90°).

Grykë konike e plotë



- Për trajtimin individual të bimësive.
- Ideale për dozim të rafinuar, psh. herbicide, etj.
- E përshtatshme për të aplikuar detergjentë të ndryshëm në industrinë e ndërtimit.

Sistemi STIHL kundër dridhjeve

Sistemi STIHL kundër dridhjeve pakëson transmisionin e dridhjeve të motorit. Kjo ul sforcimin e ushtruar nga muskujt e kurrizit të përdoruesit.

12 PRERËSE BETONI, MAKINERI PRERËSE DHE TURJELA PËR SHPIM NË TOKË

Motor STIHL 2-MIX



Motori STIHL 2-MIX është i fuqishëm dhe ekonomik. Ndarja e emetimeve nga gazi i padjegur minimizon mbetjet e lëshuara, duke rritur në këtë mënyrë fuqinë dhe duke ulur konsumin.

STIHL ElastoStart

Për shkak të presionit të ngjeshjes, ushtrime force ndodhin kur tentojmë të ndezim motorët me djegie të brendshme. Elementi amortizues në litarin special të ndezjes me Elasto-Start absorbon dhe lëshon forcën në mënyrë të alternuar, në përputhje me modelin e ngjeshjes. Rezultati është ndezje e butë dhe e njëtrajtshme.

PRERËSE BETONI

Gominë mbrojtëse

Kur prisni muret, kjo gominë e madhe e mbron strukturën e motorit kur shina është plotësisht e zhytur.

MAKINERI PRERËSE

Kontroll elektronik i ujit



Përdoruesi mund të aktivizojë sistemin e kontrollit elektronik të ujit përmes butonave të thjeshtë kur motori është në funksionim. Më pas uji aktivizohet automatikisht gjatë prerjes në varësi të shpejtësisë së motorit. Vëllimi i ujit mund të përshtatet duke shtypur thjesht butonat plus/minus. Rezultati: eliminim perfekt i pluhurit me një të shtypur të butonit. Funksioni i memories siguron që pasi motori të rindizet, e njëjta sasi uji të furnizohet në bazë të përdorimit tuaj më të fundit. Përdoruesit mund të fillojnë menjëherë punën pa zgjedhur parametrat, madje edhe pas një pushimi të gjatë.

Tendosja gjysmë automatike e rripit

Ritendosja e butë, e qëndrueshme rrit jetëgjatësinë funksionale të rripave dhe kushinetave.

Sistem jetëgjatë i filtrimit të ajrit me qarkullim të fuqishëm



Sistemi inovativ i qarkullimit të ajrit nënkupton që nuk ka më nevojë për pastrim të përditshëm të filtrit dhe mundëson një jetëgjatësi të shkëlqyer të tij. Ai gjithashtu siguron se, edhe gjatë fazës së parë të filtrimit, afërsisht 80% e grimcave të pluhurit në ajër pastrohen. Ndryshe nga sistemet tradicionale, këto grimca nuk mblidhen në filtrin e shkumës, por ndahen nga sistemi i qarkullimit të fuqishëm të ajrit dhe nxirren jashtë.

Sistem me montim të shpejtë

Ky sistem ju mundëson montim e çmontim të shpejtë të makinerisë prerëse në karrocën STIHL. Nuk nevojiten vegla për këtë.

Elemente mbrojtëse për disk prerës

Kur pritet asfalti, segmentet mbrojtëse parandalojnë konsumin e saldusit me lazer që lidh segmentet e tjera me pjesën kryesore të çelikut të tehut prerës. Gjithashtu, segmentet mbrojtëse parandalojnë konsumin e pabarabartë midis segmenteve të majta dhe të djathta, që do të thotë se disku prerës është i parandaluar nga bllokimi gjatë prerjes.

STIHL Injection (i)

STIHL INJECTION®

Teknologjia e injektimit mundëson funksionim shumë të thjeshtë. Leva combi nuk është më e nevojshme - gjithçka i duhet përdoruesit të fikë veglën e punës është një buton ndalues. Menaxhimi totalisht elektronik i motorit me karakteristikat e sensorëve garanton performancë optimale të motorit dhe përsheptim të shkëlqyeshëm në çdo kusht përdorimi.

Njësia e kontrollit përdor matje në kohë reale për të llogaritur sasinë e saktë të karburantit dhe kohën ideale të ndezjes. Karburanti injektohet direkt në shasi me anë të valvulës së injektimit. Kombinimi unik i inxhinierisë së lehtë dhe i teknologjisë së avancuar të motorit siguron raportin më të mirë peshë-fuqi në treg, të kombinuar me një strukturë kompakte të veglës së punës.

Kapak i depozitës së karburantit që hiqet pa vegla

Kapaku i serbatorit është i thjeshtë për t'u hapur me një shtypje dhe lëvizje rrotulluese, edhe kur vishen doreza. Falë strukturës së tij dhe tapës së dyfishtë, kapaku i serbatorit nuk mund të hapet aksidentalisht dhe grimcat e pluhurit nuk mund të futen në serbatorin e karburantit.

Frenat e rrotave prerëse STIHL QuickStop

Nëse operatori përdor përshtatës mbrojtëse të avancuar gjatë prerjes, rrota prerëse mund të aksesohet nga lart. Me këtë metodë pune, përdoruesi ndihmohet nga frenat e rrotave prerëse STIHL QuickStop. Nëse rezistenca rezulton në goditje kthyes, rrota prerëse ndalohet në fraksion sekondi, kjo e shkaktuar nga një sensor.

Përshtatësi i thellësisë së prerjes

Kjo mundëson përshtatjen e saktë të thellësisë së prerë nga doreza e sipërme.

TURJELA PËR SHPIM NË TOKË

Kornizë mbështetëse e palosshme



Korniza e BT 360 mund të paloset. Kjo e bën pajisjen të thjeshtë për t'u transportuar dhe magazinuar.

Dorezë shumëfunktionale



Doreza shumëfunktionale, me formë ergonomike, është e integruar në kornizën e dorezës së turjelës për shpim në tokë. Butoni ndalues dhe kabllat mund të manovrohen me një dorë.

Frenat e shpimit QuickStop



Nëse shpuesja bllokohet në tokë, frenat e shpimit QuickStop afrohen pas ijës së përdoruesit dhe ndalojnë pajisjen direkt. Gjithashtu veprojnë si një kyç kthyes rrotullues. Një shpuese e bllokuar mund të

hiqet lehtësisht nga gropa e shpuar duke e kthyer në drejtimin antiorar.

Motori STIHL 4-MIX®

Motori STIHL 4-MIX® përdor kombinimin standard të benzinës me vajin (1:50). Kjo përzjerje shpërndahet përgjatë motorit përmes një kanali kalimi në kokën cilindrike, duke siguruar lubrifikim të gjithanshëm. Ky sistem i përzjerjes dhe lubrifikimit shmang nevojën për komponentë, si pompa e vajit, e thithjes dhe serbatori i vajit.

13 VEGLA MANUALE DHE AKSESORË PYLLTARIE

Prerja Anvil



Tehu prerës bën kontakt direkt me tehu e kundërt dhe të gjerë. Tehu i kundërt dhe i gjerë quhet "anvil". Forcat anësore përdoren shumë pak, që do të thotë se druri i drejtë, i vdekur dhe i fortë mund të pritët përmes shumë lehtë. Me prerjet e buta dhe të freskëta, pjesa e poshtme e lëvores mund të hiqet para prerjes.

Prerja Bypass



Me këtë parim, tehu prerës dhe tehu anvil lëshohen kundër njëri-tjetrit gjatë prerjes. Prerja e formuar në këtë mënyrë është vazhdimisht e sheshtë, pa prishur prerjet e tjera. Prerja Bypass duhet të preferohet zakonisht për prerje jeshile. Për shkak të forcës së lartë të nevojitur për prerjen, shkurtuesit me prerjen anvil duhet të përdoren kur punohet në periudha të gjata me dru më të fortë.

Qafore mbrojtëse ndaj goditjeve dhe pllakë sigurie e mbërthyer me bulona



Doreza dhe koka formojnë një tërësi të pandashme falë kombinimit të mëngës mbrojtëse të gjatë prej çeliku, pykës në formë unaze, pllakës dhe vidhës së sigurisë. Rezultati është një lidhje tepër e qëndrueshme me avantazhe të shkëlqyera:

- Jetëgjatësi shërbimi e mjetit - që do të thotë vlerë e shkëlqyer për paratë e paguara
- Siguri perfekte në punë edhe me lëkundjet boshe

14 PAJISJE MBROJTËSE PERSONALE (PMP)

Urdhëresa (EU) 2016 / 425 - për pajisjet e mbrojtjes personale gjatë punës

Të gjitha produktet STIHL PPE përmbushin kriteret e sigurisë së shëndetit dhe asaj teknike, në përputhje me urdhëresën e Bashkimit Europian 2016 / 425 dhe janë të ndara në tre kategori rreziku:

- Kategoritë 1: PPE për mbrojtje nga rreziqë me efekt të vogël
 Kategoritë 2: PPE për mbrojtje nga rreziqë që nuk mbulojnë nga kategoritë 1 ose 3
 Kategoritë 3: PPE për mbrojtje nga rreziqë me pasoja të rënda, si psh vdekje ose dëme të pariparueshme

Produktet PPE të kategorisë së 3-të i nënshtrohen kontrolleve vjetore nga një autoritet i certifikuar (numri dallues ndodhet në siglen CE).

Mbrojtja nga shiu EN 343

Veshjet STIHL për ambiente të jashtme mundësojnë mbrojtje

nga shiu dhe era kur punoni jashtë dhe janë të rehatshme pasi materiali lejon avullimin e djersës. EN 343 i specifikon këto dy parametra si rezistenca ndaj ujit (numri i sipërm) dhe depërtueshmëria e avullimit (numri i poshtëm). Të dyja maten në 3 nivele. Kategoria 3 është më e mira. Tegelat janë të puthitura të papërshkueshme nga uji. Për shembull:



3 = rezistenca nga uji: EN 343 kategoria 3
 3 = depërtueshmëria e avullimit të ujit: EN 343 kategoria 3

EN 381 dhe. EN ISO 11393 mbrojtje gjatë prerjes



Mbrojtja STIHL nga prerjet është më së shumti e përbërë nga fibra të zhvilluara ekskluzivisht për STIHL. Veshja mbrojtëse kundër prerjes STIHL është testuar nga institutet e testimit prestigjioze European SMP ose KWF. Materiali mbrojtës nga prerja është i lehtë, i ajrosur dhe përbëhet nga shumë shtresa. Nëse zinxhiri i sharrës penetron shtresën e sipërme, grumbuj fibrash dalin jashtë dhe bllokohen yllzën. Kjo ndalon zinxhirin dhe redukton në mënyrë dramatike rrezikun ndaj dëmtimeve. Produktet mbrojtëse STIHL ndaj prerjeve janë shënuar në këtë katalog me ikonën e mëposhtme:



I testuar sipas nach EN 381 dhe. EN ISO 11393



I testuar në përputhje me EN 381 dhe. EN ISO 11393

Shënim i rëndësishëm:

Pajisjet mbrojtëse personale nuk mund të ofrojnë mbrojtje absolute nga plagosjet. Dhe as nuk janë zëvendësues për praktika të punës së sigurt. Si rrjedhim është thelbësore të zbatohen udhëzimet e sigurisë në manualët e përdoruesit si për pajisjet mbrojtëse personale dhe veglat motorike, sikurse dhe direktivat kombëtare për parandalimin e aksidenteve.

Zonat e mbrojtura nga prerjet në veshjet me mbrojtje nga prerjet

Pjesët mbrojtëse nga prerja të veshjeve mbrojtëse paraqiten nga ikonat përkatëse sipas EN 381 dhe EN ISO 11393. Ekzistojnë shkallë të ndryshme mbrojtjeje (shpejtësia e rrotullimit të zinxhirit është vetëm një parametër gjatë kontrollit sipas EN 381 dhe EN ISO 11393 dhe nuk ndërlidhet domosdoshmërisht me shpejtësinë e zinxhirit të një sharre që manovrohet me dorë): Klasa 0 e mbrojtjes nga prerja (16 m/s)
 Klasa 1 e mbrojtjes nga prerja (20 m/s)
 Klasa 2 e mbrojtjes nga prerja (24 m/s)
 Klasa 3 e mbrojtjes nga prerja (28 m/s)
 Instituti KWF rekomandon klasën e mbrojtjes numër 1. Një përmbajtje e veçorive kyçe të produktit mund të gjendet në faqen 298.

Modeli A



Modeli B



Para / prapa

Modeli C




Modeli B




Mbrojtje e plotë nga prerja në anën e përparme, në anën e pasme krahet dhe lart deri te shpatullat.

Zonat e mbrojtura nga prerjet në këpuçet



Pjesët mbrojtëse nga prerja te dorezat mbrojtëse



Forma A: pjesë mbrojtëse e fiksuar në pjesën e pëllëmbës së dorës tek dorezat me pesë gishta, por që nuk ka material mbrojtës për vetë gishtat.

EN ISO 20471 veshje paralajmëruese me shikueshmëri të lartë

Norma përcakton sipërfaqen minimale të ngjyrës paralajmëruese (shikueshmëri gjatë ditës) dhe shiritat reflektues (shikueshmëri

gjatë natës) duke i ndarë në tre kategori, ku kategoria e 3-të ka efektin maksimal paralajmëruese. Veshja e pantallonave dhe xhakëtës rrit klasën e sigurisë duke shtuar ngjyrat me dukshmëri të lartë dhe rripat reflektues. Për shembull:



2 = ngjyrë me shikueshmëri të lartë dhe material retro-reflektues këtu EN ISO 20471 kategoria 2

Vlera SNR

Pakësimi i Thjeshtuar i Zhurmës (Simplified Noise Reduction) është ulja e zhurmës e mundësuar nga kufjet mbrojtëse. Sa më e lartë të jetë vlera SNR, aq më shumë ulen zhurmat. Vlera e reduktimit të zhurmës M është kyçe për veglat e punës STIHL. Mund të gjeni më shumë informacion tek faqja e internetit të STIHL.

Mbrojtja UV



Faktori i mbrojtjes ndaj rrezeve UV (UPF) tregon sa gjatë mund të qëndrojnë një përdorues me mbrojtje ndaj diellit ose me veshje mbrojtëse nga rrezet UV nën dritën e diellit pa rrezikuar djegjen e lëkurës. Faktori UPF është i krahasueshëm me faktorin e mbrojtjes nga dielli (SPF) i përdorur në klasifikimin e kremi kundër diellit. Për shembull, një person me lloj lëkure 1 që ka veshur rroba me UPF 20 mund të qëndrojë i ekspozuar në dritën e fortë të diellit 20 herë më gjatë pa pësuar djegie të lëkurës. Shkalla e



PËRJETONI CILËSINË STIHL - NË RRJET DHE NË DYQAN



APLIKACIONI STIHL

I përditësuar, portabël, interaktiv: aplikacioni gratis i STIHL është një mjet universal kur ndodheni jashtë shtëpisë. Përfiton nga ekspertiza dhe shërbimet e vlefshme lidhur me gamën e produkteve STIHL. Ky aplikacion përmban mjete praktike, si manuale përdorimi interaktive për produktet tuaja të reja STIHL, makinë llogaritëse e cila përcakton raportin e duhur të përzierjes së karburantit dhe vajit, si edhe një kërkim intuitiv dyqanesh të autorizuara. Këto dhe shumë të tjera jua bëjnë jetën e përditshme më të thjeshtë.

STIHL NË MEDIAT SOCIALE

Na vizitoni në **Facebook**

Zbuloni kanalin STIHL në **YouTube**

Informacione për artikuj interesantë i gjeni në **stihl.com**

Na ndiqni në **Twitter**



STIHL NË DYQAN

Qoftë nëse sharroni, kositni, prisni, pastroni ose shkurtoni – produktet STIHL vazhdojnë të frymëzojnë përdoruesit për shkak të cilësisë dhe besueshmërisë pa kompromise. Duke patur një shitës specialist të STIHL gjithmonë pranë, përdoruesit mund të vazhdojnë të kenë besim se makineria e tyre do të ketë mbështetjen dhe jetëgjatësinë e përdorimit që duhet.

PARTNERËT E SHËRBIMIT STIHL

Jeni në duar të sigurta me shitësin tuaj specialist të STIHL – ata ofrojnë gjithçka që nga këshillimi deri në punët e servisit. Ata ju informojnë për mjetet më të përshtatshme për nevojat tuaja, ju japin këshilla të dobishme mbi mënyrat e duhura të përdorimit dhe ju ofrojnë shërbim profesional. Kjo siguron që vegla juaj motorike STIHL të përdoret me kënaqësi për shumë vite në vijim.

PJESË KËMBIMI ORIGJINALE TË STIHL

Besueshmëria maksimale, madje edhe në kushte ekstreme, është shenja dalluese e veglave të punës STIHL. Nëse diçka do të shkonte keq në makinerinë tuaj, STIHL mban pjesë këmbimi origjinale rezervë, duke garantuar performancën, sigurinë dhe jetëgjatësinë e shërbimit të veglës suaj të punës. **Te STIHL, ju mund të merrni pjesë këmbimi origjinale për të paktën 10 vjet pas ndërprerjes së prodhimit të një sharre me zinxhir ose të një vegle elektrike.** Kur blini STIHL, ju bëni një investim afatgjatë. Pjesët origjinale të këmbimit mund të identifikohen nga logoja STIHL ose simboli i pjesëve – një S e stilizuar.



KONTROLLI I CILËSISË SË STIHL

Standardi i lartë i veglave motorike STIHL bazohet mbi kërkesat e rrepta të cilësisë që zbatohen në të gjitha fushat e kompanisë. STIHL pajtohet me standardet ndërkombëtare ISO 9001 dhe ISO 14001 për cilësi totale dhe menaxhim mjedisor. STIHL punon gjithmonë për zhvillimin e vazhdueshëm të të gjitha produkteve. Kjo do të thotë se modeli, teknologjia dhe veçoritë mund të ndryshohen.

PËR SIGURINË TUAJ

Nëse nuk përdoren në mënyrën e duhur, të gjitha produktet tona mund të shkaktojnë dëmtim të përdoruesit ose personat e tjerë, kafshët dhe objektet që ndodhen afër. Për këtë arsye duhet të lexoni me kujdes të gjithë manualin e përdoruesit para se të ndizni dhe/ose përdorni një produkt për herë të parë dhe të zbatoni të gjitha udhëzimet e sigurisë.

MBROJTJA E MARKËS

Cilësia dhe siguria e klientëve kanë rëndësinë më të madhe për ne. Produktet tona janë rrjedhimisht të mbrojtura nga markat e regjistruara të ANDREAS STIHL AG & Co. KG, si më poshtë:

Logo STIHL

Logo e pjesëve të këmbimit STIHL

Kombinimi i ngjyrave portokalli dhe gri

